

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**MBI ZHVILLIMIN E STRATEGJISË
SË SIGURISË KOMBËTARE**

BOTIMET TOENA



MBI ZHVILLIMIN E STRATEGJISË SË SIGURISË KOMBËTARE

Materialet e këtij botimi janë marrë nga Konferenca Ndërkombëtare mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, mbajtur më 21 shtator 2007, organizuar nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2007

Aktiviteti dhe ky botim u mundësua nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).



Botues: Fatmir Toçi
Redaktor: Sotiraq Hroni
Korrektore letrare: Jonida Kofina
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 - 99943 - 1 - 295 - 5

© DCAF, IDN

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollësja", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 240116; 258893

Tel./Fax: (4) 240117

E-mail: toena@toena.com.al; infotoena@albaniaonline.net;

toena@icc-al.org

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

PËRMBAJTJA

Sotiraq Hroni Fjala hyrëse	7
Dr. David Law Praktikat më të mira në fushën e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare	11
Prof. dr. Rexhep Meidani Disa mendime mbi rishikimin e dokumentit të strategjisë ...	26
László Póti Analizë krahasuese e dokumenteve strategjike të vendeve të Ballkanit perëndimor	47
Prof. dr. Kastriot Islami Strategjia e Sigurisë Kombëtare në kontekstin e rreziqeve dhe kërcënimeve rajonale	67
Shkëlqim Cani, Merita Shehu Ekonomia – çështje kritike për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare	78
Alex Finnen Planifikimi i emergjencave civile në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë	99
Gjen. Brigade Zija Bahja Ide mbi rihartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH...	107

Sotiraq Hroni
Drejtor Ekzekutiv i IDN

FJALA HYRËSE

Konferenca “Mbi zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare” vjen si një përpjekje afatgjatë e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, nisur edhe nga roli i rëndësishëm, që ka ky dokument strategjik në sektorin e sigurisë dhe drejtimin e tij në vite. Gjatë një periudhe rreth dyvjeçare ne kemi marrë një sërë takimesh për të bërë një vlerësim dhe për të monitoruar nivelin e konsultimit të institucioneve me këtë dokument të rëndësishëm qysh prej miratimit të tij me ligjin nr. 9322, më 25. 11. 2004. Ky proces i pavarur monitorimi ka kapur dy çështje të rëndësishme; së pari, efektivitetin dhe referimin ndaj kësaj strategjie të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe së dyti, cili ka qenë institucion përgjegjës në vend për implementimin e kësaj strategjie. Fatkeqësisht, për të dyja çështjet nuk ka një përgjigje të qartë, për të mos thënë se kjo strategji ka mbetur një dokument formal në listën e dokumenteve të sigurisë së institucioneve të vendit.

Pikërisht, për këto arsye ne jemi duke bërë sot këtë konsultim dhe do të vazhdojmë përpjekjet për të adresuar këto dy probleme në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF). Ky aktivitet është produkt i një pune disamujore me DCAF si bashkorganizatore dhe mbështetësit e aktivitetit. Mbetet meritë për t’u vlerësuar e këtij institucioni prestigjioz

ekspertize, nisma për të ndihmuar dhe lehtësuar reformat në sektorin e sigurisë jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë rajonin. Si partner i saj lokal, IDN është plotësisht mirënjohës për mbështetjen që DCAF i ka dhënë nismave apo nevojave të aktorëve vendas, dhe kjo si nga qeveria e institucionet e tjera publike, ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Dëshiroj të shpreh konsideratën dhe ta falënderoj në mënyrë të veçantë Ambasadorin Gregori Zore për mbështetjen dhe rolin e tij në formatimin e përmbajtjes së këtij aktiviteti.

Nisur nga ajo çka parashikohet në fund të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) - “Kryeministri inicion rishikimin e strategjisë së sigurisë. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë rishikohet në një periudhë jo më vonë se 3 (tre) vjet nga data e miratimit të saj” - IDN dhe DCAF menduan të lehtësojnë dhe të asistojnë këtë proces nëpërmjet kësaj konference ndërkombëtare me qëllim:

- Zhvillimin e një perspektive gjithëpërfshirëse dhe të hapur, për të rishikuar dhe hartuar SSK si dhe krijimin e një forumi ndërinstitucional për procesin e hartimit të SSK 2007-2010.
- Mësimi nga praktikat më të mira prej vendeve të tjera evropiane mbi procesin e hartimit të SSK.

Në përputhje me objektivat, kam kënaqësinë të falënderoj edhe kontribuesit vendas që e kanë vlerësuar maksimalisht rëndësinë për të mirorientuar debatin nga këndvështrime analitike të pavarura për një dokument të ri të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, që duhet të jetë i ndjeshëm për qytetaret dhe, orientues e udhëheqës për të gjitha institucionet në vitet e ardhshme. Me interes të veçantë vijnë edhe prezantimet e eksperteve ndërkombëtarë e respektivisht zotit David Law për praktikat më të mira evropiane në këtë drejtim dhe të zotit

Lazlo Poti, i cili do të prezantojë një analizë krahasuese të dokumenteve të sigurisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në të gjithë këtë sipërmarrje IDN është nisur nga ideja se tashme në një shoqëri demokratike siguria nuk është vetëm atribut ekskluziv i institucioneve, dhe se ekspertiza nga jashtë mund t'i japë një frymëmarrje dhe perspektivë tjetër punës për një dokument strategjik sa me efektiv dhe udhërrëfyes. Si çështje të një ndjeshmërie absolute dhe bashkëkohore vjen në këtë botim edhe prezantimi i prof. Meidanit ku konceptit të sigurisë njerëzore i jepet një pamje mjaft konkrete, ndërsa në prezantimin e zotit Shkëlqim Cani adresohen çështje të zhvillimit ekonomik, papunësisë apo korrupsionit, të cilët qytetarët shqiptarë i vlerësojnë midis kërcënimeve më serioze për sigurinë.

Mendoj se analizat dhe pamjet e problematikes, parë nën këndvështrime të ndryshme apo përvojat më të mira evropiane që ofrohen nga ekspertët e lartë vendas dhe të huaj, do të sjellin ndoshta një qasje më konkrete, duke kontribuar për një dokument realisht strategjik e veprues për sigurinë njerëzore dhe kombëtare, si edhe për stabilitetin rajonal, në përputhje të plotë me sfidat rajonale të sigurisë dhe integritimit evropian dhe Euro-Atlantik.

Çështja e dytë e rëndësishme që mbetet për t'u ndjekur në të ardhmen është ajo që ka të bëjë me institucionin drejtues apo monitorues të këtij procesi për zbatimin e këtij dokumenti bazë të Sigurisë Kombëtare. Çështja këtu shkon tek institucioni kushtetues i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, si një çështje politike, që mund të rimerret në diskutim më të gjerë gjatë një procesi të pritshëm rishikues të Kushtetutës së vendit. Me fjalë të tjera, a do të vazhdojë të jetë Këshilli i Sigurisë Kombëtare një organ konsultativ i Presidentit të Republikës, siç është paraparë deri më sot, apo do të ketë edhe

prerogativa vendimmarrëse dhe struktura të tjera teknike mbështetëse për të drejtuar në të gjithë komponentët e tij reformat në sektorët e sigurisë dhe strategjinë kombëtare të sigurisë.

IDN dhe DCAF janë të gatshëm për të ofruar në të ardhmen praktikat më të mira evropiane edhe për këto çështje.

Duke iu kthyer edhe një herë çështjes së kësaj konference, IDN vlerëson bashkëpunimin me zyrën e Kryeministrit për të bashkërenduar përpjekjet, me qëllim përfitimin sa më të madh të ekspertëve të lartë ndërinstitucionalë që do të merren për hartimin e strategjisë së re për vitet e ardhshme dhe falënderon për fjalën dhe mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, zotit Gjergj Lezhja. Sidoqoftë, organizatorët e kësaj konference ndërkombëtare prisnin një bashkëpunim më efikas me Ministrinë e Jashtme edhe Komisionin Parlamentar të Sigurisë.

Shpresojmë se ky botim do të plotësojë mangësitë e vërejtura në konferencë.

Dr. David Law
 Ekspert i lartë DCAF

PRAKTIKAT MË TË MIRA NË FUSHËN E STRATEGJISË SË SIGURISË KOMBËTARE

Çështjet kryesore në këtë shkrim:

Çfarë është politika e sigurisë kombëtare?

Pse kanë nevojë shtetet për politika të sigurisë kombëtare?

Cila është baza ligjore për politikat e sigurisë kombëtare?

Si është e strukturuar politika e sigurisë kombëtare?

Si formulohet politika e sigurisë kombëtare?

Cilat janë sfidat kryesore për politikat e sigurisë kombëtare?

Cilat janë çështjet kyçe për formulimin e politikave efektive të sigurisë kombëtare?

Si zbatohet politika e sigurisë kombëtare?

Si e bëjnë shtete të ndryshme zbatimin dhe rishikimin e Politikave të tyre të Sigurisë Kombëtare?

Përmbledhje: Parimet e politikave efektive dhe demokratike të sigurisë kombëtare.

Çështjet e ndërlidhura

Informacion i mëtejshëm

Çfarë është politika e sigurisë kombëtare?

Politika e sigurisë kombëtare (PSK) është një kornizë-dokument, që përshkruan se si një vend ofron siguri për shtetin dhe qytetarët e vet, dhe shpeshherë prezantohet si një dokument i përgjithësuar. Për qëllimet e këtij “Backgrounder”-i, PSK do t’i referohet një dokumenti të tillë të përgjithësuar.

Ky dokument mund të quhet gjithashtu plan, strategji, koncept ose doktrinë. PSK-të kanë një rol për të tanishmen dhe për të ardhmen, pasi skicon interesat bazë të vendit dhe përcakton udhëzimet për trajtimin e rreziqeve dhe mundësive aktuale dhe të ardhshme. Normalisht, PSK-të janë në hierarki superiore ndaj politikave të tjera të sigurisë, si doktrinës ushtarake, strategjisë së sigurisë së brendshme etj., të cilat merren me sigurinë kombëtare, në bazë të agjencive apo çështjeve të veçanta. PSK gjithashtu dallohet prej këtyre politikave nga gama e temave që i trajton, dhe përpiqet të skicojë si rreziqet e brendshme ashtu edhe ato të jashtme. Së fundi, ajo mëton t'i integrojë dhe të bashkërendojë kontributet e aktorëve të sigurisë kombëtare në raport me interesat dhe rreziqet që konsiderohen më të rëndësishmet. Disa shtete, si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Kina, nuk kanë dokument të veçantë e të unifikuar të PSK-së, por mbështeten në politika të mbrojtjes ose në “dokumente të bardha” – projekt-dokumente të politikave, që përqendrohen vetëm në mbrojtjen kombëtare. Një numër i shteteve nuk i bëjnë publike dokumentet e politikave të tyre ose nuk i kanë të shkruara politikat gjithëpërfshirëse për sigurinë apo mbrojtjen.

Pse kanë nevojë shtetet për PSK?

Janë pesë arsye pse shtetet duhet të kenë një politikë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të sigurisë kombëtare:

- që të sigurojë që qeveria do t'i trajtojë të gjitha rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse
- që të rrisë efikasitetin e sektorit të sigurisë duke optimizuar kontributet e të gjithë aktorëve të sigurisë
- që të drejtojë zbatimin e politikës
- që të ndërtojë konsensusin e brendshëm të vendit
- që të rrisë besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar

Së pari, për t'u formuluar si një kornizë gjithëpërfshirëse, PSK-së i duhet një analizë e thellë e të gjitha rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare. Rreziqet e brendshme dhe të jashtme për një kohë të gjatë janë trajtuar ndaras, por gjithnjë e më shumë politikat e sigurisë janë duke përfshirë vlerësimet gjithëpërfshirëse si të mjedisit të brendshëm ashtu edhe të atij ndërkombëtar. Për krijimin e politikave të tilla duhet të konsultohen të gjitha palët e interesuara, qeveritarë të ndërlidhur me çështjet e sigurisë dhe, do të ishte ideale po të merrej edhe kontributi i palës ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Së dyti, PSK-ja mund të ndihmojë harmonizimin e kontributeve të numrit në ngritje të palëve të sigurisë, duke përfshirë ata të nivelit kombëtar, qeverisjes lokale, komunitetit të biznesit (për shembull, në mbrojtje të infrastrukturës jetike), organizatat e ndryshme të shoqërisë civile, si dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Procesi i centralizuar i formulimit të politikës që përfshin kontributin e burimeve të shumëllojta mund të ndihmojë krijimin e kuptueshmërisë të përbashkët të sigurisë.

Së treti, PSK-të japin drejtim politik palëve të ndryshme të përfshira në sigurinë kombëtare. PSK-të ofrojnë modele për bashkërendimin e vendimeve operative me pikësynimet afatshkurtra dhe afatgjata të politikës kombëtare. Procesi i centralizuar bën të mundur përdorimin optimal të burimeve, duke kontribuar në shmangien e pabarazive, të gjërave të panevojshme dhe të mungesave gjatë hartimit dhe zbatimit.

Së katërti, PSK-të sigurojnë pronësi të gjerë të politikës së sigurisë, duke thelluar diskutimin dhe bashkëpunimin përgjatë linjave profesionale, qeveritare dhe partiake. Ky dialog mund të kontribuojë për krijimin e një konsensusi në lidhje me vlerat dhe interesat kombëtare bazë dhe gamën e rreziqeve që i sfidojnë këto vlera dhe interesa.

Së pesti, PSK-të janë instrumente për ndërtimin e besimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Një politikë koherente dhe transparente ia komunikon bashkësisë ndërkombëtare shqetësimet e shtetit në lidhje me sigurinë, duke mundësuar kështu mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në shkallë ndërkombëtare.

Cila është baza ligjore e politikës së sigurisë kombëtare?

Nganjëherë, PSK-ja autorizohet me legjislacion të veçantë. Për shembull, Shtetet e Bashkuara kërkojnë nga Presidenti që çdo vit të paraqesë në Kongres strategjinë për sigurinë kombëtare, ndonëse në praktikë kjo nuk ndodh gjithmonë për çdo vit. Në Letoni, Parlamenti duhet të miratojë PSK-në që hartohet nga Kabineti dhe miratohet çdo vit nga Këshilli për Sigurinë Kombëtare. Në raste të tjera, ekzekutivi merr përsipër të nxjerrë vetë një strategji për sigurinë kombëtare. Në Federatën Ruse, për shembull, Këshilli për Sigurinë Kombëtare paraqet një strategji për sigurinë që miratohet nga ekzekutivi. Në Austri, Parlamenti krijoi në vitin 2001 një Këshill për Sigurinë Kombëtare, i cili ka mandat të drejtë politikën e sigurisë kombëtare, por jo domosdoshmërisht të nxjerrë një dokument të integruar të politikës së sigurisë kombëtare (ndonëse kjo është bërë).

Si është e strukturuar PSK?

Ndonëse PSK-të ndryshojnë nga shteti në shtet, ato kanë tendencë që të jenë një dokument i vetëm, i cili trajton të paktën tri tema bazë: rolin e shtetit në sistemin ndërkombëtar, sfidat dhe mundësitë që perceptohen brenda dhe jashtë vendit, si dhe përgjegjësitë e aktorëve zbatues për trajtimin e këtyre sfidave dhe mundësive.

Tema e parë kërkon të përcaktojë vizionin e shtetit për sistemin ndërkombëtar, si dhe rolin që luan shteti në atë sistem. Kjo kërkon që të merren në konsideratë interesat dhe vlerat e shtetit, strukturat qeverisëse dhe proceset vendimmarrëse. Kjo zakonisht arrin kulmin me një vizion afatgjatë se ku e kanë vendin në të ardhmen shteti dhe shoqëria.

Tema e dytë është një vlerësim i rreziqeve dhe mundësive aktuale dhe të ardhshme. Në teori, këto duhet të përfshijnë si rreziqet e brendshme ashtu edhe ato të jashtme, ndonëse në praktikë shumë PSK përqendrohen te rreziqet dhe mundësitë e jashtme. Qëndrimet dhe preferencat politike trajtohen gjithashtu, meqenëse ato lidhen me partnerët ndërkombëtarë të sigurisë, gjë që mund të çojë në shfaqjen e mundësive për bashkëpunim.

Tema e tretë përshkruan fushën e përgjegjësisë së çdo aktori zbatues. Këtu përfshihen lloji i veprimtarisë së sigurisë (siç është mbrojtja e atdheut, shërbimi i fshehtë i informacionit, etj.) dhe fushat në të cilat këta aktorë kanë mandat. Meqenëse në disa vende termi “siguri kombëtare” ka një lidhje historike me përfshirjen më shumë se ç’duhet të forcave të sigurisë në punët e brendshme, ai mund të jetë i diskutueshëm. Kontributi i aktorëve shpeshherë përshkruhet me hollësi, por informacione shumë të veçanta, siç është struktura e forcave, zakonisht lihen jashtë ose përfshihen në dokumente dytësore.

Si formulohet PSK?

Formulimi i PSK-së ndjek një cikël standard të politikës që përfshin fillimin, hartimin, harmonizimin dhe miratimin.

Shqyrtimin gati gjithmonë e **ndërmerr** ekzekutivi. Në disa raste, legjislativi ose grupe të përhershme për çështjet e sigurisë

mund të rekomandojnë shqyrtimin e politikës së sigurisë kombëtare. Procesi mund të jetë i përvitshëm ose i rregullt ose, si në rastin e Zvicrës, vetëm i herëpashershëm.

Organi i **hartimit** gjithashtu normalisht përcaktohet nga ekzekutivi dhe mund të jetë një komision i përhershëm ose një organ ekzistues ose mund të jetë i përkohshëm. Në shumë raste, ai është një këshill i veçantë për sigurinë që këshillon presidentin (Shtetet e Bashkuara, Austria, Federata Ruse), por në raste të tjera, ai mund të jetë kabineti (Letonia dhe Kanadaja) ose një komision i përkohshëm. Ky komision zakonisht këshillohet gjerësisht me aktorë qeveritarë të sigurisë, siç janë ministrinë e mbrojtjes, agjencitë e shërbimit të fshehtë, përfaqësuesit e forcave të armatosura, komisionet legjislative, dhe gjithnjë e më shumë ministrinë që tradicionalisht nuk janë të lidhura me sektorin e sigurisë, siç janë ato të bujqësisë, transportit, shëndetësisë, dhe organet e emigracionit dhe të administrimit financiar. Komisioni mund të këshillohet gjithashtu me aktorë joqeveritarë, siç janë partitë politike, mediat, shoqëria civile dhe akademikët. Nganjëherë këto grupe vështirë se ofrojnë ndonjë reagim, por komisioni shpeshherë punon për t'i sintetizuar vizionet e tyre të ndryshme në një qëndrim koherent ndaj sigurisë së shtetit. Gjerësia e pjesëmarrjes në formulimin e politikës së sigurisë kombëtare është çelësi për të siguruar pronësi të gjerë të politikës, që mund të ndihmojë për t'i dhënë një shtysë zbatimit të saj. Në Zvicër, për të bërë politikën më të fundit të sigurisë kombëtare u punua në dy faza: së pari, një këshillim i gjerë dhe përfshirës social-politik çoi në një raport jo të detyrueshëm për qeverinë, me sugjerime për politikën e sigurisë kombëtare; së dyti, hartimi nga një organ qeveritar që e mori parasysh këtë dokument kur nxori raportin e vet.

Harmonizimi arrihet duke kërkuar gjatë procesit të hartimit kontributin e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në

sektorin e sigurisë dhe duke qarkulluar gjatë procesit projektet fillestare të legjislacionit qoftë brenda për brenda, publikisht apo duke bërë një kombinim të të dyjave.

Miratimi mund të mos kërkohet nga legjislativi apo ekzekutivi. Nëse ekzekutivi e ka nisur procesin e shqyrtimit, nuk ka gjasa që të kërkohet marrja e miratimit të legjislativit, por ai gjithashtu mund të zgjedhë që t'ia paraqesë politikën e sigurisë kombëtare organit legjislativ të vendit, për të siguruar miratimin e tij. Disa parlamente mundet vetëm të mbajnë shënime në lidhje me një PSK, si në Zvicër, ndërsa të tjerë mund të kenë të drejtën të bëjnë ndryshime të rëndësishme në tekstin e saj.

Cilat janë sfidat kryesore për politikën e sigurisë kombëtare?

Së pari, PSK-të duhet të **baraspeshojnë hapjen dhe fshehtësinë**. Disa vende përpiqen ta shmangin këtë problem duke përdorur gjuhë të paqartë (që njihet gjithashtu si “paqartësi strategjike”), por kjo mund ta ulë efikasitetin e dokumentit. Vende të tjera mbajnë si versionet publike ashtu edhe versionet e rezervuara të Strategjisë për Sigurinë Kombëtare. Sidoqoftë, në qoftë se PSK është temë e debatit publik, përmbajtja e saj ka gjasa të pasqyrojë pikësynimet e përgjithshme të sigurisë kombëtare dhe t'ua lërë zbatimin e tyre doktrinave dytësore ose mekanizmave të tjerë të planifikimit.

Së dyti, disa perceptojnë një **konflikt mes nevojës për të ruajtur lirinë e veprimit dhe kufizimeve** të vendosura në veprimet e drejtuesve. Për këtë arsye, shumë vende në PSK-të e tyre parapëlqejnë më mirë të merren me çështje të veçanta sesa me vende të veçanta, ndonëse në rastet kur politika e sigurisë kombëtare hartohet për t'i dhënë një sinjal të qartë ndonjë fuqie tjetër, ajo mund të përmendet me emër.

Së treti, nevoja për **shqyrtime të politikës së sigurisë kombëtare duhet të baraspeshohet kundrejt kostos së tyre**, qoftë në aspektin njerëzor, qoftë edhe në atë material. Ndërsa shqyrtimet janë të nevojshme kur në mjedisin strategjik ndodhin ndryshime të rëndësishme ose në qoftë se politika aktuale e sigurisë gjykohet e papërshtatshme, në qoftë se ato autorizohen tepër shpesh, kjo mund të jetë një barrë për burimet, sidomos meqenëse politika e mirë e sigurisë kombëtare kërkon kontributin e atyre zyrtarëve, të cilët përfshihen në zbatimin e politikës.

Së katërti, politika e sigurisë kombëtare duhet të baraspeshojë **debatin publik me kontribut të ekspertëve**. Ndërsa debati publik është i nevojshëm për pronësinë, në qoftë se ka një perceptim se dokumenti është bërë peng i interesave politike, kjo mund ta minojë dobinë e tij.

Cilat janë çështjet kyçe që lidhen me formulimin e një politike të efektshme të sigurisë kombëtare?

- Kur duhet të ndërmerret një shqyrtim?
- Cilët aktorë duhet të përfshihen në procesin e shqyrtimit?
- A ka ndonjë agjenci kryesore të pavarur që mundëson dhe konsolidon kontributin e grupeve të punës në PSK?
- Si është e përcaktuar siguria kombëtare? Cilat janë sfidat e tanishme si dhe ato që mund të ndodhin në të ardhmen për sigurinë kombëtare?
- Çfarë instrumentesh janë të gatshme për sigurinë kombëtare dhe çfarë instrumentesh të reja mund të kërkojnë?
- Si e trajton PSK-ja baraspeshën mes transparencës dhe nevojës për të ruajtur konfidencialitetin në fusha jetike për sigurinë kombëtare?
- A është ngritur ndonjë organ vëzhgues për të shqyrtuar PSK-në? A është përfshirës organi vëzhgues?

- Çfarë masash duhen marrë për të përhapur PSK-në dhe për ta ndërgjegjësuar publikun në lidhje me përmbajtjen e saj?

Si duhet zbatuar PSK-ja?

PSK-të rrallëherë ofrojnë zgjidhje për probleme të veçanta të sigurisë, meqenëse këto dokumente nuk janë aq të hollësishme apo aq të ngurta sa të parashikojnë çdo të papritur. Prandaj, pas miratimit të saj, për zbatimin e PSK-së janë përgjegjës aktorë të veçantë të sigurisë, gjë që ndoshta do të përfshijë vlerësime të hollësishme të aftësive dhe shqyrtime të politikës në çdo agjenci.

Këto mund të rekomandojnë ndryshimet e mëposhtme strukturore:

Përshtatjen e instrumenteve ekzistuese të politikës.

Kjo mund të ketë ndërlikime në nivelet e personelit, shpërndarjen gjeografike të burimeve, politikat e prokurimit dhe në një shumëllojshmëri instrumentesh të tjerë. Çdo politikë vartëse, siç janë strategjitë kombëtare të mbrojtjes ose ushtarake, duhet të ndryshohen që të përkojnë me PSK-në.

Krijimi i instrumenteve të reja të politikës. Këto mund të përfshijnë komisionet e mbikëqyrjes, grupet e punës ndërdepartamentale ose mekanizma të tjerë.

Në nivel kombëtar, zbatimi i PSK-së mund të ndihmohet nga krijimi i **grupeve të përhershme** për të vëzhguar mënyrën në të cilën zbatohet PSK, ndonëse disa mund ta shohin këtë si një pengesë për vendimmarrje efikase në lidhje me sigurinë. Këto grupe e vlerësojnë PSK-në në aspektin e aftësive aktuale dhe të vlerësimeve të rrezeve. Disa vende ua atribuojnë këtë detyrë një organi të institucionalizuar, siç është Këshilli Kombëtar për Sigurinë; të tjerë parashikojnë takime të rregullta të një grupi të përkohshëm ndërministror

të shqyrtimit. Nëse është e mundur, përmbajtja dhe procedurat e organeve të vëzhgimit ndjekin të njëjtat parime të përfshirjes, transparencës, debatit dhe konsensusit si dhe komisionet për shqyrtimin e PSK-së. Në rastet kur e shohin të nevojshme, disa organe vëzhguese mund t'i propozojnë ekzekutivit një shqyrtim të PSK-së.

Si e bëjnë shtete të ndryshme zbatimin dhe rishikimin e Politikave të tyre të Sigurisë Kombëtare?

(Tabela e mëposhtme tregon se si katër vende shumë të ndryshme zhvillojnë procesin e rishikimit të Politikës së Sigurisë Kombëtare.)

	Letoni	Rusia	Zvicër	USA
Titulli i dokumentit të integruar	Koncept i Sigurisë Kombëtare (2002)	Koncept i parë i Sigurisë Kombëtare (KSK) (1997), ratifikuar me dekret presidencial; KSK II (2000)	Siguri nëpërmjet Bashkëpunimit: (1999)	Strategjia e Sigurisë Kombëtare e SHBA (2006)
Kush/çfarë e inicoi formulimin e PSK-së?	Kushtetuta	Ngritja e shtetit rus	Ministria e Mbrojtjes së Zvicrës në 1996	Akt Goldwater-Nichols (1986)
Kush e harton PSK?	Këshilli i Ministrave	Këshilli i Sigurisë Kombëtare/ ekzekutivi	Departamenti i Mbrojtjes, plus shumë aktorë të tjerë të lidhur me çështje të sigurisë	Presidenti dhe administrata e tij
Kush është/ ishte konsultuar në formulimin e PSK?	Nuk dihet (nëse janë konsultuar partnerë jashtë qeverisë, kjo nuk thuhet qartazi)	E Paqartë	Përfshirje e gjerë e ekspertëve dhe shoqërisë civile	Presidenti cakton një grup të tij politik. Ndikimi nga jashtë është i mundshëm, por nuk është e detyrueshme.

Kush, nëse dikush, miraton PSK?	Këshilli i Sigurisë Kombëtare e merr në shqyrtim ndërsa e miraton parlamenti	KSK të 1997 u vendos nga Presidenti, pa parlamentin.	Këshilli Federal (dega e ekzekutivit)	Asnjë (nuk kërkohet miratim nga Kongresi)
Sa shpesh rishikohet PSK?	Çdo vit	Në mënyrë të parregullt: 1997 dhe 2000	I papërcaktuar procesi i rishikimit	Çdo vit (por nuk zbatohet gjithmonë)
Deri në çfarë niveli adresohen kërcënimet e brendshme të sigurisë?	Theks i veçantë i kushtohet kërcënimeve të brendshme, në mënyrë të veçantë çështjeve si shteti ligjor, korrupsioni, siguria publike, parandalimi i organizatave kundër shtetit dhe radikale, dhe zhvillimit të sistemit të menaxhimit të integruar të kufijve.	Theks i veçantë i vihet rënies ekonomike të vendit dhe integritit; ekonomisë botërore, rritjes së standardeve të jetesës së qytetarëve rus; vendosjes së ligjshmërisë, forcimit të demokracisë dhe të drejtave kushtetuese; sigurimi i kufijve të Rusisë; sigurisë së informacionit; terrorizmit; krimit; konflikteve rajonale brenda Rusisë; problemeve ekologjike dhe parandalimit të tyre në të ardhmen. Si kërcënim i jashtëm përmenden në mënyrë të veçantë: zgjerimi i ndërtimeve ushtarake të NATO-s pranë Rusisë; terrorizmit ndërkombëtar; dobësimin të proceseve integruese në Komonwelthin e Shteteve të Pavarura (CIS), thellimin e konflikteve aktuale në CIS.	Si veçanti: mjedisin, migracionin, integrimin, dhe rreziqet nga ksenofobia	Kërcënimet e brendshme nuk trajtohen, por terrorizmi konsiderohet si kërcënim i brendshëm.

Përmbledhje: Parimet e një politike të efektshme dhe demokratike të PSK-së

Komisioni ose organi që ngarkohet me hartimin e PSK-së duhet të respektojë parimet e mëposhtme:

Përfshirja dhe reagimi: Formulimi i një politike përfshirëse është mënyra më e mirë për t'i trajtuar plotësisht shqetësimet e aktorëve në nivel shtetëror për sa i përket sigurisë dhe për t'i pajtuar këto shqetësime me mjetet dhe aftësitë e gatshme. Informacionet joqeveritare duhet patjetër të kërkohen dhe të adresohen nga ana e PSK-së.

Debati dhe konsensusi: Debati dhe kërkimi i konsensusit janë thelbësore për të hartuar një PSK, e cila do të kishte një mbështetje të gjerë dhe e cila do të zbatohet në mënyrë të efektshme.

Shqyrtimi i gjerë i kërcënimeve: Normalisht duhet të shqyrtohet një gamë e gjerë kërcënimesh, përfshirë ato që përmenden në Raportin e Kombeve të Bashkuara të Panelit të Nivelit të Lartë për Kërcënimet, Rreziqet dhe Mundësitë: kërcënimet ekonomike dhe shoqërore (përfshirë pandemitë dhe katastrofat natyrore dhe të papritura), konfliktet ndërshtetërore, konflikti i brendshëm, terrorizmi, armët e shkatërrimit në masë dhe krimi ndërkufitar.

Vlerësimi i drejtë i mjeteve: PSK-ja duhet të vlerësojë detyrat e organeve të ndryshme qeveritare për sa i përket kërcënimeve të përcaktuara, si dhe politikat aktuale, në lidhje me çështje të tilla si aleancat, përdorimi i forcës ushtarake, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe roli i demokracisë dhe i zhvillimit ekonomik në vizionin e vendit për sigurinë.

Transparenca: Procesi transparent i formulimit të PSK-së kontribuon për të parandaluar që mbi produktin përfundimtar të mbizotërojnë interesa të veçanta, siç janë ministritë e veçanta apo organet e sigurisë.

Vëzhgimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi i kërcënimeve: Përputhshmëria mes politikës ekzistuese të sigurisë kombëtare dhe mjedisit kombëtar dhe ndërkombëtar që është në zhvillim duhet të vëzhgohet vazhdimisht nga një grup i përhershëm. Organet vëzhguese duhet të ndjekin të njëjtat parime sikurse komisionet e shqyrtimit.

Konsideratat ndërkombëtare: Meqenëse shtetet nuk janë të izoluar, asnjë shtet nuk mund të formulojë një politikë sigurie krejtësisht “kombëtare”. Anëtarësia e shtetit në organizatat ose grupet shumëkombëshe, që lidhen me sigurinë ose ekonominë, do të ketë ndikim te formulimi i politikës së sigurisë kombëtare.

Respektimi i të drejtës ndërkombëtare: PSK duhet të marrë në konsideratë dispozitat e atyre instrumenteve ligjore ndërkombëtare ku është i anëtarësuar shteti, si dhe të drejtën zakonore, që është përgjithësisht e detyrueshme.

Çështje që lidhen me të

- Politika e mbrojtjes
- Angazhimet ndaj sigurisë ndërkombëtare
- Institucionet e sigurisë së brendshme
- Interesat kombëtare
- Struktura e komandës ushtarake
- Ministritë jo të mbrojtjes dhe sektori i sigurisë
- Mbikëqyrja parlamentare
- Grupet e përhershme për sektorin e sigurisë
- Gjendjet e emergjencës

Informacion i mëtejshëm

Politikat e sigurisë kombëtare në internet:

Austria: Doktrina e sigurisë dhe e mbrojtjes (2002)

www.am.gov.lv/en/nato/basic/4534/

Kanada: Sigurimi i një shoqërie të hapur: Politika e sigurisë kombëtare të Kanadasë (2004)

www.pco-bcp.gc.ca/docs/Publications/NatSecurnat/natsecurnat_e.pdf

Letoni: Koncepti i sigurisë kombëtare (2002)

www.am.gov.lv/en/nato/basic/4534/

Zvicër: Siguria nëpërmjet bashkëpunimit: Raport i Këshillit Federal të Asamblesë Federale për politikën e sigurisë të Zvicër (1999)

www.vbs-ddps.ch/internet/vbs/en/home.html

Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Strategjia për Sigurinë Kombëtare e Shteteve të Bashkuara (2002)

www.whitehouse.gov/nsc/nss.pdf

Ndër vendet e tjera me politika të sigurisë kombëtare përfshihet Estonia, Lituania, Polonia, Rusia, Sierra Leone dhe Turqia. Edhe BE-ja dhe NATO kanë hartuar strategji ose koncepte të sigurisë.

Burime të tjera:

“Kontroll civil apo komandë civile?” Kumtesë Konferencë e DCAF-it

www.dcaf.ch/publications/Working_Papers/121.pdf

“Administrimi i politikës kombëtare të sigurisë:

Presidenti dhe procesi”. Pitsburg:

University of Pittsburgh Press

“Strategjia për sigurinë kombëtare: dokumentimi i vizionit strategjik”. Monografi e Institutit të Studimeve Strategjike (SSI), Kolegji i Luftës i Ushtrisë Amerikane.

www.carlisle.army.mil/ssi/pdf/PUB332.pdf

“Një botë më e sigurt: përgjegjësia jonë e përbashkët”.
Raport i Panelit të Nivelit të Lartë të Sekretarit të Përgjithshëm
për Rreziqet, Sfidat dhe Ndryshimin.

www.un.org/secureworld/report2.pdf

Seria e “Backgrounder”-it të DCAF-it është përgatitur nga Grupi i Punës i DCAF-it për Reformën në Sektorin e Sigurisë, në bashkëpunim me Anëtarë të DCAF-it dhe ekspertë të jashtëm.

Kërkimet për këtë “Backgrounder” u kryen nga Asistentët Kërkimorë Shkencorë të DCAF-it, Jonas Hagman dhe James Stocker. James Stocker ofroi gjithashtu ndihmesën e tij për redaktimin e materialit. David Law, Bashkëpunëtor i Lartë Shkencor i DCAF-it për Reformën në Sektorin e Sigurisë, është Redaktor i serisë “Backgrounder”.

Numra të tjerë të “Backgrounder”-it janë të disponueshëm në adresën: www.dcaf.ch/publications/backgrounders

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) punon me qeveri dhe shoqërinë civile për të nxitur dhe forcuar kontrollin demokratik dhe civil të organizatave në fushën e sigurisë, siç janë policia, agjencitë e shërbimit të fshehtë, shërbimet e sigurisë kufitare, forcat paraushtarake dhe forcat e armatosura.

Qendra bën kërkime për të përcaktuar sfidat kryesore në qeverisjen demokratike të sektorit të sigurisë dhe për të grumbulluar ato praktika që janë më së miri të përshtatshme për t’u bërë ballë këtyre sfidave. DCAF u ofron programe këshillimore dhe ndihmesë në punë praktike të gjitha palëve të interesuara dhe kryesisht qeverive, Parlamenteve, autoriteteve ushtarake dhe organizatave ndërkombëtare.

Prof. dr. Rexhep Meidani

DISA MENDIME MBI RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË STRATEGJISË

Hyrje

Është e këshillueshme, madje dhe detyruese nga ana ligjore që dokumenti themelor i strategjisë kombëtare të rishikohet në mënyrë periodike, për të pasqyruar drejt ndryshimet objektive dhe subjektive, të brendshme (politike-institucionale e social-ekonomike) dhe të jashtme (globale, rajonale), që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këtë siguri. Ky proces rishikimi, i pakushtëzuar prej rotacionit politik të pushtetit, bëhet akoma më i domosdoshëm në prag të proceseve të tilla siç janë: mundësia e një anëtarësimi të afërt të Shqipërisë në NATO apo përfundimi i plotë i procesit parlamentar të ratifikimit të MSA-së dhe më tej nisja e etapës përfundimtare të procesit të anëtarësimi tonë në BE. Akoma më madhor është në këtë periudhë problemi i përcaktimit përfundimtar të statusit të Kosovës si shtet i pavarur, që jo vetëm do të rrisë shkallën e vetintegritit kombëtar, sidomos në fushën ekonomike-kulturore, por në një mënyrë apo tjetër, do të ndikojë në stabilitetin e mëtejshëm të Ballkanit, në përshpejtimin e proceseve integruese të tij, dhe mbi të gjitha në rritjen e shkallës së sigurisë në rajon, që “përkthehet” në gjuhën ekonomike, me mundësi shumë më të mëdha

bashkëpunimi dhe investimesh të huaja. Pikërisht, në një këndvështrim të tillë konkret, ia vlen të trajtohet dhe pjesa e çështjes kombëtare në kuadër të rishikimit të strategjisë.

Sidoqoftë, duke e parë problemin e rishikimit të strategjisë kombëtare në një plan më të gjerë, duket e arsyeshme që të trajtohen apo debatohen edhe disa çështje që lidhen ngushtë me vetë përmbajtjen e këtij koncepti. Përfshirë edhe emërtimin e tij, duke pasur parasysh krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Pra, ndryshe e thënë, në vend të termit tashmë të pranuar si *“siguri kombëtare”* vlen të konsiderohet dhe mundësia e përdorimit të tij si *“siguri shtetërore”* (apo *vendore*).

Po ashtu, nga ç’është shkruar dhe diskutuar, ende kjo lloj sigurie të ne, por dhe në vende të tjera, u referohet politikave qeverisëse që kanë të bëjnë me mbijetesën dhe garancinë e shtetit-komb, duke përfshirë (por jo kufizuar) ushtrimin e fuqisë në fushën diplomatike, ekonomike e ushtarake në kohë paqe e lufte. Natyrshëm, brenda këtij kuadri, si një aspekt i veçantë shfaqet dhe mbrojtja e vendit, e integritetit territorial dhe sovranitetit nga kërcënime të ndryshme, sidomos ato të jashtme, edhe pse ajo perceptohet sot në një optikë të re, me theks më shumë kolektiv (brenda një strukture globale të sigurisë) sesa individual (vëndor). Pa mohuar dhe domosdoshmërinë e zbatimit të një diplomacie aktive e pragmatike në lidhje me aleancat konkrete, zgjedhjen e drejtë apo klasifikimin e tyre hierarkik, për të njohur e vlerësuar drejt realitetet e pozicionimet, konsekuencat tradicionale e “përdredhjet moderne”, dhe mbi të gjitha për të shmangur konfliktet, për të izoluar kërcënimet apo për të nxjerrë përfitimet optimale në rrafsh shtetëror e kombëtar. Në këtë kuptim, po aq i vlefshëm është vazhdimi i strukturimit efektiv të forcave të armatosura, në përputhje me kërkesat e anëtarësimit, duke pasur parasysh si pjesëmarrjen konkrete

ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit apo operacione të tjera, ashtu dhe ndërvarësinë në rritje në kuadër të integritimit në NATO. Kjo, nga ana saj, po bën të nevojshëm dhe zëvendësimin e shërbimit ushtarak të detyrueshëm me atë profesional. Po aq i nevojshëm, në konceptimin modern të një force efektive, të dobishme dhe të lidhur me komunitetin, po bëhet dita-ditës fuqizimi numerik, profesional e teknik i përbërëses xheniere mjaft të dobishme brenda këtyre forcave. Nga ana tjetër, nga përvoja mjaft e hidhur e kësaj vere tepër të nxehtë, po aq i domosdoshëm, rezulton fuqizimi e strukturimi modern i mbrojtjes civile, efektiviteti dhe rritja e shkallës së bashkëpunimit të saj me struktura të tjera brenda vendit apo ato si motra të vendeve fqinje, krijimi dhe garantimi për këtë i një minimumi kritik infrastrukture, të gatshme dhe të lëvizshme, marrëveshjet paraprake me struktura të ngjashme në nivel rajonal e evropian, etj., për përbashkimin e përbashkët të katastrofave të mëdha natyrore ose akteve terroriste me pasoja masive. Madje, të gjitha vlejné të formulohen në mënyrë “urdhërore” në dokumentin e strategjisë. Një mbështetje më të kujdesshme në planin profesional e financiar kërkojnë sot dhe shërbimet inteligjente, bashkëpunimi i tyre në një nivel rajonal e ndërkombëtar në luftën e përbashkët kundër krimit ekonomik, terrorizmit e dukurisë mbështetëse të tij, si trafikimi i drogës, armëve, qenieve njerëzore, etj. Dhe së fundi, pas miratimit parlamentar të dokumentit të strategjisë, ai, për periudhën në fuqi, të mos kthehet, si deri tani, në një material “sirtarësh”, por të bëhet një udhërrëfyes për zbatim. Sidomos kjo vlen për dikasterin e financave.

Kufizimi demokratik i pushtetit ekzekutiv në kuadër të sigurisë. Domosdoshmëria e transparencës.

Në lidhje me pjesën e tretë të quajtur “Elementët e Fuqisë Kombëtare”¹ vlejnë të parashtrihen dhe mendimet e mëposhtme në shërbim të fuqizimit të sistemit demokratik në qeverisje, që pasqyrohet edhe në rritjen e mëtejshme të garancive në fushën e sigurisë.

Që në fillim të shekullit, Uillson (Woodrow Wilson) ka theksuar se: “*Historia e lirisë është historia e kufizimit të pushtetit qeverisës e jo e rritjes së tij*”². Në një sistem demokratik, kufizimi i pushtetit qeverisës realizohet, së pari, në mënyrë ligjore, nëpërmjet bashkëpunimit, balancimit dhe kontrollit reciprok të pushteteve të ndryshme. Ky është dhe *kufizimi kushtetues-ligjor* i këtij pushteti, që ende lë shumë për të dëshiruar. Një rol mjaft të rëndësishëm në kufizimin e pushtetit qeverisës luan *kontrolli e kufizimi parlamentar*, sidomos kjo në kuadrin e një republike parlamentare. Këtu krahas grupit parlamentar të shumicës, për sqarime, rregullime, ndërhyrje e korrigjime, ndryshime kabineti, një rol me peshë duhet të luajë dhe opozita (interpelanca për çështje konkrete, iniciativa ligjore në mbështetje të zhvillimit apo në shërbim të grupimeve të caktuara qytetare, mocione të ndryshme mosbesimi për raste individuale, deri dhe komisionet parlamentare për çështje tepër madhore e serioze, etj.). Në kushte normale, kufizimi i pushtetit qeverisës realizohet politikisht si nga forca politike apo koalicioni i partive në qeverisje, sepse një gjë e tillë është në detyrimin programor e interesin e tyre politiko-elektoral,

¹ *The National Security Strategy of the Republic of Albania*, (merln.ndu.edu/whitepapers/Albania_English-2004.pdf).

² Woodrow Wilson (1856–1924), U. S. president. Address, September 9, 1912, to the New York Press Club. *The Public Papers of Woodrow Wilson*, vol. 25, p. 124, ed. Arthur S. Link.

ashtu dhe nga partitë opozitare nëpërmjet angazhimeve e veprimtarive të larmishme. Ky është dhe *kufizimi apo kontrolli politiko-partiak i qeverisjes*. Në terma të kufizuara, mund të flitet dhe për partitë e koalicionit, strukturat drejtuese të cilave, pas ndarjes së “copërave” të qeverisjes mbeten pothuajse krejtësisht jashtë loje në mbarëvajtjen e punëve apo në orientimin e drejtë dhe kolegjal të tyre. Me mungesë efektiviteti e pykëzimi shfaqet dhe opozita, e cila në mungesë të një strategjie të përcaktuar, hidhet pothuajse në mënyrë spontane nga një “iniciativë” në tjetrën.

Një rol të veçantë mund të luajnë dhe institucione të pavarura që realizojnë *kufizimin apo kontrollin juridiko-ekonomik*. Të tilla janë: Prokuroria e Përgjithshme, Gjykatat (Gjykata e Faktit, Apelit dhe Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese), Avokati i Popullit, KLSH, Banka e Shqipërisë, entet rregullatore (p. sh. për politikat e çmimeve), Inspektorati i Lartë i deklarimit të pasurive, Zyra e Konkurrencës, etj. Në këtë rast, një shqetësim në vete, edhe në kuadër të sigurisë, është ndërhyrja politike mbi këto institucione, deri komandimi i tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë (nëpërmjet presionit politik e parlamentar, akuzave publike apo shtrëngesës financiare).

Një përbërëse tjetër është *kontrolli sindikalist apo i vetë biznesit*. Në kushtet e reja të riorganizimit ekonomik e shoqëror, të rritjes së rolit të prodhimit të vogël e të mesëm, të shoqëruar me shpërndarjen dhe mikrostrukturimin e fuqisë punëtore, janë shfaqur dobësi të theksuara në lëvizjen sindikaliste. Kjo gjë është manifestuar dhe si dobësi e rolit dhe kontrollit të kësaj lëvizjeje në *kufizimin e pushtetit qeverisës*. Në kushte të tilla si çështje parësore mbetet reformimi i kësaj lëvizjeje, që krahas problemeve të strukturës dhe drejtimit, shfaq qartë dhe një mungesë energjie e orientimi, dhe mbi të gjitha frymë korruptive e konformizmi. Jo pa vlerë është dhe reagimi i

organizmave punëdhënëse private dhe i bashkimeve të tyre, përfshirë dhe Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë, ndaj trysnive e veprimeve të padrejta e arbitrare të pushtetit qeverisës, në dëm të biznesit të rregullt me ligjin e sistemin rregullator.

Në nivelin e sotëm të demokracisë dhe zhvillimit, si element i rëndësishëm i kontrollit, në shërbim të sigurisë, është *kontrolli publik nëpërmjet shoqërisë civile, medias së shkruar e elektronike, apo, në përgjithësi, pjesëmarrjes qytetare*, ku reagimi i konsumatorit duhet të zërë një vend të dorës së parë. Pavarësisht, disa shformimeve të shfaqura dhe në median tonë, disa pozicioneve diku konformiste, diku abuzive apo dhe me lidhje interesi, në mesatare ajo përsëri e ka ruajtur forcën e saj të oponcës dhe mbetet një zë me vlerë në zhvillimet tona. Një problem në vete, pavarësisht “ngjyrës” së qeverisjes, mbetet dhe “trysnia tatimore” e pushtetit ekzekutiv ndaj saj.

Siguria dhe të drejtat e njeriut

Një plotësim e përpunim të mëtejshëm konceptor kërkon dhe pjesa e parë “Strategjia e sigurisë” (ku trajtohet koncepti strategjik i sigurisë dhe objektivat e sigurisë) apo pjesa e dytë “Kwadri strategjik i sigurisë”. Në këtë optikë, jo vetëm te ne, masat e adoptuara për sigurinë kombëtare përkundrajt kërcënimeve aktuale nuk mund të mos hapin diskutime deri kundërshtuese, mbi shkallën dhe rolin që mund të luajë pushteti ekzekutiv në kushte problematike apo rritje rreziku, pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo sepse, në raste të tilla, masat e sigurisë shtetërore (vendore apo kombëtare), që nënkuptojnë një mbrojtje të shoqërisë si të tërë, mund të krijojnë kufizime mbi parimet e tregut, liritë dhe të drejtat e njeriut apo dhe të mishërojnë mungesë solidariteti e kohezioni për grupime të caktuara. Qofshin këto

masa dhe të përkohshme siç ishte rasti i moratoriumit për skafet!

Shqetësimi që duhet të shprehet në dokument është se ushtrimi i fuqive dhe ligjeve specifike të sigurisë kombëtare me pretendimin e rrezikut, që i kërcënohet vendit apo me luftën kundër dukurive kriminale, nuk mund të jenë përbërës normalë të një qeverisjeje të mirë, të shtetit ligjor, dhe në një mënyrë apo tjetrën ato nuk duhet të kufizojnë mekanizmat e “kontroll-balancimit”. Madje, mund të trajtohen dhe si pretekste për autoritarizëm apo akumulim pushteti, për “shuarje” pikëpamjesh të kundërta politike e sociale. Në këtë optikë, masa të tilla të gabuara mund të jenë, p. sh., dhe spiunimi me nuancim masiv apo survejimi me urdhër verbal, censurimi i medias, “shtrëngesa” e lejes speciale për botimet, dhe për më keq përqendrimi i këtyre lejeve e licencave përkatëse te Ministria e Kulturës, etj. Por me një “logjikë” të tillë mund të rriten gradualisht përbërësit antidemokratikë dhe të shtohen prirjet drejt “*shtetit të policit*”, që në një mënyrë apo tjetrën pasqyrohet në kualitetin e demokracisë dhe të sigurisë së njeriut. Përkundrazi, hartimi i një legjislacioni më të plotë (qoftë dhe më “të fortë”) anti-terror apo përmirësimi i tij, duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, duhet të jenë një kërkesë permanente dhe krejtësisht eksplicite në dokumentin e strategjisë. Një çështje tjetër për t’u theksuar aty është ajo e sigurisë elektronike apo hartimi i legjislacionit përkatës.

Sidoqoftë, në parapritje të ardhmes, që në këtë dokument të strategjisë, del si problem rritja në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e peshës specifike të *sigurisë njerëzore*, qoftë dhe brenda konceptit ende ekzistues të sigurisë kombëtare (shtetërore). Kjo edhe sepse vetë siguria njerëzore po bëhet aktualisht një “paradigmë” emergjente për të evidentuar faktin e domosdoshmërisë së rishqyrtimit të konceptit të sigurisë në

shkallë globale, vendore e kombëtare. Në thelb, ajo synon të “martojë” konceptin tradicional të sigurisë me parimet e lirive dhe të drejtave të njeriut, sovranitetin me ndërvarësinë në rritje. Për më tepër, në pasqyrim të realitetit të ri, ajo shkon përtej të kuptuarit tradicional të mbrojtjes dhe kërcënimeve ndaj vendit (p. sh. sulmit nga një shtet tjetër) duke përfshirë aty dhe ndjesi të tjera shumë të mëdha si ato të varfërisë, pabarazisë ekonomike, sëmundjeve problematike, abuzimit ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut (në mënyrë institucionale, kolektive apo individuale), abuzimit me tokën e natyrën, ndotjes së mjedisit, katastrofave natyrore apo ngrohjes globale...

Siguria njerëzore dhe lidhja e saj me sigurinë shtetërore¹

Siguria shtetërore apo kombëtare, në një këndvështrim tradicional, ka mbizotëruar në skenën globale si koncept parësor i sigurisë në rrafsh kombëtar e ndërkombëtar. Ajo, ka përjetuar variantet e ndryshme të saj që nga traktati i Vestfalisë të vitit 1648 (me futjen dhe kultivimin e konceptit të shtetit-komb²) deri në ditët tona. Megjithatë, gjatë dhjetëvjeçarëve të shkuar, u duk qartë se përpjekjet për të garantuar sigurinë territoriale të kombeve ose të blloqeve ushtarake nuk ishin gjithmonë të suksesshme në plotësimin, garantimin apo përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve dhe *sigurisë* e tyre. Për më tepër, edhe kur kufijtë e disa shteteve mund të jenë të sigurt nga kërcënimet e huaja, popujt brenda kufijve të këtyre shteteve nuk janë ndier patjetër të çliruar nga krimi, të kenë ushqim të mjaftueshëm, të gëzojnë kujdesin e

¹R. Meidani, *Probleme të sigurisë njerëzore në Ballkanin Perëndimor*, Rev. “Çështje të Sigurisë”, IDN, Nr. 2, 2006, f. 78-92.

²Për më hollësisht shihni, R. Meidani, *Kurthet e shtetit-komb*, Toena, 2005; *Las trampas del Estado-nación*, Siddharth Mehta Ediciones, Madrid 2007.

nevojshëm shëndetësor, arsimin e duhur apo t'u respektohen liritë politike dhe të drejtat njerëzore.

Ndryshe nga *siguria tradicionale* (shtetërore, vendore apo kombëtare) *siguria njerëzore* nxjerr, pra, në plan të parë sigurinë e individit, madje dhe duke iu kundërvënë aty-këtu asaj tradicionale, kur kërcënohet siguria e tij. Ndryshe e thënë, për sigurinë tradicionale parësore ka qenë mbrojtja e shtetit-komb, kurse në kuadër të sigurisë njerëzore në qendër është individi, standardet e pranueshme të jetës, shëndetit dhe mirëqenies së tij. Dhe kjo, ndërkohë, që *koncepti i sigurisë* për një kohë mjaft të gjatë është interpretuar, madje vazhdon të interpretohet në mënyrë të ngushtë: si *siguri e territorit* nga agresioni i jashtëm, si *mbrojtje e interesave kombëtare në politikën e jashtme*, etj., d. m. th. siguria ka qenë e lidhur më shumë me vendet sesa me popujt, më shumë me *sigurinë e shtetit* sesa me *sigurinë e njeriut*.

Koncepti i sigurisë njerëzore filloi të zhvillohet sidomos në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, duke përfshirë, krahas marrëdhënieve ndërkombëtare, problemeve të zhvillimit politik e social-ekonomik, dhe fusha të tjera si ato të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, të mbrojtjes së mjedisit, edukimit të gjithanshëm dhe më cilësor të popullsisë¹, etj. Madje, siguria njerëzore, nga partizanët e saj, po konsiderohet sot si një zhvillim konceptor i ri, i domosdoshëm në kushtet e globalizimit. Në terma të tjera, siç është shprehur Oskar Arias²: “*Siguria njerëzore përfaqëson shkallën e mbrojtjes së qenieve njerëzore nga injoranca, sëmundjet, uria, shpërfullja dhe keqtrajtimi. Standardi i jep dinjitet jetës njerëzore*”; kurse në një trajtim më

¹ Për një trajtim më të plotë, shihni R. Meidani, *Education as a Fundamental Right (Edukimi si një e drejtë themelore)*, in *Balkan Yearbook of Human Right (Human Rights Education in the Balkans)* BHRN, 2003

² Oscar Arias, *Globalization and the Challenges of Human Security*, Speech by him, University of San Diego, September 28 1998.

njerëzor, ajo “është një fëmijë që shpëtohet, një sëmundje që kurohet, një tension etnik që zbutet, një disident i cili arrin të flasë lirshëm, një shpirt njerëzor që ka shpresë.”... Pra, siguria njerëzore lidhet me jetën dhe dinjitetin e njeriut, ajo përfshin sigurinë e individit në mjedisin dhe bashkësinë ku jeton. Apo e thënë ndryshe, nënkupton sigurinë personale të individit ndaj dhunës apo dëmtimit; edukimin e tij cilësor dhe mundësinë e sigurimit të gjërave më thelbësore për jetën, mbrojtjen e tij nga krimi e sëmundjet masive, nga korrupsioni politik e shpërnguljet me dhunë, nga shkeljet e lirive dhe të drejtave të tij. Po ashtu, ajo nënkupton çlirimin nga dhuna e bazuar në gjini; respektin e plotë të drejtave të komuniteteve politike dhe kulturore; zhvillimin demokratik politik e social-ekonomik të tyre; parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve, përpjekjet për mosshpërdorimin e tokës dhe të burimeve natyrore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe pakësimin e ndotjes, etj.

Nuk mund të mohohet se kjo problematikë ndeshet dhe në dokumentin aktual të strategjisë, por fjala këtu është për peshën specifike në optikën e shikimit të çështjeve të sigurisë. Aq më tepër që siguria njerëzore dhe ajo tradicionale nuk janë aspak koncepte reciprokisht përjashtuese. Ato janë plotësuese, komplementare. Madje, pa garantuar sigurinë njerëzore nuk ka kuptim të flasësh për garantim të sigurisë tradicionale dhe anasjelltas. Por, ama, këto dy koncepte të sigurisë, në thelbin e tyre, nuk janë identike. Siguria tradicionale ka në qendër *shtetin*, kurse siguria njerëzore *individin*, popullin. E para lidhet ngushtësisht me territorin dhe kufijtë shtetërorë, pra hapësirë-kohën e merr pothuajse të ngurtë (*absolute*), kurse e dyta kujdeset për individin, pavarësisht kohës dhe vendndodhjes së tij (territorit apo kufijve brenda të cilëve ai jeton në një moment të dhënë), pra hapësirë-kohën e merr si të lëvizshme (*relative*). Madje,

është ky koncept i dytë që mishërohet qartë dhe në nenin 8 të Kushtetutës së Shqipërisë¹.

Po ashtu, sipas sigurisë tradicionale rreziku apo kërcënimi për vendin e territorin vjen kryesisht nga një *agresion i jashtëm*, por jo nga një përplasje e brendshme, p. sh. një luftë civile. Kurse, siguria njerëzore e përfshin mbrojtjen e njerëzve (të njësisë shtetërore apo anëtarësisë kombëtare) nga agresioni i jashtëm, por njëkohësisht merr në konsideratë përplasjet dhe konfliktet e brendshme, terrorizmin apo krimin e organizuar brenda vendit apo atë ndërkufitar e ndërkombëtar, marxhinalizimin e shpërfilljen, pabarazinë e theksuar ekonomike, sëmundjet infektive e masive, ndotjen e mjedisit, etj. Gjithashtu, në konceptin e sigurisë tradicionale vendimet merren përgjithësisht nga strukturat e fuqisë apo *institucionet e shtetit*, që janë dhe aktorët kryesorë, ndërkohë që për garantimin e sigurisë njerëzore *spektri i aktorëve* është shumë më i gjerë, duke përfshirë agjenci vendore, rajonale e ndërkombëtare apo struktura joqeveritare, segmente të tjera të shoqërisë civile, si universitetet, komunitete fetare, etj. Në fund të fundit, siguria njerëzore është, pikësëpari, mbrojtje e lirive jetësore, nëpërmjet zhvillimit të parimeve demokratike dhe pjesëmarrjes sa më të gjerë qytetare në qeverisje, që nënkupton, nga ana tjetër, edhe kërkesën për institucione demokratike, shtet të së drejtës, në të cilin funksionojnë drejt pavarësia e pushteteve apo ndarja e fuqisë dhe mekanizmi i kontroll-balancimit ("*check and balance*")...

¹ Në nenin 8, thuhet: "1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj. 2. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet. 3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare", f. 5, në "Këtu fillon e ardhmja", Tiranë, nëntor 1998.

Siguria njerëzore në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor

Me fundin e Luftës së Ftohtë apo zbutjen e armiqësive ideologjike, me rritjen graduale të ndërvarësisë politike e ekonomike në nivel global, po kuptohet dita-ditës që kërcënimet ndaj sigurisë janë, përgjithësisht, shumë më të ndryshme nga problemet e dikurshme të lidhura me mbrojtjen klasike ose kufijtë kombëtarë. Krahas terrorizmit dhe dukurive shoqëruese të tij, sot në plan të parë, siç u përmend më sipër, kanë dalë probleme të tilla si: varfëria, ndarja dixhitale e teknologjike, pabarazitë e theksuara social-ekonomike, sëmundjet masive, abuzimet ndaj të drejtave të njeriut, ndotja e mjedisit apo fatkeqësitë natyrore. Bile, në një raport ndërkombëtar të zhvillimit njerëzor¹ për vitin 1994, duke u mbështetur në këto realitete të reja, për sigurinë njerëzore (në përputhje dhe me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit²) jepen dhe 7 drejtime kryesore të saj:

Siguria ekonomike nënkupton garantimin e disa të ardhurave bazë për jetën e individit, duke u mbështetur në punën e tij (por në mungesë të saj dhe nga një sistem asistence). Kjo lloj sigurie nuk është ende e garantuar në Shqipëri, Kosovë apo në përgjithësi, në Ballkanin Perëndimor, sepse në shumë nga këto vende, për arsye të luftërave, reformave të shpejta ekonomike (shpesh problematike), gabimeve e paqëndrueshmërive politike e sociale dhe të një shkalle të ulët të investimeve, niveli i papunësisë është ende mjaft i lartë, madje përqindja e popullsisë që jeton *nën linjën e varfërisë* (me 1-2 Euro në ditë) është relativisht shqetësuese³. Problem në

¹ United Nations Development Programme's 1994, Human Development Report, 1994.

² Millennium Development Goals - The United Nations Millennium Declaration, firmosur në shtator 2000.

³ Promoting Sustainable Economies in the Balkans: Independent Task Force Report, by Michael B. G Froman, Steven Rattner - Political Science – 2000.

vete, p. sh. në Shqipëri, është dhe furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, jo vetëm i një pjese të popullsisë, sidomos në zonat rurale, por dhe i shumë shërbimeve e bizneseve prodhuese.

Siguria ushqimore, e lidhur ngushtë me sigurinë ekonomike, nënkupton që të gjithë njerëzit kanë mundësi ekonomike dhe fizike të ushqehen në mënyrë bazike. A plotësohet kjo gjë për të gjitha shtresimet e popullsisë? Gjatë konflikteve në ish-Jugosllavi, (krizës boshnjake, kroate e kosovare), as që mund të bëhej fjalë për diçka të tillë. Por ende dhe sot mbeten mjaft shqetësime. Nga njëra anë, papunësia është e lartë, kurse asistenca sociale e dobët, dhe, nga ana tjetër, mosfunksionimi i rregullt i strukturave doganore dhe kontrollit ushqimor apo pafuqia e organizatave të konsumatorit, e bëjnë, në mjaft raste, relativisht problematik garantimin e sigurisë ushqimore.

Siguria shëndetësore synon garantimin e një mbrojtjeje të pranueshme nga sëmundjet e ndryshme apo nga një jetë e pashëndetshme. Nuk mund të mohohet që kjo siguri lidhet ngushtë dhe me cilësinë e sasinë, me mënyrën e ushqimit, me nivelin e ndotjes së mjedisit, me shërbimin shëndetësor dhe strukturat e sigurimit të tij, dhe pse jo edhe me stabilitetin politik. Po aq shqetësuese po bëhen gradualisht në nivel vendor e rajonal edhe sëmundje të tilla si p. sh. *SIDA (HIV/AIDS)*. Kjo e fundit si një sëmundje e re në rajon, nga ritmet e përhapjes së saj, por dhe dobësia e strukturave të mirëfillta mjekësore, po bëhet dita-ditës kërcënuese, sidomos në mungesë të higjienës dhe edukimit seksual apo të një sensibilizimi të mjaftueshëm të opinionit publik. Problematik po bëhet dhe dhurimi i gjakut, kushtëzuar dhe nga pakujdesia e teknologjia e përdorur në analizën e tij.

Siguria mjedisore nënkupton mbrojtjen e njerëzve nga abuzimi e shkatërrimi i natyrës, nga keqpërdorimi i tokës nëpërmjet ndërtimeve pa leje nga individit apo vetë strukturat

shtetërore, në mosrespektim të kriterëve urbanistike e mjedisore, nga përdorimi i teknologjive të prapambetura, i makinave të vjetra, etj. Një problem në vetvete në rajon është administrimi i drejtë i ujërave dhe shmangia e ndotjes së tyre në lumenj, liqene e det, apo ndotja e ajrit, sidomos në qytetet e mëdha. Mund të pohohet, pa më të voglin hezitim, që në lidhje me sigurinë mjedisore është bërë shumë pak në rajonin e Ballkanit, përfshirë Shqipërinë. Po kështu, mungesa e marrëveshjeve të reja në lidhje me problemet e ndotjes apo të administrimit të drejtë të ujërave që përshkojnë kufijtë kombëtarë (p. sh. rasti i liqenit të Ohrit, të Shkodrës, të lumenjve si Drinit të Zi, Drinit të Bardhë, Danubit, etj.) mund të shoqërohet me përplasje ndërshtetërore, që nuk i shërbejnë mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit të përbashkët, dhe mbi të gjitha paqes, bashkëjetesës dhe sigurisë rajonale.

Siguria e individit ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve nga dhuna fizike prej aktorëve individualë e shtetërorë. Këtu futen dhe përpjekjet për shmangien e abuzimeve ndaj gjinisë apo moshës, të trafikimit të grave apo të fëmijëve, të aksidentëve të shumta në transport e punë, etj. Sidomos një vëmendje të veçantë politike e qytetare kërkohet ndaj abuzimeve individuale apo dhunës së ushtruar nga segmente të policisë, dhe mbi të gjitha diferencimit të kësaj dhune sipas përkatësisë etnike e fetare.

Siguria e grupit lidhet më shumë me grupet pakicë (etnike, nacionale, fetare, etj.), që mund të diskriminohen nga grupi shumicë. Këtë e kanë ndier keqas mbi supet e tyre shqiptarët e Kosovës nën kolonializmin serb, por në mënyrë diku të hapur diku të fshehtë edhe shqiptarët në Maqedoni.

Siguria politike ka të bëjë me kushtet politike në të cilat jeton populli përkatës, nëse ai jeton apo jo në një shoqëri, që i respekton tërësisht liritë dhe të drejtat themelore njerëzore. Krimet e kryera ndaj popullsisë civile në Bosnjë dhe Kosovë,

në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të 20-të, të urdhëruara politikisht, janë dëshmia më tragjike e abuzimit të plotë me këtë përbërëse sa fundamentale, po aq dhe kapilare të sigurisë njerëzore.

Për Shqipërinë, infrastruktura e varfër apo, në përgjithësi, trashëgimia ekonomike nga sistemi komunist, por dhe krizat e ndryshme gjatë periudhës së tranzicionit, në një mënyrë apo një tjetër, janë shfaqur me dobësimin e masave të sigurisë për njerëzit sidomos për kategoritë më të varfra të popullsisë. Gjithashtu, gjatë dekadës së fundit, si rezultat i lëvizjes së lirë, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë është larguar nga zonat rurale dhe është vendosur në periferitë e qendrave kryesore urbane. Rezultati qe: një shtrirje e çrregullt në zonat urbane, shoqëruar me mangësi serioze për shërbime publike e mirëqenie sociale, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe higjiena publike, shkollimi dhe shëndeti, menaxhimi i mbeturinave të ngurta, etj. Paralel me këtë shtrirje në zonat urbane, nivelet e punësimit në sektorin privat edhe pse shënojnë rritje, nuk u përgjigjen kërkesave për punë, standardeve të sigurisë në punë apo mbrojtjes së mjedisit. Rendi publik në veçanti, si dhe siguria personale e kolektive, ndonëse të përmirësuara në shkallë të konsiderueshme, kanë ende shumë për të bërë për të arritur “standartet evropiane”. Shqetësuese po bëhen sidomos aksidentet rrugore afro dhjetë herë më të larta se ato në vendet e BE-së.

Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, është bërë një progres i konsiderueshëm në zbatimin e mjaft reformave strukturore dhe institucionale të domosdoshme për vendosjen e një ekonomie tregu funksionale dhe krijimin e një sistemi demokratik qeverisjeje. Në këtë mënyrë, pas një tranzicioni të vështirë, Shqipëria ka hyrë tashmë në *rrugën normale* të zhvillimit. Madje, sot, Shqipëria, nga një *konsumator sigurie* është shndërruar në një *prodhues sigurie* në rajon dhe më gjerë.

Prania e trupave paqeruajtëse të saj në Bosnjë, Afganistan, Irak, etj. flet mjaft qartë. Mbi të gjitha, roli i saj stabilizues, në një rrafsh rajonal, është shumë i rëndësishëm, të paktën dhe për këto arsye të tjera:

1. *Shpërhapja rajonale e popullsisë shqiptare.* Kjo shpërndarje dhe zëri relativisht i rëndësishëm i Shqipërisë për shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë, veçanërisht me solidaritetin e plotë dhe humanizmin e shfaqur gjatë krizës kosovare, është me një domethënie të konsiderueshme.

2. *Pozicioni gjeopolitik i Shqipërisë.* Shqipëria, duke qenë një portë konkrete midis detit Adriatik dhe Gadishullit të Ballkanit, mund të kanalizojë dhe të lehtësojë daljen si të Kosovës ashtu dhe të Maqedonisë në Adriatik.

3. *Modeli shumë pozitiv i bashkekzistencës e tolerancës fetare.* Shoqëria shqiptare ka mbështetur dhe zhvilluar historikisht tolerancën dhe bashkëjetesën fetare e etnike. Kjo përbërëse tejet e rëndësishme e sigurisë njerëzore ka nxitur, në mënyrë të brendshme e solidare respektin ndaj grupeve të ndryshme fetare dhe etnike, vetë fqinjëve. Njëkohësisht ky model shqiptar është dhe një kontribut tradicional e historik, por dhe mjaft aktual, në kuadër të plotësisimit sa më të mirë të parametrave të domosdoshëm të garantimit të sigurisë njerëzore, në kuadër të sigurisë rajonale e globale. Dhe kjo vlen të theksohet dhe në dokumentin e sigurisë.

“Operacionalizimi” i sigurisë njerëzore

Të gjithë këto elementë të sigurisë njerëzore, siç u theksua dhe më sipër, ndeshen dhe në dokumentet ekzistuese. Por çështja është se si mund të orientohen dhe të theksohen me mirë këto elementë, duke i dhënë dhe frymën vetë përmbajtjes së dokumentit, apo si mund të “operacionalizohet” në mënyrë konkrete agjenda për sigurinë njerëzore (ndryshe nga siguria shtetërore që perceptohet shumë më thjesht, të paktën në

variantin tradicional). Pavarësisht, nga rezultati i vështirë i këtij operacionalizimi, siguria njerëzore, mbetet të sfidojë në një mënyrë apo tjetrën konceptin tradicional të sigurisë kombëtare, duke u bërë paralelisht dhe pjesë inerente e sigurisë ndërkombëtare. Dhe në këtë kuptim krahas mekanizmave institucionale kombëtarë e ndërkombëtarë, ku përfaqësimet janë shtetërore, një rol në rritje duhet të marrin aktorë të tjerë, si NGO-të, media, etj., sidomos ata me shtrirje tejshtetërore e tejkombëtare. Po ashtu, ky koncept i sigurisë njerëzore, i shtrirë në një nivel rajonal e ndërkombëtar, duhet të përmbajë kontributin tonë modest dhe në fusha të tjera si në ndërhyrjet humanitare, kontrollin e armëve, eliminimin e minave kundër njeriut, reagimin ndaj abuzimit nga jashtë të mjedisit, shfrytëzimit të padrejtë të fuqisë punëtore, abuzimit me fëmijët, reduktimin e ndarjes teknologjike, që ka zëvendësuar atë ideologjike, etj. Nuk mund të mohohet se nëpërmjet një përpunimi të drejtë në nivel vendor, rajonal e global të sigurisë njerëzore mund të bëhet më e suksesshme lufta kundër trafikeve të ndryshme, krimit ekonomik e terrorizmit, por dhe të rriten kontributet vendore kundër ngrohjes globale, për shfrytëzimin me nikoqirllëk të rezervave energjetike, ujore, etj.

Çështje të tjera ideore

Në kushtet e sotme, gjithnjë në ndryshim e lëvizje të shpejtë, në azhurnimin e dokumentit bazë të strategjisë, nëpërmjet një pjesëmarrjeje gjithnjë e më të gjerë, duhen përpunuar detyrimisht dhe koncepte e ide të reja. Madje, këtij qëllimi i shërben dhe takimi i organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Prandaj, krahas problematikës së prekur më sipër mbi theksimin e aspiratave njerëzore për liritë dhe të drejtat e njeriut, konsolidimin e infrastrukturës institucionale demokratike, kontrollin dhe kufizimin

demokratik të pushtetit ekzekutiv, zgjerimin e peshës specifike të shoqërisë civile dhe të pjesëmarrjes qytetare, rritjen e rolit të konsumatorit dhe të përkujdesjes ndaj tij, etj., mendojmë se po aq thelbësor është për dokumentin e strategjisë dhe ridimensionimi i vetë konceptit të sovranitetit, “dobësimi” apo reduktimi, nga pikëpamja teorike e praktike, i mjaft përbërëseve të tij, në favor të rritjes së përbërëseve të ndërvarësisë. Për më tepër, në këtë rishikim, krahas kësaj ndërvarësie të kuptueshme dhe në rritje në të gjitha fushat, duhen analizuar e përfshirë, të paktën si “frymë”, edhe disa koncepte të tjera. Kështu, ndoshta, duhen mishëruar në tekstin e dokumentit të strategjisë koncepte të tillë janë si p. sh.: koncepti i sistemit të hapur, relativiteti i hapësirë-kohës, binomi ndërvarësi-sovranitet, pakthyeshmëria e proceseve makroskopike, etj.¹ Përfshirja e tyre veçse e pasuron përmbajtjen e këtij dokumenti, duke krijuar terrenin e duhur për rishikime më cilësore në një të ardhme të afërt.

¹ Për lexuesin e interesuar mund të jenë të vlefshme dhe komentet e mëposhtme:

- **Zhvillimi i një sistemi të hapur.** Aktualisht, shoqëria shqiptare, ndryshe nga një sistem i mbyllur në regjimin komunist, po zhvillohet si një *sistem i hapur*, që shkëmben, që jep e merr me një botë që ndryshon në mënyrë intensive, që komunikon shumë më mirë se dje, nëpërmjet kontakteve të shumëfishta njerëzore, ekonomiko-financiare e kulturore, fizike e elektronike. Po ashtu, është epërsia politike e padiskutueshme e sistemit të hapur, që lehtëson përshtatjen në mënyrë konkrete e të natyrshme të sistemit politik, ekonomik, arsimor, shëndetësor dhe atë të mbrojtjes së mjedisit, të ndihmës e përkrahjes sociale, me ekonominë e tregut dhe iniciativën e lirë, me sistemin global e instrumentet e tij. Madje, në kushtet e kësaj hapjeje, merr një rëndësi të veçantë edukimi profesional, jo thjesht për tregun shqiptar e rajonal, por dhe atë evropian, edhe pse kjo nuk është kuptuar ende drejt në Shqipëri!... Nga ana tjetër, është pa kuptim çdo “kompleks” e ndjenjë inferioriteti ndaj të “huajit të parë”, por dhe “yes-man”-i servil i politikës dhe qeverisjes në marrëveshjen e bashkëpunimit me kompani apo struktura të veçanta ndërkombëtare.

Ndërkohë që vlerë të veçantë duhet të ketë transparencën e gjithanshme e qeverisë ndaj qytetarit. Aktualisht, për banorët e politikanët e rajonit, pas euforisë, “naivitetit” politik dhe iluzioneve optimiste të fillimit, është e qartë se rregullat e ekonomisë së tregut dhe sistemet e hapura politike ndryshojnë tërësisht nga ato të ekonomive të mëparshme të komanduara dhe sistemet politike autoritare të mbyllura të partisë-shtet. Prandaj dhe nuk mund të imagjinohet që rregullat dhe kërkesat për ekonomitë tona të tregut dhe sistemet e reja të hapura politike në rajon, të mund të ngjasojnë menjëherë dhe *automatikisht* me ekonomitë e fuqishme të tregut dhe sistemet politike evropiane të hapura e të zhvilluara në një proces normal “tretjeje” shumë kohë më parë. Siç shihet, në një perceptim të tillë, pavarësisht arsyeve që gjithmonë mund të gjenden, ekziston dhe një *parakusht* i fortë, i cili mund të sjellë një tjetër vonesë të madhe në unifikimin e Ballkanit Perëndimor me familjen evropiane por, në të njëjtën kohë, mund të krijojë edhe një *hendek* mjaft të madh midis vetë BE-së dhe rajonit tonë. Për më tepër, procesi i integritit është më tepër sesa një *statistikë e thjeshtë*, më tepër se sa një *ushtrim* ekonomik apo financiar, më tepër se sa një *tërësi rregullash apo termash e paketash që shtohen çdo ditë*, por as një pozicion reminishent politik e gjeopolitik, etnik e fetar. Në fund të fundit, çdo mbyllje apo izolim pjesor brenda një rajoni, në kushtet e integritit-globalizimit, veçse “konservon” apo aktivizon mendësitë ekstremiste, radikale e nacionaliste të së kaluarës, frenon e pengon jo vetëm vendin përkatës, por dhe vendet përreth, duke krijuar kështu barriera artificiale, tensione, destabilizim politik, vonesa krejtësisht të padëshirueshme në realizimin sa më të plotë e të shpejtë të vetë procesit me vlera integruese-rajonale e euro-atlantike.

- **Relativiteti i hapësirë-kohës.** Revolucioni i paparë në teknologjitë e informacionit dhe të telekomunikimit, krahas dhe në bashkëshoqërim të procesit të globalizimit, është pasqyruar dhe me ndryshime të thella të përmasave hapësinore dhe kohore të veprimtarisë njerëzore. Në fakt, meqë koha në përshkrimin e ngjarjeve, në lëvizjen e ideve dhe njerëzve, të mallrave dhe kapitaleve, është reduktuar në mënyrë të ndjeshme, dhe vetë hapësira apo territori ka pësuar tkurrjen e tij. Me fjalë të tjera, kufijtë gjeografikë, shtetërorë apo kombëtarë midis çështjeve të brendshme dhe atyre globale në planin politik, ekonomik, kulturor, të sigurisë, etj., po bëhen gjithnjë e më “fluidë”. Gjë që në një mënyrë apo në tjetrën gjeneron një erozion gradual të konceptit të sovranitetit, e manifestuar në rastin më ekstrem me ndërhyrjen ndërkombëtare, apo përfshirjen në veprim të Gjykatës së Hagës.

- **Binomi ndërvarësi-sovranitet.** Kjo ndërthurje me vlerë të veçantë teorike e praktike synon të pajtojë kundërshtinë midis globalizimit me “kufij të

butë” apo pa kufij, nga njëra anë, dhe sovranitetit klasik, me “kufij të ngurtë” deri absolutë, nga ana tjetër. Ai nënkupton një zhvendosje të pushtetit nga autoriteti qendror në atë vendor, dhe zhvendosjen tjetër, për nga sipër, nga autoriteti qendror kombëtar në atë mbikombëtar, duke e përfshirë *vetëvendosjen* si një element plotësisht normal e demokratik të shprehjes së lirisë e të vullnetit popullor.

- **Pakthyeshmëria e proceseve makroskopike.** Bazuar në pakthyeshmërinë e proceseve makroskopike, në përgjithësi dhe atyre historiko-shoqërore në veçanti, proceset globalizuese si procese makroskopike, në një periudhë afatgjatë, janë vetëm të pakthyeshme. Si të tillë, çdo konceptim e projektim pozitiv i tyre në kohët e sotme i shërben më së miri të nesërme, duke pakësuar mundësitë e “zbythjeve” kohëshkurtra e vonesave lokale në ecjen përpara. Pjesë e kësaj pakthyeshmërie është dhe çështja e statusit përfundimtar të Kosovës e zhvillimi i saj si *shtet më vite*, përfshirë dhe ndërvarësinë perspektive euro-atlantike të saj.

- **Integrim i diferencuar, diferencim i integruar.** Siç po shihet, aktualisht, në Ballkan është ende mbizotërues konceptimi e realizimi i procesit *diferencial* mbi atë *integral*. Kjo është larg prirjes që, në një kohë të shkurtër, të arrihej balancimi e ndërthurja sa më e drejtë e pjesëve përbërëse të këtij rajoni në integrimet rajonale e euro-atlantike. Madje, ajo që po përjetojmë sot, është faza e një diferencimi të paintegruar. Kështu, është bërë diferencimi i parë me Slloveninë, Rumaninë e Bullgarinë lidhur me anëtarësimin në NATO; diferencimi i dytë me deklarimin e përfshirjes së Sllovenisë në BE dhe aktualisht anëtarësimi i Rumanisë e Bullgarisë në BE. Këto procese, si të veçuara, por dhe kufizimet shoqëruese, e bëjnë deri diku të drejtë shtrimin e problemit, madje dhe shqetësimin. Për më tepër, meqë proceset kanë filluar të zhvillohen jo në mënyrë *integrale*, por *diferenciale*, çdo vend ka qenë i detyruar, madje në kurriz të vendeve të tjera të rajonit, të nxjerrë e të realizojë sa më mirë detyrat e veta, gjë që pasqyrohet negativisht në proceset integruese rajonale, në zhvillimin e tregtisë dhe *lëvizjen e lirë* të qytetarëve të pjesëve të mbetura. Ndërkohë, që kërkohet një raport më frutdhënës e përfshirës, në dialektikën e *diferencim-integrimit*, në një kuadër më të përgjithësuar rajonal dhe jo duke lënë jashtë, në mjaft aspekte, qoftë dhe përkohësisht Ballkanin Perëndimor.

- **Koncepti integral i të drejtave të njeriut.** Koncepti i globalizim-integrimit po zhvillohet e jetësohet dhe si *koncept integral* i bashkëzistencës, i respektit për një etni, nacionalitet, komb apo grupim tjetër, e për më tepër edhe si një model i bashkëpunimit shumë planesh ndërshtetëror, ndërëtnik, ndërëfetar. Ky konceptim i ri nënkupton edhe të njëjtin standard ligjor e praktik midis vendeve e popujve, sidomos midis fqinjëve, ku shfaqen dhe

“heterogjenitetet” e ndryshme, lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, në përgjithësi, dhe të atyre të minoriteteve, në veçanti. Por jo kërkesa e pretendime me tepriçë, nga njëra anë, dhe mohim i të ngjashmeve, nga ana tjetër, siç po manipulohet jo pak edhe në rajon. Madje, në kushtet e globalizimit, bëhet më se normal e i domosdoshëm synimi drejt një *evolucioni* të ri të bashkëjetesës, që e shndërron atë nga një proces *shumëkulturore* në një proces *ndërkulturore*. Dhe mbi të gjitha duke mos spekuluar me pretendime “bajate” vetëdeklarimi kombësie, duke shfrytëzuar varfërinë, pensionimet e “çuditshme” apo marifete të tjera arkaike, etj.

László Póti

Kërkues i vjetër shkencor, Universiteti Kombëtar i Mbrojtjes Zrinyi Miklós,
Qendra për Studime Strategjike dhe të Mbrojtjes, Budapest

ANALIZË KRAHASUESE E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

I. Gjendja aktuale në fushën e dokumenteve kryesore strategjike

Strategjitë e sigurisë dhe dokumente të tjerë të sigurisë, që janë në fuqi në vendet e Ballkanit Perëndimor, janë miratuar vitet e fundit, por mënyra, institucioni miratues, dhe vetë tipat e dokumenteve përfaqësojnë variante nga më të ndryshmet. Në Shqipëri, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, u miratua në nëntor 2004 nga parlamenti, ndërsa në vitin 2005 u miratua Strategjia Ushtarake si variant i rishikuar i asaj të miratuar në 2002. Gjithashtu ekziston edhe një Libër i Bardhë për Mbrojtjen, miratuar në 2005.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, për herë të parë një dokument i Politikës së Mbrojtjes u miratua nga Presidenca e B-H në maj 2001, më pas një Libër i Bardhë mbi Mbrojtjen u miratua nga Presidenca në mars 2005, e cila u ndoq nga një dokument mbi Politikën e Sigurisë në shkurt të vitit pasardhës miratuar nga i njëjti institucion. Në Kroaci, parlamenti miratoi Strategjinë e Sigurisë Kombëtare në mars të 2002. Në të njëjtën kohë, u miratua edhe Strategjia e Mbrojtjes, ndërkohë, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (Strategic Defence Review) u hartua nga Ministria e Mbrojtjes në 2005. Koncepti i Sigurisë

dhe i Mbrojtjes Kombëtare të Maqedonisë u miratua në shkurt 2003, ndërsa si një dokument me karakter rajonal ne vlerësuam dhe morëm në konsideratë Librin e Bardhë mbi Mbrojtjen e Maqedonisë (tetor 2005) si dhe Kuadrin e Politikave për Buletinin Strategjik të Mbrojtjes (tetor 2003) mbi të cilin ai u bazua.

Në Mal të Zi, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë në qershor 2006 qeveria miratoi Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Serbia ende nuk ka një strategji specifike të sigurisë, vetëm se aty ekzistojnë tre dokumente që janë ende në fuqi si: Strategjia e Mbrojtjes së Unionit Shtetëror Serbi & Mal i Zi (2005) miratuar nga parlamenti, Libri i Bardhë mbi Mbrojtjen e këtij Unioni, hartuar nga Ministria e Mbrojtjes (2005), si dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, gjithashtu miratuar nga kjo ministri në 2006.

Duke marrë në konsideratë ndryshimet e shpejta në mjedisin e sigurisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe progresin në procesin e përafrimit të tyre me NATO dhe BE, shumica e këtyre dokumenteve të vendeve të rajonit, megjithëse të miratuara rishtazi, janë nën rishikim dhe dokumente të reja (të paemërtuara sepse ende nuk janë miratuar), ndërmjet të cilave, Strategjia Ushtarake e Shqipërisë e 2005 është duke u rishikuar; Strategjia e re e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Kroacisë, etj. janë nën përpunim dhe pritet të miratohen në gjysmën e dytë të këtij viti. Në Maqedoni, Koncepti i Sigurisë dhe i Mbrojtjes Kombëtare është në përpunim dhe për t'u zëvendësuar me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Republika e re e Malit të Zi është duke i shtuar Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, të miratuar vitin që kaloi, një Strategji të Mbrojtjes Kombëtare dhe së fundmi, Serbia është duke pritur miratimin e Strategjisë së re të Mbrojtjes, projekti i së cilës ka përfunduar tashmë së hartuari nga Ministria e Mbrojtjes. Njëkohësisht, Serbia është duke punuar

për integrimin në një të dy projekteve të hartuara te Strategjisë së saj të ardhshme të Sigurisë Kombëtare.

Këto dokumente të sigurisë së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dëshmojnë në një masë të konsiderueshme njëkohësisht edhe afërsi edhe diversitetet ndërmjet tyre. Për sa i përket afërsive mund të vërehet fakti se të gjitha janë miratuar kohët e fundit brenda një kohe të shkurtër dhe shumica prej tyre janë mbështetur në situatën aktuale të sigurisë. Numri i madh i dokumenteve krijon përshtypjen gjithashtu se vendet e rajonit kanë zhvilluar tashmë një sistem të zhvilluar të dokumenteve të sigurisë. Të gjitha shtetet kanë nga 1-3 dokumente të lidhura me sigurinë që përfshijnë nivele të ndryshme. Sipas terminologjisë së përdorur, gjithkush mund të dallojë tre tipa dokumentesh të niveleve të ndryshme:

- Strategji të Sigurisë Kombëtare;
- Strategji Ushtarake ose të Mbrojtjes;
- Libra të Bardhë/ Buletinë Strategjike të Mbrojtjes (strategic defence reviews).

Sistemi aktual i dokumenteve të sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor

Shqipëria	B-H	Kroacia	Maqedonia	Mal I Zi	Serbia
Strategjia e Sigurisë Kombëtare	Politika e Sigurisë së B-H	Strategjia e Sigurisë Kombëtare	Koncepti i Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare	Strategjia e Sigurisë Kombëtare	
Strategjia Ushtarake	Politika e Mbrojtjes e B-H	Strategjia e Mbrojtjes			Strategjia e Mbrojtjes e Unionit Shtetëror Serbi-Mal I Zi.
	Libër i Bardhë i Mbrojtjes	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes	Rishikimi Strategjik i Kuadrit i Politikave të Mbrojtjes; Libër i Bardhë i Mbrojtjes		Libër i Bardhë mbi Mbrojtjen e Unionit Shtetëror Serbi-Mal i Zi; Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

Për sa i përket nivelit të miratimit, i cili është një tregues i rëndësishëm i jetëgjatësisë dhe legjitimitetit, dokumentet ndryshojnë ndjeshëm, duke filluar nga miratimi parlamentar, tek ai presidencial e deri te miratimi i Ministrisë së Mbrojtjes.

Numri i madh i këtyre dokumenteve dëshmon edhe ndryshimet midis vendeve që analizohen. Në ndonjë rast vendi mund të ketë miratuar vetëm një dokument, (Mal i Zi), në ndonjë rast tjetër nuk ka dokument përfshirës, seria e dokumenteve strategjike fillon menjëherë me Strategjinë e Mbrojtjes (Serbi).

II. Interesat dhe vlerat

Dokumentet e sigurisë trajtojnë gjithashtu në një masë të caktuar çështjet e interesave dhe vlerave, por përgjithësisht ky trajtim zë një vend modest krahasuar me tekstin. Përgjithësisht dokumentet përcaktojnë interesat dhe vlerat kombëtare në një kuptim të gjerë duke mos i kufizuar me kontekstin e sigurisë. Këto dokumente pothuajse pa përjashtim përfshijnë (në ndonjë rast duke iu referuar edhe Kushtetutës së vendit) konceptet e mëposhtme: ruajtje të sovranitetit, integritetin territorial, zhvillimin dhe mbrojtjen e shtetit ligjor, institucionet demokratike, liritë dhe të drejtat e njeriut, prosperitetin dhe zhvillimin ekonomik etj.

Dokumentet i rendisin interesat dhe vlerat pa i prioritetizuar ato. Nga ky këndvështrim dokumentet e Maqedonisë dhe Kroacisë demonstrojnë një logjikë tjetër duke i prezantuar këto koncepte në një mënyrë të strukturuar. E para i klasifikon interesat kombëtare sipas nivelit të rëndësisë:

- Maksimalisht themelore;
- Afatgjata;
- Jetësore;
- Të rëndësishme,

ndërsa dokumenti kroat përdor kategoritë e mëposhtme:

- vlerat më të larta;
- interesat kombëtare jetësore;
- konsiderime të tjera.

Në mënyrë shumë interesante, Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Malit të Zi përdor një qasje tematike dhe i grupon interesat si interesa dhe objektiva politike, interesa ekonomikë, interesa të mbrojtjes, si dhe interesa ligjore, teknologjike apo mjedisore.

Pas nivelit abstrakt dhe deklarativ të interesave kombëtare qëndrojnë një sërë çështjesh që pothuajse trajtohen në të gjithë dokumentet dhe që përgjithësisht kanë një qasje të ngjashme. Ndër këto çështje është *stabiliteti rajonal* si një interes kombëtar. Mesazhi kryesor për këtë çështje që përcjellin të gjithë dokumentet është se vendet e rajonit janë të angazhuara për të kontribuar në mënyrë aktive për ruajtjen dhe forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në Evropën Juglindore (me formulime si “për të qenë faktor stabiliteti” në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë); “të konsiderohen si kontribues i paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore” te Libri i Bardhë i Maqedonisë, apo si “kontribues aktiv për ruajtjen e paqes dhe zhvillimit të një mjedisi të favorshëm sigurie” në Librin e Bardhë të Serbisë mbi Mbrojtjen. Çështja e *identitetit kombëtar* zë një vend të rëndësishëm midis vlerave që trajtohen në këto dokumente të sigurisë, duke pasur referime të tilla: “Zhvillimi i identitetit kombëtar” si në rastin e Shqipërisë dhe Kroacisë, “shprehja e lirë e përkatësisë kombëtare dhe ruajtja e forcimi i identitetit kombëtar dhe etnik” siç shkruhet në dokumentet e Maqedonisë, apo objektivi “i ruajtjes së shoqërisë multi-etnike” të shprehur në dokumentin e sigurisë kombëtare të Malit të Zi. Për më tepër, dokumenti shqiptar dhe kroat flet për “ruajtjen e identitetit dhe mirëqenies kombëtare” të bashkëkombësve të tyre që

jetojnë në vende të tjera. Më tej, me përjashtim të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë, të gjitha dokumentet e tjera strategjike trajtojnë ruajtjen e mjedisit si interes i sigurisë kombëtare, duke shfaqur një qasje moderne dhe të rëndësishme ndaj sigurisë.

Natyrisht, ka një sërë çështjesh gjithashtu mbi të cilat nuk ka qëndrime të përbashkëta, por shprehen qasje specifike kombëtare. Dy dokumente i referohen çështjes së “*ndryshimit të kufijve*”, ai shqiptar që kundërshton “ndryshimin e kufijve me anë të forcës” dhe Libri i Bardhë serb që i referohet dokumenteve të OSBE-së “për ruajtjen e kufijve aktuale”.

Koncepti i Sigurisë dhe i Mbrojtjes Kombëtare të Maqedonisë trajton disa çështje specifike si integrimi i brendshëm, përfaqësimi i barabartë i komuniteteve kombëtare, vetëqeverisje vendore, dhe ndërtimi i një shoqërie multietnike mbështetur në tolerancë.

Në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes së Serbisë, theks i veçantë vihet në nivelin e interesave dhe vlerave, në parimin që trupat e huaja mund të vendosen në një territor kombëtar nëse ka një mandat të Kombeve të Bashkuara dhe se qëllimi i tyre është paqeruajtës. Dokumenti malazez ka zgjedhur një element tjetër për të vendosur ndër interesat më të rëndësishme kombëtare, pikërisht atë se vendi ka vullnetin për të kontribuar “për stabilitetin dhe paqen jashtë kufijve të Malit të Zi nga... duke lejuar mundësinë e përdorimit të territorit, ajrit dhe detit të Malit të Zi, në mbështetje të misioneve të ndërmarra nga OKB, BE, OSBE, apo NATO”.

III. Vlerësimi i mjedisit të sigurisë

Dokumentet e sigurisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor përgjithësisht e përshkruajnë mjedisin e sigurisë në një mënyrë të ngjashme, duke përdorur terminologji moderne, duke e

interpretuar sigurinë ndërkombëtare në periudhën postbipolare si një fenomen kompleks (multidimensionale, sipas Strategjisë së Mbrojtjes së Kroacisë). Situata e sigurisë është karakterizuar gjithashtu si me një dinamikë ndryshimi, shpesh dhe të paparashikuar. Në mënyrë unanime NATO dhe BE konsiderohen si faktor bazë të stabilitetit, megjithëse vetë vendet e rajonit janë në faza të ndryshme të përpjekjeve integruese. Theks i veçantë në këto dokumente u vihet vlerave dhe objektivave të përbashkëta të vendeve të rajonit si dhe nevojës e aspiratës për bashkëpunim rajonal.

Kuadri analitik i mjedisit aktual të sigurisë gjithashtu dëshmon ngjashmëri. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë përcakton trashëgimin historike, rëndësinë gjeostrategjike, dhe fragmentarizimin etnik si faktor kyç në përcaktimin e situatës aktuale të sigurisë. Shumica e strategjive të sigurisë vënë theksin gjithashtu se tranzicioni i papërfunduar është një faktor tjetër i destabilitetit të mundshëm. Procesi i pajtimit përshkruhet si i papërfunduar gjithashtu, (dokumenti maqedonas përdor këtë term) dhe masat për rritjen e besimit luajnë rol thelbësor në çuarjen përpara të këtij procesi (siç e përmend dokumenti shqiptar).

Ballkani Perëndimor, për nga rëndësia dhe roli i veçantë për sigurinë, vlerësohet pjesërisht në mënyrë të ngjashme dhe pjesërisht me ndryshime në dokumentet, të cilave po i referohemi. Dokumenti shqiptar përdor termin “urëlidhje” që e bën rajonin të rëndësishëm, dokumenti boshnjak e përshkruan pozitën e vendit si “lidhëse midis rajonit të Danubit me rajonin e Adriatikut të Mesëm”, Koncepti maqedonas për Sigurinë dhe Mbrojtjen Kombëtare e cilëson mjedisin e afërt - në një mënyrë pak si të ekzagjeruar - “udhëkryq” ndërmjet Evropës, Azisë dhe Afrikës, ndërsa ai kroat e vendos vendin e vet si zotërues i një “pozite rajonale multidimensionale” duke pasur parasysh Evropën Lindore,

atë Juglindore, dhe rajonin e Mesdheut, si rajone së cilave Kroacia i përket njëkohësisht.

Formulime të ndryshme ka edhe për situatën aktuale të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Strategjia e Sigurisë së Kroacisë deklaron se Evropa Juglindore është “pika më e shqetësuar e kontinentit”, koncepti maqedonas për Sigurinë dhe Mbrojtjen Kombëtare formulon në mënyrë të ngjashme, duke vlerësuar se Evropa Juglindore mbetet “rajonin më i pastabilizuar në Evropë, ndërsa Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Serbisë e quan rajonin si “më pak të stabilizuar”, ku mundësia e përdorimit të forcës ende nuk është zhdukur në mënyrë përfundimtare.

Këto dokumente që po i referohemi, japin një pamje të veçantë të panoramës së përgjithshme të sigurisë. Strategjia shqiptare e Sigurisë p. sh. paraqet termin “faktori shqiptar” si një element i rëndësishëm i sigurisë, gjë e cila është shumë e vështirë për t’u interpretuar nga një lexues i huaj.

IV. Perceptimet e kërcënimeve

Dokumentet e sigurisë kombëtare i kanë kushtuar një pjesë relativisht të vogël në tekstin e tyre vlerësimit të kërcënimeve, sfidave dhe rreziqeve me të cilat përballen vendet. Por përveç problemit sasior, duket se ka edhe një problem cilësor. Me fjalë të tjera këto dokumente ndryshojnë ndjeshëm midis tyre për sa i përket mënyrës - nëse ka një mënyrë - të klasifikimit të kërcënimeve, sfidave dhe rreziqeve. Dy vende të rajonit (Shqipëria, B-H) dhe pjesërisht edhe Strategjia e Mbrojtjes së Kroacisë i klasifikojnë sfidat, kërcënimet dhe rreziqet në një mënyrë të strukturuar, duke përdorur tre nivele të analizës: lokale, rajonale, dhe globale. Dy vende të tjera (Maqedonia dhe Serbia) i referohen një mënyrë tjetër klasifikimi, duke

përdorur nivelin e intensitetit të treguesit, e kombinuar kjo me një qasje kronologjike (afatshkurtër - të mesëm dhe afatgjatë). Ndërsa, Serbia bën edhe një diferencim midis ushtarak dhe jo-ushtarak. Pjesa e vlerësimeve të risqeve e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Malit të Zi - e cila duhet thënë se është e dobët krahasuar edhe me standardet ballkanike - nuk bën asnjë përpjekje për të klasifikuar kërcënimet dhe sfidat. Dokumenti malazez as nuk i interpreton kërcënimet e përgjithshme të përmendura edhe në kontekstin e atij vendi. Një aspekt tjetër i problematikës së cilësisë së këtyre dokumenteve themelore është mungesa e prioritizimit, kur përmenden kërcënimet dhe sfidat, sikundër dhe nuk bëhet kurrfarë diferencimi ndërmjet kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave. Ndërsa krahasojmë perceptimet e kërcënimeve të këtyre dokumenteve, ne mbështetemi në klasifikimet e bëra në dokumentet më të mirëstrukturuara, duke zbatuar kategorizimin e kërcënimeve të brendshme, rajonale, globale dhe krahasuar ato me të tjerat.

IV. 1. Kërcënimet e brendshme

Në kuadër të kërcënimeve të brendshme, mund të identifikohen si kërcënimet dhe rreziqet të përbashkëta katër kategoritë e mëposhtme: krimi i organizuar, terrorizmi, fatkeqësitë dhe probleme të tranzicionit. Ia vlen të sqarojmë se dy kategoritë e para mungojnë tërësisht nga dokumentet boshnjake në kërcënimet e brendshme. Kur themi *krimi i organizuar*, dokumentet strategjike përgjithësisht i referohen formave të ndryshme të trafikeve ilegale (drogave, trafikimit të qenieve njerëzore, agjentëve biologjikë dhe nuklearë, armëve konvencionale dhe armëve të shkatërrimit në masë, si dhe përdorimit strategjik apo dyfish të materialeve), e njëkohësisht duke iu referuar rrezikut të bashkërendimit me korrupsionin e mundshëm, si në rastin e dokumenteve të

Serbisë. Në kategoritë e *fatkeqësive*, dokumentet listojnë përgjithësisht fatkeqësi ekologjike, teknike dhe epidemike. Përveç të tjerash, në këtë listë Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Kroacisë, në mënyrë të qartë përmend zjarret e pyjeve si një burim i mundshëm fatkeqësish. *Problemet e tranzicionit* trajtohen në një mënyrë shumë të detajuar në shumë dokumente, në mënyrë të veçantë në atë boshnjak. Ky i fundit përmbledh sfidat politike të tranzicionit si për shembull: zhvillimi i ngadaltë i autoritetit të ekzekutivit, legjislativit, dhe sistemit të drejtësisë, aspekteve ekonomike të tranzicionit, si niveli i ulët i investimeve, ekonomia gri, tregu i zi dhe ritmi i ulët i privatizimeve. Koncepti i Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare të Maqedonisë ofron një interpretim të veçantë të problemeve që kanë shoqëruar tranzicionin, duke përfshirë elemente si terrorizmi urban, krime të rënda si për shembull kërcënimi, pengmarrjet, vrasjet dhe sumet mbi pronat e qytetarëve, në këtë mënyrë duke ofruar një qasje të sigurisë së atdheut (homeland security).

Dokumentet e ndryshme të strategjive kombëtare ofrojnë edhe karakteristika të veçanta në lidhje me sigurinë e brendshme. Në rastin e Shqipërisë, theks i veçantë i është vënë problemeve demografike, si për shembull migrimit ilegal të qytetarëve shqiptarë në vendet të tjera, apo “lëvizjes së pakontrolluar të popullsisë” brenda vendit. Ndërsa dy nocione të tjera japin një perspektivë pak a shumë konfuze për sigurinë e brendshme të Shqipërisë: “keqinformimi i opinionit publik” dhe “zhvillimi i pamjaftueshëm i arsimit, shkencës kulturës”. Trashëgimia e konflikteve të armatosura në Bosnjë 1992-1995 ka lënë gjurmën e vet edhe në dokumentet strategjike të Bosnjës, duke cituar “mbeturina të armiqësive politike e sociale” të konfliktit, zbatimi i ngadaltë i Marrëveshjes së Dejtonit, burime financiare të pamjaftueshme për të realizuar një kthim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur dhe

refugjatëve, si edhe “armatime dhe municione të magazinuara në vende të papërshtatshme” dhe ekzistenca e minave të pashpërthyer në tokën boshnjake. Si dokumenti strategjik kroat, ashtu edhe Koncepti i SMK të Maqedonisë, përcaktojnë krimin kibernetik (IT), respektivisht terrorizmin IT si dhe abuzimin me të dhënat personale të qytetarëve si kërcënime të sigurisë së brendshme. Dokumentet strategjike të Maqedonisë kanë si veçori të tyre referimin ndaj veprimtarive armiqësore të forcave speciale të huaja “të drejtuar drejt përkeqësimit të situatës së sigurisë, duke ulur ritmin e proceseve integruese e demokratike”. Nga ana tjetër, strategjia e sigurisë malazeze - ndërmjet shtatë kërcënimeve serioze të sigurisë - dallon një kategori të errët dhe të paqartë “të aktiviteteve të individëve dhe grupeve që thyejnë ligjet e Malit të Zi”, në këtë mënyrë ngatërron vijat ndarëse midis linjave të sigurisë së brendshme dhe kriminalitetit individual. Së fundmi, për sa i përket Serbisë, dy çështje të lidhura me njëra-tjetrën mund të identifikohen si kërcënime të brendshme të sigurisë: “rebelimi i armatosur, si një formë specifike të konfliktit të armatosur të motivuar nga një përpjekje jokushtetuese dhe të dhunshme për ndryshimin e kufijve”, dhe e dyta “çështja e pazgjidhur e Kosovës dhe Metohisë”.

IV. 2. Kërcënime rajonale

Krahasuar me kërcënimet e brendshme, dokumentet strategjike të rajonit janë më homogjene dhe kanë më shumë ngjashmëri për sa i përket aspekteve të ndryshme të vlerësimit të kërcënimeve rajonale të sigurisë. Analiza në nivel rajonal të dokumenteve të sigurisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor, identifikon aspektet e mëposhtme të perceptimeve të sigurisë:

- Mundësia e konflikteve të armatosura në rajon;
- Trashëgimia e konflikteve të fundit/faktor historike;
- Mungesa e stabilitetit rajonal dhe krizat;

- Probleme të tranzicionit;
- Ekstremizmi dhe intolerancë,
- Krimi i organizuar;
- Terrorizmi.

Vlerësimi i *kërcënimit të konflikteve të armatosura konvencionale* në rajon ndryshon nga njëri dokument te tjetri. Ka disa që e vlerësojnë mundësinë e një konflikti të armatosur si të ulët dhe të kufizuar, (Libri i Bardhë mbi Mbrojtjen e B-H: “virtualisht nuk ka rrezik të një agresioni të jashtëm, në të ardhmen e afërt”); SSK të Kroacisë: “rreziqet ushtarake në rajon janë kufizuar shumë për një periudhë më të gjatë kohe... Mundësia e një konflikti ndërmjet shteteve është minimizuar”; SSK të Shqipërisë nuk shfaq pozicion në lidhje me këtë çështje, por, deklaron në një mënyrë pak a shumë abstrakte faktin se përdorimi i forcës ushtarake është “një rrezik për Republikën e Shqipërisë”. Nga ana tjetër, ka dokumente që e konsiderojnë si realist një konflikt të tillë të mundshëm (Koncepti i SMK të Maqedonisë: “Konfrontimet nacionale, religjioze, të shtetit më të madh, dhe territoriale janë të mundshme dhe rreziqe realiste që mund të çojnë në kriza e konflikte”; Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes të Serbisë “...ndërhyrjet ushtarake në dem të Republikës së Serbisë është pak e mundshme për të ndodhur...”, ndërsa në Strategjinë e Mbrojtjes së Unionit Serbi & Mal i Zi thuhet: “Sfidat, risqet dhe kërcënimet ushtarake ... Janë reduktuar, por jo plotësisht përjashtuar”).

Me përjashtim të Malit të Zi, të gjitha vendet e konsiderojnë *trashëgiminë e konflikteve të fundit dhe faktorët historikë* si aspekte të rëndësishme të perceptimeve të kërcënimeve rajonale. Dokumenti shqiptar (Strategjia Ushtarake) e vendos theksin në problemet e pavendosura që burojnë nga një histori komplekse, ai boshnjak i referohet “rrezikut latent dhe problemeve të mëdha brenda disa vendeve apo midis vendeve të rajonit” (DP), si dhe faktit që “rajoni ka qenë skenë e

konflikteve të ndryshme që kanë lënë pasojë ekonomike, psikologjike, sociale e të tjera”. Ndërsa, Libri i Bardhë i Maqedonisë i referohet “dekadave të armiqësive dhe mospërfundimit të procesit të pajtimit”; ai serb i referohet “trashëgimisë negative të luftërave” (Libri i Bardhë), si dhe faktit se “marrëdhëniet midis vendeve të ish-Republikës Federative Jugosllave janë të ngarkuara me mungesë besimi, mbylljes së ngadaltë të çështjes së kthimit të refugjatëve ... si dhe konfirmimin e ngadaltë të përgjegjësive për krimet e luftës, mosmarrëveshje territoriale të pazgjidhura”... as well as slow confirmation for responsibility for war crimes, unresolved territorial disputes” (RMS).

Mungesa e stabilitetit rajonal dhe krizat konsiderohen përgjithësisht si burime të mundshme të kërcënimeve, por thekset në këto dokumente janë vendosur në çështje të tjera. SSK të Shqipërisë e shikon këtë problem në kontekstet e nacionalizmave dhe të konflikteve etnike, ndërsa dokumenti i Politikave të Mbrojtjes së Bosnjës e shikon nën një vështrim tjetër, atë të rolit të “fuqive të mëdha për të ushtruar influencë politike”, si dhe të përpjekjeve për “ndërprerjen e autonomisë dhe pavarësinë e grupeve të caktuara etnike, të cilat, ndërthurur me një përqendrim relativisht të lartë të kapaciteteve ushtarake, e bëjnë situatën e përgjithshme edhe më komplekse” (Libri i Bardhë). Ndërkohë, SSK të Kroacisë tërheq vëmendje te një numër faktorësh që mund të çojnë në një krizë rajonale, si p. sh. “konflikte rajonale interesash për të siguruar kontrollin mbi rrugët e tranzitit të burimeve natyrore”, probleme të tranzicionit, çështje kufijsh midis ish-shteteve RFJ dhe krizat e refugjatëve.

Për sa i përket *problemeve të tranzicionit*, të gjitha vendet i referohen vështirësive ekonomike, politike dhe sociale si burime potenciale të destabilitetit.

Faktori tjetër që influencon destabilitetin rajonal ka të bëjë me *ekstremizmin dhe intolerancën*. Konkretisht, të gjitha

dokumentet i referohen fenomeneve në një kontekst nationalist, etnik, dhe fetar. SSK të Kroacisë paralajmëron kundër “zgjidhjeve unilaterale” të çështjeve të minoriteteve.

Krimin e organizuar dhe terrorizmin të gjitha shtetet e shikojnë, përveçse si një kërcënim të brendshëm, edhe si kërcënim rajonal, duke e laboruar këtë nga dy shtete në mënyrë më të detajuar. SSK të Shqipërisë shkruan se për shkak të pozicionit gjeo-strategjik të Shqipërisë, vendi përdoret si “rrugë logjistike dhe komunikimi”, ndërsa Libri i Bardhë i Bosnjës, në të njëjtën linjë, e konsideron rajonin me terma si rrugë të tranzitit për grupe terroristësh dhe të materialeve për aktivitete terroriste. Dokumenti i Politikës së Sigurisë së Bosnjës identifikon terrorizmin si një nga kërcënimet më të mëdha për stabilitetin e rajonit e të B-H, dhe më poshtë shton se “po bëhen gjithmonë e më të qarta tendencat e disa grupeve terroriste për të fituar terren në disa vende ku nuk kanë qenë të pranishëm më përpara, të lidhen atje me njerëz me të njëjtat pikëpamje dhe të gjejnë streha e të fshehin aktivitetin e tyre”.

IV. 3. Kërcënimet globale

Më poshtë renditen karakteristikat e përbashkëta të perceptimit të kërcënimin në nivel global të dokumenteve të sigurisë së vendeve të rajonit:

- Terrorizmi;
- Krimi i organizuar;
- Përhapja e armëve konvencionale dhe ato të shkatërrimit në masë (WMD);
- Sfida mjedisore përfshirë probleme të burimeve natyrale;
- Ekstremizmi,

por, këto dokumente nuk përcaktojnë ndonjë ndarje prioritare të tyre.

Terrorizmi si një kërcënim global vlerësohet pa përjashtim nga të gjitha dokumentet kombëtare, megjithatë, në asnjë prej

tyre nuk elaborohet kjo çështje e rëndësishme. E njëjta situatë qëndron edhe *me krimin e organizuar*, sepse shumica e dokumenteve nuk e trajtojnë këtë çështje në mënyrë të detajuar, por në mënyrë të përgjithshme e lidhin problematikën me forma të ndryshme të trafikeve ilegale. Të gjitha dokumentet trajtojnë çështjen e përhapjes së *armëve të shkatërrimit në masë (WMD)*, por në disa raste kjo është bërë duke e vendosur këtë çështje në një kontekst specifik. Strategjia e Mbrojtjes së Kroacisë e lidh përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë me qëllime terroriste, ndërsa Strategjia e Mbrojtjes së Serbisë e konsideron me të njëjtën rëndësi si përhapjen e armëve konvencionale ashtu edhe ato të shkatërrimit në masë, ndërsa dokumentet boshnjake i qasen kësaj çështje në një kontekst më të gjerë, dhe konkretisht “prodhimin dhe tregtimin të pakontrolluar”. Për sa i përket *sfidave mjedisore*, dallohen tre fusha kryesore të shqetësimeve: ndotja e mjedisit, degradimi i mjedisit dhe ndryshimet klimaterike, fatkeqësitë si pasojë e tyre, duke përfshirë edhe ato të shaktuara nga njeriu, ashtu si dhe probleme të *rënies apo mungesës së aksesit në burime natyrore strategjike*. Në lidhje me këtë çështje, SSK të Shqipërisë veçon si një sfidë të veçantë “reduktimin e burimeve ujore”, ndërsa KSSM të Maqedonisë formulon mundësinë e “përplasjes së interesave për përdorimin e burimeve dhe rrugëve të materialeve energjetike strategjike”, ashtu si dhe “pengimin apo bllokimin e importit të tyre në Maqedoni”. Me përjashtim të dokumenteve shqiptare, të gjitha të tjerat adresojnë problemin e *ekstremizmit* duke iu referuar në mënyrë të përgjithshme intolerancës etnike, fetare, raciale dhe politike, impaktit të ideologjive ekstreme, ekstremizmit të dhunshëm, ndërkohë që p. sh. Strategjia e Mbrojtjes së Kroacisë përdor një këndvështrim tjetër, duke nënvizuar problemet e proceseve demokratizuese, të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve etj., në përputhje

me problemet e diskriminimit që përmenden nga Politikave të Sigurisë së Bosnjës.

Ka, gjithashtu, një sërë çështjesh që janë trajtuar vetëm në disa dokumente. Migracionit p.sh, i referohen si “migracion me forcë i shkaktuar nga situata ekstreme” (PM, B-H), “ekspansion demografik dhe migracion” (SM, Kroaci), “migracion ilegal” (KSMM, Maqedoni), “migracion i pakontrolluar dhe masiv” (LB, Serbi) (Serbian WP). Për më tepër, në kuadër të pasojave negative të globalizimit, dokumenti i Politikave të Sigurisë së Bosnjës i referohet “rritjes së ndryshimeve në zhvillimin ekonomik dhe social midis vendeve të pasura të botës dhe atyre të varfra”, ndërsa, SM të Kroacisë përmend zhvillimin ekonomik asimetric midis vendeve të ndryshme të botës si një sfidë sigurie. Ndërsa, dokumenti për RSM të Kroacisë veçon komunikimin dhe teknologjitë kompjuterike si burim të një shqetësimi global të sigurisë, në një kohë që Libri i Bardhë i Serbisë i referohet “abuzimit me teknologjitë e reja dhe me arritjet e shkencës në fushat e informatikës, inxhinierisë gjenetike, mjekësisë dhe meteorologjisë”. Dokumentet e sigurisë së Serbisë janë unike në aspektin e marrjes parasysh të mundësisë të një konflikti global të armatosur.

V. Bashkëpunimi rajonal në fushën e sigurisë

Dokumentet e strategjive të sigurisë i kushtojnë nivele të ndryshme vlerësimit çështjes së bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë. Në rastin e Shqipërisë e ashtuquajtura “çështje kombëtare shqiptare” vendoset midis prioriteteve më të larta në objektivat strategjike të sigurisë dhe sugjerohet se “çështja kombëtare shqiptare do të arrihet përmes integritimit evropian dhe Euro-Atlantik të vendeve të rajonit”. Me

përjashtim të kësaj ky dokument strategjik nuk merret më me çështjen e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë.

Dokumenti boshnjak nuk i kushton ndonjë trajtim specifik dhe konkret kësaj çështje, përveçse në një paragraf hidhet pak dritë, me referenca të vogla, qasjes së bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë. Ndërsa, në dokumentin që merret me politikën e mbrojtjes deklarohet se B-H është “e angazhuar të promovojë rolin dhe rëndësinë e saj në bashkëpunimin rajonal”, duke iu referuar në mënyrë të veçantë zbatimit të Marrëveshjes për Kontrollin Rajonal të Armëve”. Në një vend tjetër, midis parimeve të politikës së mbrojtjes, gjendet një deklaram për “balancën e forcave dhe aftësive në...Evropën Jug-Lindore”.

Kroacia është vendi, ku strategjia e sigurisë kombëtare i kushton vëmendjen e duhur dhe shpjegon qëllimet e politikës së sigurisë rajonale. Bashkëpunimi rajonal për herë të parë përmendet ndër parimet kryesore të sigurisë kombëtare në kontekstin e kërcënimeve rajonale të sigurisë, e më pas, në një nënkaptull që merret me marrëdhëniet e fqinjësisë dhe ato rajonale, dokumenti thekson se bashkëpunimi rajonal është “një komponent i rëndësishëm i politikës së jashtme të Kroacisë”. Këtu, edhe një herë, theks i vendoset vetëperceptimit kroat si “identitet multi-rajonale, dhe pasi përmend iniciativat ekzistuese rajonale, dokumenti shpreh interesin kroat në “thellimin e të gjitha formave të bashkëpunimit” në rajon. Është me interes të përmendet, se për sa i përket misionëve paqeruajtës ndërkombëtare, gatishmëria kroate “për të marrë pjesë në njësi ushtarake të përbashkëta” i referohet në mënyrë ekskluzive “Lidhjes Veriore” të identitetit multi-rajonale, d. m. th. vendeve të Evropës Qendrore, duke përjashtuar mundësinë për një përpjekje të përbashkët ballkanike.

Koncepti i Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare të Maqedonisë është shumë i mjegullt në fushën e

bashkëpunimit rajonal (por edhe në çështje të tjera). Ai i referohet kësaj çështjeje në një mënyrë deklarative që nënkupton interesin në “thelimin dhe gjetjen e formave të reja të bashkëpunimit”. Vetëm një moment dhe pikërisht ai që e vë theksin në “kujdesin për mbrojtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të lirive dhe të drejtave të minoritetit maqedonas që jeton në vendet fqinjë” e bën këtë dokument të veçantë nga të tjerët.

Leximi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Malit të Zi, të jep përshtypjen se ky vend është vendosur jo në një mjedis rrethor rajonal, drejtpërsëdrejti si pjesë e gjithë botës. Në këtë dokument të shkurtër, niveli rajonal përmendet dy herë në kontekstin e kërcënimeve të mundshme që burojnë nga procesi i tranzicionit. As që përmendet fare bashkëpunimi rajonal i sigurisë.

Dokumenti i Rishikimit të Mbrojtjes Strategjike të Serbisë i kushton dy paragrafe kësaj çështjeje duke deklaruar se “vendi është aktiv në iniciativat dhe programet rajonale”. Për më tepër, dokumenti shpreh pikëpamjen se “menaxhimi i përbashkët i krizave dhe vendosja e mekanizmave rajonale për parandalimin e kërcënimeve dhe rreziqeve përbëjnë kushte të rëndësishme për konsolidimin e sigurisë”.

VI. Konkluzione

Gjatë gjysmës së dekadës së fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë përpunuar një numër impresionues të dokumenteve strategjike të sigurisë. Këto dokumente - në shumicën e rasteve - përbëjnë një sistem shumëshkallësh të qasjeve strategjike, duke zbatuar tre nivel standarde të këtyre dokumenteve si për shembull, strategji të sigurisë kombëtare, strategji ushtarake apo të mbrojtjes, libra të bardhë apo

rishikime të mbrojtjes. Për më tepër, këto dokumente janë rishikuar apo rifreskuar në mënyrë konstante.

Krahasimi i tipave të këtyre dokumenteve lë lidhje me strukturën e përmbajtjes, tematikës, nivelit të miratimit e të tjera të lë përshtypjen e përgjithshme se ndryshimet dhe diversiteti mbizotëron mbi të përbashkëtat dhe ajo që është më e rëndësishme është fakti se shkrimi i tyre nuk është mbështetur në ndonjë model të unifikuar.

Kur vlerësohet mjedisi i sigurisë, dokumentet strategjike dallohen për dy çështje që nënvizojnë rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor. E para, - të paktën në sytë e një vëzhguesi të jashtëm - ka një vetëperceptim të ekzagjeruar se rajoni është një “udhëkryq” mjaft i rëndësishëm midis kontinenteve dhe se luan një “rol urëlidhës” duke të krijuar përshtypjen se “rajoni në tranzicion” është në realitet një “rajon i tranzitit”. Së dyti, në mënyrë me realiste, dokumentet deklarojnë unanimisht se kjo pjesë e Evropës është rajoni me problematik dhe i paqëndrueshëm.

Për sa i takon çështjes thelbësore, d. m. th., atë të perceptimeve të sigurisë, me përjashtim të terminologjisë moderne dhe gjatësisë së këtyre dokumenteve, niveli i përpunimit është në një fazë shumë fillestare. Problemet kryesore janë si më poshtë:

- mungesë diferencimi midis sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve;
- mungesë klasifikimi i sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve;
- mungesë prioritizimi i kërcënimeve;
- mungesë dallimi midis niveleve të ndryshme (të brendshme, rajonale, globale);
- mungesë interpretimi të kërcënimeve të reja në kontekstin lokal, (p. sh. terrorizmin);
- ngatërrim konceptesh bazë, p. sh. siguri kolektive përkundrejt mbrojtje kolektive.

Duke krahasuar analizat dhe tre nivelet e sigurisë - të brendshme, rajonale dhe globale - ndihet një tendencë se sa më shumë ngjitemi lart, kërcënimi i sigurisë bëhet më i njëjtë. Me fjalë të tjera, në nivelin e brendshëm gjendet një pamje me shumë ngjyra, ndërsa në planin rajonal kërcënimet bëhen më homogjene, ndërkohë që në planin global ato pothuajse koincidojnë me njëra-tjetrën. Nëse do të krahasonim perceptimet e kërcënimeve të dokumenteve nga një këndvështrim “sektorial” konkluzioni themelor është se kërcënimet ushtarake zënë një pozicion të marginalizuar në të gjitha nivelet e analizës, dhe se problemet e politikës mbeten thelbësore për sigurinë. Problemet e sigurisë të karakterit ushtarak janë relativisht më të rëndësishme te niveli rajonal. Ndërsa, një konkluzion dekurajues rezulton në krahasimin e analizës së bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë. Dokumentet e strategjive të vendeve të rajonit nuk përcjellin ndonjë koncept të këtij bashkëpunimi, gjë që dëshmon mungesën e një interesi të vërtetë për të zhvilluar një bashkëpunim më të thellë në planin rajonal.

Prof. dr. Kastriot Islami

STRATEGJIA E SIGURISË KOMBËTARE NË KONTEKSTIN E RREZIQEVE DHE KËRCËNIMEVE RAJONALE

Në dokumentin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare pasqyrohen zhvillimet e politikave shtetërore për sigurimin e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit demokratik shqiptar ndaj kërcënimeve e rreziqeve të brendshme dhe të jashtme. Rreziqet e kërcënimit e jashtme, me karakter transnacional, mund të jenë me natyrë globale e rajonale. Dhe në më të shumtën e rasteve këto përbërëse rezultojnë të ndërthurura fuqimisht midis tyre. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, tipike janë kërcënimet/rreziqet kryesore me natyrë etnike, të cilat janë prezente pothuajse në të gjithë vendet e rajonit.

Zhvillimet botërore dhe rajonale në fillim të mijëvjeçarit të ri kanë përcaktuar parametra të rinj në mjedisin strategjik ndërkombëtar të sigurisë. Këto zhvillime kanë ndikuar ndjeshëm në ndryshimin e politikës dhe mjedisit të sigurisë. Trafiku i qenieve njerëzore, i armëve dhe i lëndëve narkotike, krimi i organizuar, terrorizmi dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë janë shfaqur si dukuri e sfida transnacionale, duke rritur kështu rreziqet dhe kërcënimet edhe në nivel rajonal, të cilat rezultojnë jo rrallë të shfaqen si pjesë e dukurive globale. Në këtë kontekst, krahas përcaktimit të konceptit dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare të

Sigurisë është e nevojshme të studiohet mjedisi i sigurisë dhe rreziqet e kërcënimeve që ndikojnë në arritjen e parametrave të sigurisë kombëtare. Por duhet pasur parasysh se faktorët që paraqesin problem për sigurinë do të quhen kërcënime, kërcënime potenciale apo rreziqe në varësi të intensitetit të tyre. Në rast se kërcënimet apo rreziqet prekin ekzistencën apo normalitetin e shumicës së vendeve të rajonit, atëherë ato quhen kërcënime/rreziqe rajonale.

Politikat e sigurisë së vendeve të Evropës Qendrore e Lindore mund të përcaktohen më saktësisht përmes dy koncepteve, evropianizimit dhe rinacionalizimit, në kuptimin që çdo shtet ish-komunist, pas rënies së murit të Berlinit, përcaktoi synimin e ndërtimit të shtetit demokratik, të bazuar në shtetin ligjor e ekonominë e tregut dhe objektivin e integritetit në BE e NATO. Ndërkohë të gjithë këto shtete, të çliruara nga koncepti i sovranitetit të kufizuar riformuluan interesat e tyre kombëtare, duke ripërcaktuar njëkohësisht politikat e jashtme dhe të sigurisë.

Në SSK të Shqipërisë thuhet se “Destabilizimi i rajonit nëpërmjet ringjalljes së dëshirës për realizimin e ndjenjave nacionaliste dhe e zhvillimit të konflikteve etnike përbën rrezik transnacional ndaj sigurisë së Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë vendosja e një raporti të drejtë koherence midis proceseve të evropianizimit dhe rinacionalizimit për secilin shtet do të funksiononte të drejtë të rritjes së sigurisë, ndërkohë që inkoherenca do të rrezikonte e kërcënonte sigurinë, bile deri rajonale. Shqipëria duket më shumë e fokusuar në procesin e evropianizimit, ndërkohë që edhe vetë “çështja kombëtare” synohet të zgjidhet përmes procesit të evropianizimit të Shqipërisë dhe të secilit vend ku është prezent faktori shqiptar. Të gjithë forcat politike në Shqipëri janë të artikuluara qartësisht për këtë mënyrë të zgjidhjes së “çështjes kombëtare”, e cila do të garantonte rritjen e sigurisë

rajonale dhe integrimin e vendit në BE e NATO, gjë që përbën dhe objektivin prioritar të shoqërisë shqiptare.

Një vështrim i shkurtër dhe i shpejtë i konfiguracionit të sigurisë në nivel rajonal do të ndihmonte përcaktimin e masave të nevojshme, në kuadër të përditësimit të Strategjisë së sigurisë Kombëtare. Rajoni më i afërt ku bën pjesë Shqipëria është Ballkani Perëndimor, si pjesë e Evropës Juglindore.

1. Nocioni i Ballkanit Perëndimor

Ish-Jugosllavia, në formën e bashkëjetesës kryesisht të sllavëve të jugut se do të mund të ekzistonte për rreth 70 vjet. Vetëm faktori shqiptar do të ishte relativisht i panatyrshëm për këtë bashkëjetesë, e cila mbështetej në mirëkuptimin e popujve që ndanin identitetet gjuhësore e kulturore pothuajse të njëjta dhe kërcënim nga vendet humbëse të Luftës së Dytë Botërore apo më tej nga synimet e Bashkimit Sovjetik. Konfederata jugosllave do të ishte një zonë ndërmjetëse ekuilibruese për Evropën, e ndërtuar me konsensusin e vendeve fituese të Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Në vitet 1990 këto kërcënime që impononin bashkëjetesën nuk do të ishin prezente, dhe për rrjedhojë do të fillonte dizintegrimi i ish-Jugosllavisë.

Themeluar kryesisht mbi vendet e dala nga dizintegrimi i ish-Jugosllavisë, Ballkani Perëndimor është indentifikuar si një rajon me përzierje e ndarje etnike, fetare e kulturore të konsiderueshme, një rajon me histori të lashtë e tradita të pasura, një rajon me prapambetje në zhvillimin ekonomik, një rajon me tradita të pakta demokratike, një rajon të cilin zhvillimet historike e kanë përcaktuar si një zonë me konflikte e tensione të shpeshta, si një truall ballafaqimesh dhe krizash. Natyrisht ky kompleksitet lidhet edhe me faktin se rajoni ka një pozicion të rëndësishëm gjeostrategjik, ka shërbyer si një

urë lidhjeje mes lindjes e perëndimit dhe për rrjedhojë historikisht ka qenë i përfshirë në konfiguracionin e influencave dhe të interesave të aktorëve të rëndësishëm globalë.

Në një këndvështrim tjetër, Ballkani Perëndimor mund të konsiderohet më tepër një nocion politik sesa gjeografik, një gjetje e përshtatshme për të argumentuar “qasjen rajonale” të integritit të vendeve ballkanike në BE dhe NATO, për shkak të situatave multi-etnike në pothuajse të gjithë vendet e tij dhe të ndërlidhjeve të fuqishme, po me natyrë etnike, midis tyre. Në Ballkanin Perëndimor, futen tanimë të gjithë njësitë e ish-Jugosllavisë, duke lënë jashtë Slloveninë dhe përfshirë Shqipërinë. Megjithatë ka një dallim midis hapësirës ish-jugosllave dhe Ballkanit Perëndimor, jo vetëm nga përbërja, por edhe nga tipi i krizave që ka kaluar secili vend në këtë rajon.

Ballkani Perëndimor është rajoni më i afërt për Shqipërinë, ku konfigurohen kërcënimet e rreziqet rajonale më të mundshëm dhe intensivë për vendin tonë, deritanimë edhe konfliktet kryesisht me natyrë etnike. Në këtë kontest, të gjithë pjesët e ish-Jugosllavisë, do t’i përcillnin Ballkanit Perëndimor karakteristikat e problematikës komplekse e të komplikuar, kryesisht me natyrë etnike, që shoqëruan zbërthimin e ish-Jugosllavisë. Në kuadrin e dy proceseve të evropianizimit e të nacionalizimit të vendeve të ish-Jugosllavisë, Shqipëria do të rezultonte e implikuar në mënyrë indirekte në këtë problematikë për shkak të ekzistencës së faktorit shqiptar në dy shtete të rinj të pavarur, Maqedoni e Mal i Zi dhe në Kosovë që pret të pavarësohet përmes një procesi tepër kompleks.

2. Zhvillimet kryesore në Ballkanin Perëndimor

Konfliktet ballkanike të viteve '90, dekompozimi i ish-Jugosllavisë, vështirësitë e krijimit të shteteve të reja multi-etnike, problematika komplekse e tranzicionit drejt shoqërisë

demokratike, vështirësitë dhe vonesat objektive e subjektive dhe lidhjet e vjetra e balancat e reja të interesave të aktorëve globalë e të rëndësishëm në rajon, e me vendet e rajonit kanë përcaktuar hartën e re të kërcënimeve e të rreziqeve rajonale e njëkohësisht e kanë ekspozuar më tepër rajonin para sfidave dhe kërcënimeve të reja transnacionale duke e bërë vulnerabël ndaj dukurive negative dhe prezantuar sfida të reja, komplekse e të sofistikuara për stabilitetin e sigurinë e rajonit. Kjo është arsyeja që rajoni konsiderohet e perceptohet ende me siguri e stabilitet të brishtë, dhe si vend origjine e urë tranzitimi për aktivitetet e paligjshme drejt vendeve të BE apo më tej, duke u konsideruar jo vetëm si rajon i kërcënuar nga pasiguria, por që edhe mund të kërcënonte sigurinë e vendeve të tjera .

Faktori shqiptar në Ballkan ka qenë, mbetet dhe shfaqet i rëndësishëm progresivisht në rritje, për garantimin e sigurisë e të stabilitetit në rajon. Natyrisht në qendër të këtij faktori, kontributi dhe roli i Republikës së Shqipërisë ka qenë primar, përgjithësisht pozitiv. Veprimet e Republikës së Shqipërisë, në kontekstin e kërcënimeve e rreziqeve rajonale janë të dyfishta, nga njëra Shqipëria me maturimin e saj gjithëplanësh po transformohet nga konsumatore në kontribuese e sigurisë rajonale dhe nga ana tjetër Shqipëria përgatitet përmes Strategjisë Kombëtare të Sigurisë të sfidojë kërcënimet e rreziqet me natyrë rajonale. Natyrisht në procesin e demokratizimit të saj mund të veçohen zhvillimet në vitin 1997, të cilat ishin një kërcënim jo vetëm për sigurinë e brendshme.

Krijimi dhe konsolidimi i papërfunduar plotësisht i vendeve të reja të Ballkanit Perëndimor dhe ndërlihdhja midis tyre, kryesisht me natyrë etnike, përcaktojnë natyrën e këtyre kërcënimeve e rreziqeve. Në këtë këndvështrim, Sllovenia ka ndërlihdhje të dobët me problematikën etnike të Ballkanit Perëndimor dhe për rrjedhojë “largimi” i saj nga ky rajon ka

qenë më i lehtë dhe deri në njëfarë mënyre i justifikuar. Ndërlidhjet me natyrë etnike të Shqipërisë me rajonin konkretizohen me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Kurse ndërlidhjet etnike të Serbisë konkretizohen me Bosnje-Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi. Të Kroacisë me Bosnje-Hercegovinën. E kështu me radhë. Jashtë këtij rajoni, në rajonin e Evropës Juglindore, ndërlidhjet etnike janë prezente midis Greqisë e Shqipërisë, midis Greqisë e Maqedonisë, midis Maqedonisë e Bullgarisë, e tjerë.

Të gjithë ndërlidhjet etnike, nëse nuk menaxhohen në mënyrë të përshtatshme, mbeten potencialisht burime të kërcënimeve dhe rreziqeve e njëkohësisht edhe përcjellësit më të mirë të tyre në nivel rajonal. Krijimi i shteteve të reja multi-etnike nga ish-Jugosllavia, rrezikimi i integritetit të tyre nga mosrespektimi i modeleve të bashkëjetesës multi-etnike dhe të respektit të të drejtave të minoriteteve, ka qenë burim i vazhdueshëm i konflikteve dhe mbeten potencialisht një burim për kërcënime të sigurisë kombëtare. Këto kërcënime me origjinë nga vendet ku jetojnë shqiptarët apo gjetiu për shkak të radikalizimit të marrëdhënieve ndëretnike, mundet përmes “përcjellësve ndëretnikë” të kthehen në rreziqe reale për sigurinë e Shqipërisë.

3. Siguria në Ballkanin Perëndimor

Përgjithësisht rajoni i Ballkanit Perëndimor, vlerësohet të ketë arritur në nivel makrorajonal një stabilitet e siguri të vlerësueshme, progresivisht në rritje. Ndërkohë në nivel mikrorajonal në mjaft zona të veçanta, siguria dhe stabiliteti janë ende të brishta. Prezenca e faktorit ndërkombëtar, përgjithësisht qeverisja e kryeqyteteve ballkanike nga lidershpi i zgjedhur demokratikisht dhe i deklaruar qartë e orientuar përgjithësisht në proceset e integritetit evropian e euroatlantik

janë disa nga faktorët bazë të dominimit të krizave potenciale lokale dhe të pengimit të shpërhapjes së tyre në nivel rajonal.

Në periudhën 1990-2007 siguria dhe stabiliteti i rajonit janë rritur progresivisht, ndonëse me oshilacione të shumta, bazuar në një sërë aktesh e veprimesh të rëndësishme, të tilla si: I) Marrëveshja e Paqes e Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën e vitit 1995; II) Fushata ajrore e NATO kundër ish-Jugosllavisë së mbetur me synim zgjidhjen e konfliktit në Kosovë në vitin 1999; III) rënia e regjimit të Millosheviqit; IV) Pakti i Stabilitetit i ndërtuar në vitin 1999, V) Marrëveshja e Ohrit në Maqedoni; VI) Krijimi i Kartës së A3 për Shqipërinë, Kroacinë e Maqedoninë në 2001 dhe ftesa për Bosnje-Hercegovinën, Serbinë e Malin e Zi në PFP në samitin e Rigës në 2006; VII) Përfshirja në CEFTA (marrëveshjen e tregtisë së lirë të vendeve të Evropës juglindore), e tjera.

Por në këtë periudhë, pavarësisht rritjes progresive të sigurisë në rajon e të secilit vend në veçanti, janë shënuar edhe kriza e ngjarje që kanë kërcënuar e rrezikuar stabilitetin e sigurinë e vendeve të veçanta, e deri me impakt për sigurinë e vendeve fqinje apo më gjerë. Mund të përmenden këtu: i) Konflikti i armatosur midis shqiptarëve dhe kosovarëve në vitin 1998, ii) konflikti i armatosur midis shqiptarëve dhe maqedonasve në vitin 2001, iii) kriza politike që shoqëroi rënien e piramidave në Shqipëri, e tjerë.

Zona më e brishtë për sa i përket sigurisë e stabilitetit natyrisht mbetet Kosova. Zvarritjet dhe vonesat në përcaktimin e statusit përfundimtar apo akoma më keq ndryshimi i kufijve të saj territorialë përmes ndarjes së Mitrovicës do të mund të pasoheshin nga një krizë me pasojë kërcënimin e rrezikimit të stabilitetit e sigurisë rajonale. Ndryshe nga të gjithë vendet e tjera, ku bashkëjetesa ndëretnike është inkorporuar në programe të tranzicionit demokratik e të integrimiave evropiane e euroatlantike, ndonëse me problemet e rreziqet e

tyre përkatëse të lidhura me tranzicionin demokratik të shoqëruara me problemet e konsiderueshme ndëretnike, Kosova përbën ndoshta zonën më delikate e potencialisht burimin kryesor të rreziqeve e kërcënimeve për stabilitetin e sigurinë e saj por që mund të shtrihen për të gjithë rajonin.

Secili shtet i ri i krijuar nga zbërthimi i ish-Jugosllavisë përbën rrezik për sigurinë rajonale për shkak të vështirësive të respektimit të parimeve të bashkëjetesës multi-etnike, ndonëse konturet statutore janë të përcaktuara qartë, dhe pavarësisht se demokratik i ka ofruar mundësinë të jetë anëtarë i OSBE, i Këshillit të Evropës apo të përfshihet në plane, programe dhe projekte të anëtarësimit në BE dhe NATO. Kosova, ndryshe nga të gjithë vendet e tjera, është pa status legal, ndërkohë që de facto është e pavarur, dhe për rrjedhojë jashtë OSBE e Këshillit të Evropës dhe e papërfshirë në asnjë plan apo program specifik integrimi. Për rrjedhojë ajo është e rrezikuar duke përbërë njëkohësisht burimin e rrezikut kryesor e të kërcënimit për sigurinë rajonale në rast se minimalisht procesi i përcaktimit vonohet apo akoma më keq në rast se ajo ndahet.

4. Statusi i Kosovës dhe rreziqet nga ndarja e saj

Procesi i pavarësimit të Kosovës po zvarritet. Kalendari i veprimit të bashkësisë ndërkombëtare është shtyrë pothuajse me një vit nga momenti kur plani Ahtisari do të duhej të paraqitej në Këshillin e Sigurimit të OKB. Naveta e re e Trojkës kërkon të gjejë një zgjidhje kompromisi duke përsëritur ekzaktësisht teknologjinë e ish-presidentit finlandez. Asnjë shenjë nuk duket për të besuar se serbët i janë afruar zgjidhjes. Taktika e Serbisë mbetet zvarritja, ruajtja e statukuosë, lodhja e dhe përçarja e faktit ndërkombëtar dhe njëkohësisht provokimi/nxjtja e rebelimit në Kosovë për të demonstruar

rrezikun e “pavarësimit të shtetit të Kosovës”. Një nga opsionet për serbët mbetet ndarja e Kosovës ose kërcënimi me ndarjen për pengimin e pavarësimit. Fatkeqësisht përmes deklarimeve kaotike të përfaqësuesit të BE-së Ishinger situata shfaqet më e paqartë dhe për rrjedhojë më e rrezikshme. Fillimisht zyrtari i lartë evropian “nuk e përjashtoi ndarjen” dhe para pak ditësh la të kuptohej se “pavarësia nuk është në rendin e ditës”. Artikulimi se “pavarësia nuk është në rendin e ditës” e zyrtarit evropian do të thotë ose “autonomi e zgjeruar”, e cila kundërshton në thelb planin Ahtisari, të cilin e kishte mbështetur BE, ose “shtyrje e përcaktimit të statusit në një kohë të pacaktuar”, që gjeneron padurim. Në të dy rastet Kosova detyrohet të deklarojë pavarësinë e njëanshme, e cila do të shoqërohej me të gjithë rreziqet përkatëse.

Më komplekse dhe e rrezikshme do të paraqitej situata në rastin e ndarjes së Kosovës. Nga këndvështrimi i kërcënimeve/ rreziqeve të sigurisë e stabilitetit rajonal, ndarja e Kosovës nuk ka të bëjë vetëm me Kosovën. Në rast se ajo do të ndodhte, destabiliteti e pasiguria mund të ishin pothuajse panballkanike, duke përcaktuar në skenarin më ekstrem fillimin e formatimit të shteteve-kombe. Ndarja e Kosovës do të thoshte ndryshim kursit e filozofie, e cila qëndroi në themel të ndërtimit të shteteve të reja multi-etnike pas fillimit dhe pothuajse përfundimit të procesit të zbrërthimit të ish-Jugosllavisë. Do të thoshte kalim nga ndërtimi i shteteve të reja pas-jugosllave mbi bazën e bashkëjetesës multi-etnike në ndërtimin e shteteve-kombe, pothuajse etnikisht të pastër në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Një proces që përmes efektit domino do të përfshinte të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor deri ndoshta pjesë të Evropës Juglindore. Një proces me shumë gjasa i shoqëruar me ballafaqime ndëretnike e ndërshitetërore për një periudhë të gjatë kohore. Proces që do të vinte përkohësisht në rrezik zgjerimin e NATO-s dhe Bashkimit

Evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Proces që aktualisht vlerësohet të kërcënojë sigurinë e rajonit.

5. Në vend të përfundimit ...Qëndrimi i Shqipërisë

Shqipëria konsiderohet në të gjithë raportet ndërkombëtare që ka pasur një politikë të jashtme e të sigurisë në favor të rritjes së sigurisë kombëtare dhe me impakt pozitiv në rritjen e sigurisë rajonale. Sfidat kryesore janë lidhur me shumë me procesin e tranzicionit demokratik dhe të integritimit në BE e NATO. Në këtë kuadër çështjet e forcimit të shtetit ligjor, të zhvillimit dhe të fuqizimit të ekonomisë së tregut, të luftës kundër krimit të organizuar dhe të trafikëve të paligjshme, të luftës kundër terrorizmit, të konsolidimit të shoqërisë demokratike dhe të të drejtave të njeriut, të përafrimit të legjisllacionit me standardet e Bashkimit Evropian, e tjerë mbeten objektiva afatshkurtër e afatmesëm për rritjen e sigurisë e të stabilitetit të vendit.

Në kuadrin e përmirësimit të mjedisit të sigurisë në nivel rajonal Shqipëria ka qenë proaktive në intensifikimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit rajonal në funksion të arritjes së qëllimit të përbashkët të integritimit në strukturat evropiane dhe euroatlantike për të kthyer rajonin tonë në faktor paqeje, stabiliteti dhe prosperiteti. Për sa i përket arritjes së objektivave që kanë të bëjnë me “Çështjen Kombëtare Shqiptare”, qëndrimi i Shqipërisë mbetet i qartë dhe i kushtëzuar nga Kushtetuta, pra arritja e zgjidhjes së saj përmes integritimit evropian dhe euroatlantik të Shqipërisë dhe të vendeve të rajonit ku ndodhet faktori shqiptar. Natyrisht kjo presupozon zgjidhje që sigurojnë garanci afatgjatë e të pranueshme për secilin vend të pavarur bazuar në parimin e bashkëjetesës multi-etnike. Në SSK qartësisht thuhet se “Faktori shqiptar në Ballkan është i një rëndësie të dorës së parë, duke bërë që

kontributi dhe roli i Republikës së Shqipërisë të jetë mjaft i rëndësishëm në krijimin e një atmosfere harmonie, të bashkëjetesës dhe bashkëpunimit reciprok në interes të paqes, prosperitetit mirëqenies dhe integritetit sa më të shpejtë të rajonit tonë në familjen evropiane”. Në themel të kësaj zgjidhjeje qëndron çështja e Kosovës. Pavarësimi i saj, pa vonesë e zvarritje, pa ndarje apo bashkim me shtete të tjerë të pavarur, është guri i fundit që do të garantonte një siguri cilësisht të rritur për të gjithë rajonin dhe do të reduktonte ndjeshëm kërcënimet/rreziqet me natyrë etnike ndaj sigurisë në nivel rajonal.

Shkëlqim Cani
Merita Shehu

EKONOMIA – ÇËSHTJE KRITIKE PËR STRATEGJINË E SIGURISË KOMBËTARE

Hyrje

Sfidat madhore me të cilat përballet zhvillimi i çdo vendi në ditët e sotme janë:

- Të gjenerojë një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike;
- Të sigurojë që rritja ekonomike nuk diskriminon shtresat e varfra të popullsisë, përkundrazi ajo ndikon në përmirësimin e standardeve të jetesës së të gjitha grupimeve;
- Të sigurohet që rritja është e përballueshme dhe në harmoni me politika të tjera të vendit, si ato ambientaliste etj.

Rritja e qëndrueshme ekonomike nxitet nga disa faktorë bazë:

1. Kuadër makroekonomik i shëndetshëm, ndërmjetësim i thellë financiar, stabilitet financiar;
2. Liberalizim i tregjeve dhe nxitje e eksporteve;
3. Nivel i lartë investimesh (të huaja dhe vendase);
4. Minimizim i ekonomisë joformale dhe korrupsionit;
5. Zbatimi i ligjshmërisë, sistem drejtësie eficient dhe strukturë rregullative e efektshme etj.

Strategjia kombëtare e sigurisë përfaqëson një përpjekje sistematike për t'u përballur me këto sfida në një mënyrë krijuese dhe vizionare, duke i dhënë zhvillimit më të shpejtë të vendit një pamje më humane, si nga pikëpamja e politikave makroekonomike, ashtu dhe atyre në sektorë të veçantë të ekonomisë. Realizimi i një procesi të shpejtë rritjeje ekonomike në vend do të ishte dhe objektivi kryesor i një politike zhvillimi, që ka në fokusin e vet njeriun, duke krijuar kushte për punësim dhe përmirësuar aksesin e popullatës ndaj shërbimeve bazë sociale dhe ekonomike. Pra, që një strategji kombëtare të marrë konture të plota, ajo duhet të trajtojë jo vetëm çështjet e mirëfillta ekonomike, por dhe ato në sektorët e shëndetësisë, arsimit, strehimit, uljes së varfërisë, në fushën sociale etj., nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes aktive të të gjitha segmenteve të shoqërisë.

Objekt i këtij punimi janë aspektet e politikës ekonomike dhe financiare të ndjekura, në kuadrin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë. Punimi është i ndarë në dy pjesë: në të parën synohet të bëhet një analizë e shkurtër e realizimit të objektivave të strategjisë ekzistuese, nga këndvështrimi sasior e cilësor, ndërsa në pjesën e dytë paraqiten disa rekomandime modeste në vëmendje të hartuesve të strategjisë së re.

Që në fillim do theksonim se strategjia aktuale është rezultante e një vullneti dhe përpjekjeje serioze që vlen për t'u përshëndetur nga pikëpamja e vendosjes së disa piketave për rrugën që duhet të përshkonte vendi në një periudhë afatmesme, për konsolidimin e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut në vend.

Së dyti, për të bërë një vlerësim më të saktë do të duhej të analizonim shkallën e realizimit të treguesve sasiorë, të cilët mungojnë në këtë strategji. Por dhe treguesit cilësorë janë formuluar në disa raste në mënyrë evazive. Për rrjedhojë monitorimi i strategjisë paraqet vështirësi në mungesë të

afateve dhe instrumenteve konkrete për arritjen e këtyre objektivave, të cilat normalisht duhet të jenë pjesë integrale e një strategjie klasike. Përgjithësisht, mendojmë se strategjia në fjalë nuk ka qenë objekt promovimi dhe për pasojë referimi nga aktorët e ndryshëm politikë apo palë të tjera të interesuara për hartimin e strategjive dhe programeve vijuese në fusha të tjera. Pra, me të drejtë mund të pyesim: është ky një dokument “i tepërt”, “i harruar” apo thjesht një dokument më shumë formal për të kënaqur kushtet apo sugjerimet e ndërkombëtarëve? Kjo na e vështirëson disi analizën për realizimin e objektivave të strategjisë.

Në një pamje më të përgjithshme mund të themi:

- Programi i çdo qeverie deri tani është përfunduar brenda 15 ditësh nga marrja e pushtetit ose është ndërtuar mbi baza premtimesh elektorale, që tradicionalisht nuk janë mbajtur, duke vënë në pikëpyetje që në fillim seriozitetin dhe angazhimin real të qeverive.
- Në fushën e ekonomisë ndarjet midis dy forcave kryesore nuk janë të prera dhe të shumta. Prandaj partitë duhet të gjejnë forcën për të arritur kompromisin e duhur për çështjet prioritare, si dhe për të qenë më transparentë me programet e tyre, duke evidentuar qartë çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan me njëra-tjetrën. Kjo do shërbente për evitimin e konfuzioneve në elektorat dhe rritjen e vëmendjes nga investitorët e huaj.
- Kemi shtet të dobët, që megjithatë kërkon të ndërhyjë në ekonomi edhe pse shpesh nuk mund të përmbushë siç duhet detyrat e veta minimale. Ka shumë burokraci dhe administratë mbi nevojat.

I. Vështrim mbi realizimet e objektivave ekonomike të SSK

Nga një vlerësim i përgjithshëm i strategjisë mund të dalim në përfundimin se hasen mjaft realizime, por ka dhe mosrealizime të synimeve të strategjisë në fuqi:

TREGUES EKONOMIKË-2006	Eurozona	Shqipëri	Serbi	Maqedoni
Popullsia (milionë)	315.2	3.1	7.5	2.0
PBB/frymë (000 €)	26.5	2.3	2.9	2.8
Inflacioni (%)	2.2	2.1	6.6	2.9
Bujqësia, % e PBB	2.0	23.0		
Shërbimet % e PBB	71.3	46.3		
Rritja e PBB (% vjetore)	2.4	5.0	5.5	2.7
Norma e papunësisë (%)	7.7	13.8	26.9	37.3
Deficiti publik % e PBB	-1.6	-3.2	+2.0	+0.3
Borxhi bruto % e PBB	69.0	55.9		39.0
Të ardhura buxhet. % e PBB	46.1	25.2	43.8	36.5
Shpenz. buxhetore % e PBB	47.7	28.3	41.8	36.2
Bilanci llog.korrente % PBB	-0.1	-7.6	-10.5	-1.4
Depozitat bankare % e PBB	100.3	58.8		40.0
Huatë bankare % e PBB	130.0	21.3		

1. Siç mund të shihet dhe nga tabela treguesit makroekonomike kanë shfaqur një ecuri të qëndrueshme në vite, gjë e cila vlerësohet si një bazë e mirë për zhvillimin e sotëm e të ardhshëm, në harkun e strategjisë së re që do të hartohet.

Sidoqoftë, kjo panoramë optimiste nuk duhet të na fshehë probleme, një pjesë të trashëguara prej vitesh, të cilat një ditë mund të na kthehen në kërcënime për ekonominë.

2. Kemi rezultate të pakënaqshme në tërheqjen e investimeve të huaja, të cilat vlerësohen në nivele të ulëta, bazuar si në standardet dhe ambiciet e ekonomisë shqiptare, ashtu edhe në krahasim me vendet e tjera në rajon. Për pasojë, këtë objektiv të SKS-së do ta vlerësonim të porealizuar.

Investimet e huaja në vendin tonë në shumicën e rasteve kanë ardhur si pasojë e privatizimeve, gjë që shpjegon dhe luhatshmërinë e ndjeshme të tyre ndër vite. Edhe nisma shumë e trumbetuar “Shqipëria 1 Euro” nuk ka sjellë ndonjë të re deri tani. Investimet e huaja në 6-mujorin e parë të këtij viti ishin 145 milionë Euro.

3. Klima për biznesin dhe investimet vlerësohet si jo e kënaqshme, duke marrë në konsideratë treguesin relativisht të ulët të investimeve dhe sidomos të atyre prodhuese, si dhe rezultatet e mbledhura për klimën e biznesit nga sondazhet e anketimet e kryera gjatë këtyre viteve të fundit nga institucione vendase dhe të huaja (Banka Botërore, BERZH, IFC, MJAFT, ZMQ, IDN etj.).

4. Vërehen përmirësime në treguesin e deficitit buxhetor dhe në disa raste dhe në treguesit e tjerë fiskale, si p. sh. në ato të tatimeve dhe doganave, të cilat përsëri mbeten larg standardeve të BE-së dhe shifrave analoge të fqinjëve. Kështu mund të përmendnim faktin që të ardhurat e buxhetit ndaj PBB-së janë thuajse sa gjysma e atyre të Kroacisë (25 për qind ndaj 44 për qind). Pra, rruga që duhet të përshkojmë drejt integritimit në BE është jo vetëm e gjatë, por dhe e mundimshme. Strategjia e re do të duhet të vendosë objektiva ambiciozë dhe konkretë për ngushtimin e këtij hendeku të ndjeshëm, të krijuar si nga dimensionet e frikshme dhe të toleruara të ekonomisë joformale, evazionit fiskal dhe korrupsionit, aq edhe nga mosshtrirja e bazës së tatueshme p. sh. edhe në fshat (kryesisht për sigurimin e avantazheve afatshkurtra politike).

Lidhur me shpenzimet buxhetore, mënyra e kryerjes së tyre evidenton një sërë problemesh:

- 1) aritmi në realizimin e shpenzimeve (thuajse çdo vit niveli i tyre në tremujorin e fundit është sa afro dyfishi i atyre të tremujorit të parë);

- II) alokim i keq i shpenzimeve të buxhetit, me përfitime të vogla për njësi të shpenzimeve që kryhen¹;
- III) në shumë raste projektet e investimeve zgjidhen jo mbi bazën e studimeve të fizibilitetit dhe leverdishmërisë ekonomike;
- IV) mosrealizimi i të ardhurave buxhetore në fund të vitit imponon ulje drastike të shpenzimeve për investime, qoftë dhe për projekte që gjykohen të domosdoshme.

5. Po brenda të njëjtit objektiv, konstatojmë thëllim të deficitit tregtar dhe të llogarisë korrente (rritje me 28.5 për qind në fund të 6-mujorit të parë 2007 kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar për të dy treguesit). Shqipëria në fund të 6-mujorit të parë 2007 mbulonte me eksportet e saj më pak se një të tretën e importeve (28 për qind). Burimi kryesor për financimin e deficitit tregtar kanë qenë dërgesat e emigrantëve, të cilat gjatë pjesës së parë të vitit ishin 493 milionë Euro, ose rreth 50 për qind e deficitit tregtar. Përkeqësimi i deficitit të llogarisë korrente arriti në 7.6 për qind të PBB-së në fund të vitit 2006². Sipas literaturës dhe praktikës botërore tejkalimi i nivelit prej 5 për qind të PBB-së, konsiderohet përgjithësisht si pikë kritike³.

6. Privatizimet kanë qenë me sa duket prioritet i çdo qeverie, duke u materializuar me arritje konkrete (prej vitesh rreth 75 për qind i PBB-së është siguruar nga sektori privat). Tashmë kemi sektorë të tërë të ekonomisë plotësisht të privatizuar (SME-të, tregtia, ndërtimi janë 100 për qind

¹ Banka Botërore, “Ristrukturimi i shpenzimeve qeveritare në Shqipëri për të mbështetur rritjen”, studim 2006.

² Thëllimi i deficitit të llogarisë korrente ka vazhduar edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2007 - shih “Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2007”, Banka e Shqipërisë, gusht 2007.

³ Vit Barta, “Bashkëveprimet midis politikës monetare dhe stabilitetit financiar, përvoja çeke dhe mësimet”, Konferenca VI e BSH-së, 2006

private). Për më tepër, një pjesë e mirë e tyre ka kaluar në pronësinë e investitorëve të huaj (sistemi bankar 100 për qind privat e mbi 92 për qind në duart e të huajve).

Pavarësisht nga sukseset, duhet të jemi realistë dhe të pranojmë që privatizimet në jo pak raste janë kryer pa strategji dhe objektiva të qarta, më shumë me imponimin e kushtëzimit e organizmave ndërkombëtare (BE, BB, FMN), pa transparencën e duhur, me afëra e korrupsion, me raporte të përmbysura ristrukturim-privatizim, ku në pjesën dërrmuese ristrukturimi ka rezultuar i dështuar, madje edhe atëherë kur procesi është mbështetur, financuar e monitoruar nga organizmat e huaja. Pasojat qenë jo vetëm kosto shtesë për ekonominë, por edhe vonesa në privatizim (tri bankat shtetërore - Banka Bujqësore, BKT, Banka e Kursimeve). Besojmë se privatizimi më herët i bankave do të kishte sjellë të ardhura më të mëdha (sidomos nga dalja me fitim e bankave private, në vend të humbjeve që prodhuan bankat shtetërore deri në privatizim). Ndërsa kostot e transformimit, të hasura nga sektori publik gjatë periudhës, do të kishin qenë shumë më të vogla, pasi shumica e kostove potenciale do të ishte mbuluar nga pronarët e rinj privatë. Zvarritja e privatizimeve të bankave erdhi paksa edhe për arsye politike, nisur së pari nga bindja se ky sektor kyç i ekonomisë duhet të mbahej nën kontrollin e shtetit në kushtet e pasigurisë së mjedisit ku vepronte, dhe së dyti, nga një dyzim i qeverisë lidhur me privatizimin e sistemit bankar.

Nga rastet e shqyrtuara në praktikën e deritanishme të privatizimeve apo dhënieve me qira/koncesion, në konfliktet e shtetit shqiptar me palën e huaj, kontratat e përfunduara kanë qenë në mënyrë të dukshme në disfavor të shtetit shqiptar. Kjo nuk ka si të jetë vetëm paaftësi e ekipeve tona negociuese!

Me jo pak kosto për ekonominë kanë qenë edhe deklaratimet për avantazhe politike të politikanëve të djeshëm të opozitës për disa privatizime ose për moskryerjen e disa investimeve

të huaja. Shtyrja e pajustificuar e tyre (me sa duket rezultoi!) për një afat dy ose më shumë vjeçar (TEC-i Vlorës, Albtelekom etj.) na bëjnë të japim një vlerësim kritik ndaj këtij elementi të strategjisë kombëtare.

Të njëjtat probleme shtrohen sot edhe për privatizimet në sektorin energjetik dhe atë të furnizimit me ujë. Sot shqiptaret vlerësojnë si mallra me cilësi të dobët, por me çmime relativisht të larta (për nga cilësia e furnizuar), pikërisht mallrat ende publikë si energjia elektrike etj. Sipas gjykimit tonë, qeveria duhet të heqë dorë nga praktika “tashmë tradicionale” e orvatjeve të dështuara për ristrukturim të këtyre sektorëve e më pas kryerje privatizimi. Nga eksperiencia e deritanishme (jo vetëm në vendin tonë), qeveritë përgjithësisht nuk kanë rezultuar as pronare e as ristrukturuese të mira, për shkak të paaftësive operacionale dhe menaxhuese.

7. Ekonomia e tregut i bëri pronarë shqiptarët pas 50 vjetësh. Fitimi i titullit të pronësisë u realizua në mënyra nga më të ndryshmet: disa si ish-pronarë, disa nëpërmjet procesit të blerjes, të tjerë me akte ligjore dhe shpërndarje falas, por jo pak dhe me korrupsion apo zaptim pronash. Në këtë rrjedhje komplekse të ngjarjeve nuk është e lehtë të japësh vlerësime të sakta, por megjithatë do të vinim nota jo pak negative për sa i takon konsolidimit të të drejtave pronësore. Sot dëgjojmë ankime të ish-pronarëve në Bruksel; shohim pronarë të rinj që legjitimohen me akte të dyshimta, por dhe pa dokumente përfundimtare; bëhen ndërtime pa lejet përkatëse dhe më pas në një pjesë të tyre shteti demonstroi forcën me “rruspa”. Në fund të fundit, rezultati përfundimtar nuk është gjë tjetër veçse kosto ekstra për gjithë ekonominë. Këto kosto në dukje “i kompenson buxheti”, por në fakt i paguajnë shtetasit e këtij vendi të varfër, duke pasur më pak rrugë, më pak energji, më pak ujë si dhe shërbime të një niveli të pakënaqshëm në arsim dhe shëndetësi.

Tashmë është një fakt i pakontestueshëm që problemet e pronësisë si p. sh. raportet ish-pronarë dhe pronarë të rinj, formalizimi i zonave informale, vonesat, burokracitë e mbivendosjet në regjistrimin e pronës, aferat korruptive që nisin që nga marrja e një dokumenti të thjeshtë e deri në zhvatjen e sipërfaqeve të pamerituara, po mbajnë peng zhvillimin ekonomik të vendit duke u bërë përgjegjëse për një fluks më të pakët të investimeve të huaja, për hezitime, vonesa dhe deri në pamundësi kreditimi nga bankat, mbizotërimin e monopoleve të fshehta ose të hapura etj.

8. Sipas statistikave të publikuara, Shqipëria ka bërë përmirësime në uljen e varfërisë dhe pabarazisë në vend. Por, kjo çështje mbetet pjesë e fokusit të qeverisë në strategjinë e re, pasi Shqipëria është vendi i dytë më i varfër në Evropë, me të ardhura për frymë në nivelin e 2275 Euro në fund të vitit 2006. Varfëria është më e dukshme në zonat rurale dhe kryesisht më e theksuar në zonën verilindore të vendit.

9. Rasti i parë i dokumentuar i korrupsionit është identifikuar në Indi rreth 2300 vjet më parë, ndërsa Kodi i parë Penal që e dënon korrupsionin është gjetur në Kinë para 2200 vjetësh. Pra korrupsioni nuk është fenomeni i hasur për herë të parë në Shqipëri. E veçantë për vendin tonë është se jemi në nivele tepër të larta në raport me vendet e tjera në botë dhe sidomos në rajon.

Lidhur me korrupsionin dhe transparencën mund të themi që progresi i bërë përfaqëson më shumë zhurmë propagandistike sesa realitetin. Në pesë vitet e fundit Shqipëria është renditur ndër vendet me korrupsion dhe ekonomi joformale në shifra të larta. Studime dhe anketime të ndryshme nga organizma të huaja si dhe OJF-të vendase e rendisin Shqipërinë ndër vendet më të korruptuara në Evropë dhe në botë. Sipas “World Audit Organization”, Shqipëria në fund të vitit 2006 renditet në vendin e 96 nga 145 vende të botës. Të

njëjtat rezultate konfirmohen edhe nga anketimi në mesvitin 2007, i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN-organizatë civile shqiptare dhe bashkorganizatore e këtij seminari të këndshëm), ku del se ndër faktorët kërcënues të sigurisë kombëtare, shqiptaret rendisin si dy të parët: korrupsionin, varfërinë dhe stanjacionin ekonomik.

Duhet të pranojmë se fitorja e ngushtë e PD-së me aleatët në zgjedhjet e vitit 2005 kishte si lajtmotiv luftën kundër korrupsionit, ekonomisë joformale dhe krimit të organizuar. Pas dy vitesh, nëse duam të përkthejmë anketimin e mësipërm të IDN-së, kemi “shumë zhurmë për asgjë”. “Investimet, pjesë e nevojshme për rritjen ekonomike, kanë mbetur prapa në rajon. Shpjegimi për këtë ecuri të dobët ka të bëjë me nevojën për të forcuar qeverisjen dhe për të mposhtur korrupsionin dhe këtu ...rajoni ka mbetur prapa”¹.

10. Problemi i parë për ekonominë joformale mbetet përcaktimi i saktë, bazuar në metodologjinë e llogaritjes së elementëve përbërës të saj. Pavarësisht nga metodat e zbatuara në sondazhe, kjo shifër është luhatur në rastin e Shqipërisë nga 30-60 për qind (ACER 1999 - 30%, INSTAT 2004 - 25%, Christie & Holzner 2003 - 51%, FMN 2003 - 30%-50%, Muço etj. 2004 - 30% - 60%, CIA 2006 - 50%, Berisha 2007 - 60%). Diferenca kryesore në metoda të ndryshme vjen nga përfshirja ose jo në llogaritje e sektorit të bujqësisë. Në përmirësimin e treguesve shpresojmë të ndikojë fushata anti-cash me imponimin për të kaluar nëpërmjet sistemit bankar mbi 90 për qind të transaksioneve të shoqërive tregtare si dhe krijimi ditët e fundit i Zyrës së Regjistrimit të Bizneseve, me synim regjistrimin e biznesit brenda 1 dite.

¹ J.A. Spindler, “Zhvillimi i tregjeve financiare në Ballkan: një vlerësim i progresit rajonal”, Financial Services Volunteers Corp, 2006

11. Sistemi financiar në Shqipëri ka një strukturë të thjeshtë, e dominuar nga bankat tregtare që përbëjnë mbi 90 për qind të aktiveve totale të sektorit financiar. Pjesa tjetër e tregut financiar i përket sektorit të sigurimeve, aktivet e të cilit zënë 1 për qind të PBB, shoqatat e kursim-kredive, aktive pak më shumë se 1 për qind e PBB dhe disa fonde pensionesh akoma në embrion. Sektori bankar, si pjesa më avancuar e tregut, është tashmë i reformuar, 100 për qind privat dhe me një prezence të lartë të kapitalit të huaj (92 për qind në fund të vitit 2006). Ai karakterizohet nga një përqendrim i lartë në treg, ku pesë bankat më të mëdha zotërojnë 77 për qind të aktiveve totale të sistemit dhe 72 për qind të depozitave, si dhe tregues të shëndetshëm performance dhe risku, vlerësuar dhe nga BB, BERZH, FMN etj. Pavarësisht nga arritjet, niveli i ndërmjetësimit financiar, megjithëse në përmirësim, është ende i ulët. Ky tregues, i llogaritur si raport i aktiveve totale të bankave, i kredive bruto dhe i depozitave ndaj PBB-së, arrin respektivisht në 69.4 për qind, 25 për qind dhe 56.8 për qind.

Bankat tregtare dhe sidomos bankat e huaja, kanë kontribuar ndjeshëm në uljen e kostos së ndërmjetësimit dhe në zhvillimin e burimeve financiare, të investimeve dhe të kredisë për bizneset e mëdha e të vogla. Roli i tyre është vendimtar për krijimin e stabilitetit financiar në vend, duke pakësuar ekonominë joformale dhe kanalizuar më shumë para nëpërmjet kanaleve zyrtare.

12. Objektivi i transparencës mendojmë që ka më tepër karakter formal dhe nuk kuptohet në thelbin e vet. P. sh. institucioni i Bankës së Shqipërisë, që është vlerësuar ndër më transparentët në vend, e konsideron transparencën më shumë si respektim formal të detyrës sesa si përcimin e një mesazhi parashikues e cilësor në përmbajtje të tregu dhe publiku, duke mos bërë ndonjë progres në këtë fushë në 2-3 vitet e fundit. Siç ka më shumë vlerë pavarësia reale e BSH

nga pavarësia ligjore, në raportet me publikun ka më tepër rëndësi transparenca reale sesa ajo formale. Në të njëjtën “bandë valësh” gjendet dhe qeveria, e cila ka zgjedhur për transparençë dhe edukim të publikut fjalën e kryeministrit me ministrat dhe median në fillim të çdo mbledhjeje qeverie.

Transparenca dhe statistikat nuk pëlqehen shumë nga politikanët. Ato në mjaft raste ose injorohen ose keqpërdoren duke bërë vlerësime subjektive në favor të interesave të çastit. Sa i takon opozitës, ajo lihet zakonisht në terr nga institucionet shtetërore, të cilat e kanë për detyrë informimin dhe llogaridhënien. Përgjithësisht rritja e transparençës dhe e publikimeve statistikore vijnë me imponim nga ndërkombëtarët.

Lidhur me integrimin e vendit në BE, nëse do të ballafaqoheshim me Kriteret e Konvergencës do të kishim tablonë si vijon:

Kriteret e konvergencës	BE	Shqipëri
Zhvillimet fiskale	<ul style="list-style-type: none"> ▫ qëndrueshmëri e pozicionit financiar të qeverisë; ▫ deficitit buxhetor/GDP < 3% ▫ borxhi publik/GDP < 60% ▫ BQE jep mendim mbi zhvillimet fiskale 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ -3.2% ▫ 55.9% ▫ BSH jep, por rrallë i merret parasysh?!
Zhvillimet në çmime	<ul style="list-style-type: none"> ▫ arrijte stabiliteti çmimesh; ▫ inflacioni = < +1.5% e mesatares inflacionit të tre vendeve me inflacionin më të ulët të BE 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ 2.4%
Zhvillime në interesat afatgjatë	<ul style="list-style-type: none"> ▫ <+2% të mesat. të tre vendeve me interesat më të ulëta 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ ?!
Zhvillimet në kurset e këmbimit	<ul style="list-style-type: none"> ▫ dy vite pa zhvlerësim vs. monedhës çdo vendi anëtar; ▫ së paku dy vite progres drejt konverg. para se vendi anëtar i BE lejohet të euroizojë ekon. 	<ul style="list-style-type: none"> ▫ përgjithësisht leku ka pasur kurs këmbimi stabil, me mbiçmim të lehtë

I plotësojmë vërtet këto kritere apo kemi të bëjmë thjesht me një iluzion optik?!

Shifrat e mësipërme na bëjnë me optimiste duke na e afruar anëtarësimin në BE brenda një viti. E vërteta tashmë e pranuar nga të gjitha palët është 1 vit + 1 dekadë. Vlerësimet për

qeveritë e ardhshme do të ishin pozitive nëse anëtarësimi në BE do të ishte sa më pranë afatit 1 vit dhe një dekadë dhe jo 1 vit e dy dekada. Ka studime që evidentojnë se një pjesë e mirë e këtyre treguesve për Shqipërinë duhet të jenë shumë më të përmirësuar për të bërë krahasime me kriteret e konvergjencës. Për të pasur një ide më të qartë dhe për të analizuar rrugën që na pret, duhet të marrim në konsideratë edhe këta tregues themelorë krahasuar me eurozonën:

- Të ardhurat për fryme afro 12.6 herë më pak se të eurozonës;
- Kontributi bujqësisë në PBB - 12 herë më i lartë;
- Papunësia dy herë më e lartë në Shqipëri;
- Të ardhurat buxhetore - 2 herë më të ulëta;
- Eksporti i mallrave - 2 herë më i ulët;
- Deficiti i llogarisë korrente - 8 herë më i lartë;
- Huatë bankare/PBB - 6 herë më të ulëta.

II. Sfida për të ardhmen dhe sugjerime modeste

Duke përfaqësuar një vend akoma me demokraci dhe ekonomi në tranzicion – të pastabilizuar dhe të brishte – është kritike për stabilitetin dhe sigurinë e vendit hartimi i një strategjie të re të sigurisë kombëtare, e cila duhet të gërshetojë platforma të unifikuara dhe koherente në të gjitha drejtimet: politike, ekonomike, ambientaliste, humanitare, sociale etj. Kjo strategji për përmasat dhe rëndësinë që ka, duhet të sigurojë vullnetin, konsensusin dhe angazhimin e gjithë faktorëve në vend si dhe mbështetjen e donatorëve dhe faktorit ndërkombëtar. Në funksion të këtij misioni do të duhej që grupi i punës për hartimin e strategjisë së re të fillojë menjëherë nga puna, pasi me sa duket tashmë jemi të vonuar.

Ndërkohë mendojmë që synimeve të strategjisë së re do t'i përshtatej më mirë një shtrirje e saj në një hark kohor prej

pesë vjetësh, ku elemente të veçantë të përmbajnë parashikime e vizione edhe përtej një dekade. Përmbajtja e strategjisë mund të harmonizojë objektiva sasiore me ato cilësore më të përcaktuar si dhe paketën e instrumenteve që do përdoren për realizimin e tyre. Nëse palët e përfshira në procesin e hartimit të strategjisë e konsiderojnë atë jo thjesht një dokument më shumë “në piringun e dosjeve që i ka zënë pluhuri”, por një gur themeltar për zhvillimin e ardhshëm të vendit, ato duhet të kalojnë nga pozitat reaguese në ato parandaluese¹, duke ndarë përgjegjësitë mes tyre dhe ndërmarrë hapa për minimizimin e risqeve.

Mbi bazën e analizës së mësipërme, në mënyrë me konkrete po parashtrajmë disa opinione për elemente të veçantë të fushës ekonomike të strategjisë së ardhshme:

1. Jemi të mendimit që brenda mandatit të kësaj strategjie të vendoset përfundimi i privatizimit të ekonomisë në gjithë sektorët, duke konsideruar si parësore privatizimin e energjetikës, ujit etj. Kjo do t'i jepte fund një herë e mirë dhe praktikave tashmë rutinë të qeverive të keqpërdorimit të energjisë elektrike për arsye politike dhe afëra korruptivë nga individë apo grupe të caktuara.

2. Caktimi i objektivave vjetore konkrete për decentralizimin e pushtetit vendor, duke parashikuar që brenda mandatit të kësaj strategjie të jetë realizuar decentralizimi sipas standardeve të BE, do të ishte autokritika më e mirë e qeverisë për gjithë këtë dekadë të kaluar pa shumë veprime konkrete në këtë drejtim. Sipas eksperiencës botërore, pushteti qendror do të ishte më tepër eficient, në rast se funksionet e tij do përqendroheshin më shumë në drejtim dhe mbikëqyrje, si dhe në përcaktimin e politikave kryesore të monitorimit dhe zbatimit. Ndërkohë, roli kryesor i pushtetit qendror në të

¹ Paris Principles for International Engagement in Fragile States

ardhmen do të ishte vendosja e rregullave kryesore të lojës për gjithë aktorët në treg.

3. Referuar vlerësimeve në pjesën e parë të këtij punimi, trinomi transparencë, statistika dhe partneritet privat-publik kërkojnë një angazhim serioz e konkret të gjithë organeve shtetërore në të ardhmen e afërt. Pa statistika dhe transparencë vendimmarrja është mjaft e cunguar. Do të ishte një pritshmëri logjike që qeveria dhe faktorët e tjerë të jetës politike dhe ekonomike të vendit të ndryshonin thelbësisht qëndrimin ndaj transparencës, statistikave e komunikimit me publikun, duke qëndruar larg formalizmit dhe rutinës.

4. Kudo në botë e sidomos në nivel evropian po nxitet një klimë e re dialogu dhe konsultimesh në kuadrin e partneritetit të sektorit privat me atë publik në fushën e hartimit të politikave të reja qeveritare e rregulluese, zhvillimin ose përshtatjen e standardeve e shërbimeve të ndryshme të degëve të ekonomisë etj. Për rrjedhojë, do sugjeronim që kjo përvojë dhe praktikë e suksesshme të zbatohet dhe në vendin tonë duke parashikuar në strategjinë e re një proces vendimmarrjeje të mbështetur në konsultime me bazë të gjerë (qeveri, komuniteti i biznesit, grupe të interesit, përfaqësues të konsumatorëve, institucione publike, OJF, akademike etj.). Në vijim të kësaj ideje do të ishte e nevojshme të shqyrtohet mundësia e zbatimit të metodës RIA¹ - “Vlerësim i Impakteve Rregullative”. Do të ishte një hap përpara sikur strategjia e re të përfshinte realizimin e RIA-s në të gjithë nivelet e legjislacionit shqiptar brenda vitit 2008.

5. Ulja drastike e korrupsionit, ekonomisë joformale dhe krimit të organizuar, duke iu referuar morisë së kritikave të

¹ Regulatory Impact Assessment – Metodologjia me anë të së cilës hartimi i legjislacionit të ri parashikon opsionet e mundshme për zgjidhje të problemeve, duke analizuar impaktin e çdo opsioni (metoda kosto/përfitime dhe testi proporcional) për bizneset dhe palët e interesuara.

vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit, duhet të zërë një vend parësor në strategjinë e re. Përcaktimi i objektivave ambiciozë dhe konkretë sasiorë dhe cilësorë do të ishte përgjigjja më e mirë e autoriteteve ndaj kritikave, duke dëshmuar vendosmëri dhe seriozitet në premtimet tashmë të marra. Në këtë kontekst, mund të sugjeronim formulime të tilla në strategjinë e re si: ekonomi joformale të ulët në fund të pesë viteve në një të tretën e nivelit të sotëm; renditja e vendit tonë për korrupsion të jetë në të njëjtin nivel me atë të anëtarëve më të rinj të BE-së; Shqipëria të dalë nga harta e krimit të organizuar në fundin e mandatit të kësaj strategjie.

6. Varfëria dhe pabarazia, me gjithë përmirësimet në disa tregues statistikorë, jo vetëm nga perceptimi i publikut (anketimi i IDN), por edhe në realitet është kërcënim për sigurinë në vend. Strategjia e re duhet të ketë objektiva dhe instrumente konkrete të tipit të objektivave të mijëvjeçarit dhe në harmoni me dokumentet e tjera. Një zotim i arsyeshëm i autoriteteve përgjegjëse do të ishte që Shqipëria të realizojë objektivat e mijëvjeçarit brenda vitit 2013.

7. Hendeku i krijuar me BE-në dhe vendet e tjera të rajonit në nivelin e të ardhurave buxhetore e ka kapërcyer dekadën. E ndërjegjshme për një pozicion të tillë kaq të pafavorshëm, qeveria duhet të ndërmarrë një nismë shumë më ambicioze për ta mbyllur këtë hendek. Objektivi i kësaj strategjie mund të jetë përmirësimi i dukshëm i treguesit të të ardhurave buxhetore ndaj PBB-së, për të arritur në nivelin 38-40 për qind brenda vitit 2013. Kjo do të krijonte hapësirë për një ristrukturim të shpenzimeve buxhetore, pasi do të alokoheshin me shumë para për edukimin më cilësor të brezit të ri, për rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e infrastrukturës etj. Procesi i ristrukturimit do të duhet të prekë thellësisht procesin e administrimit të këtyre shpenzimeve për të shmangur investimet në projekte të

paleverdishme, me shpenzime abuzive e çmime të fryra ose pa studimet përkatëse të fizibilitetit. Sipas studimeve të bëra kohët e fundit nga organizatat ndërkombëtare rezulton se projektet e përfunduara deri tani mund të ishin realizuar me 70% të vleftës së tyre.

8. Një rritje e shpejtë, e qëndrueshme dhe me baza e ekonomisë kombëtare (me jo më pak se 6% në vit), do të ishte në funksion dhe në përmbushje të integritit sa më të shpejtë të Shqipërisë në NATO, BE etj. Me gjithë ecurinë e mirë të ekonomisë përgjithësisht në të gjithë vitet e tranzicionit, kanë qenë jo të rralla rastet kur një mungesë vëmendje apo një vizion i turbullt për të ardhmen, bëhen shkak për anomali dhe shpërpjesëtime të rënda e me pasoja (vitet 1997, 2002). Ngërçi aktual në ekonomi, rritja e deficitit të llogarisë korrente dhe deficitit tregtar, statistikat e mangëta dhe jo fort të besueshme, mbikëqyrja e institucioneve financiare jo sipas standardeve etj. nuk duhen lejuar të kthehen në pengesa për ekonominë dhe me pasoja negative, në radhë të parë për uljen e tempit të rritjes ekonomike.

9. Literatura akademike tregon se zhvillimi i tregjeve dhe institucioneve financiare të shëndosha promovon rritjen ekonomike³. Siguria kombëtare kërcënohet nëse nuk mbahen nën kontroll dhe përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme të gjithë treguesit makro. Tolerimi apo neglizhenca në monitorimin e një treguesi apo një grupi treguesish kanë vërtetuar që janë me pasoja në ecurinë ekonomike të vendit. P. sh. në vitin 2002 gjendja e sistemit bankar ishte e shëndetshme, megjithatë presionet politike dhe lufta mes partive kryesore për avantazhe të momentit dhe interesa shumë të ngushta çuan në një kërcënim të sistemit bankar me efekt negativ tërheqjen nga sistemi i 8% të volumit të depozitave.

Deri tani Shqipëria fatmirësisht, ka qenë e imunizuar nga efekti i përhapjes së krizave në rajon apo më gjerë (p. sh. kriza

e Rusisë në '98, e Turqisë në 2001 etj.). Kjo jo shumë për meritën e politikës ekonomiko-financiare të qeverisë dhe asaj monetare të BSH-së, apo për menaxhimin e mirë të pasojave, por kryesisht për shkak të një sistemi financiar akoma embrionik, i përbërë në 90 për qind nga sistemi bankar. Sigurisht, vendi ynë synon që tregu financiar e bankar të hapet dhe të liberalizohet më tej në kuadrin e globalizimit dhe integritit të Shqipërisë në rajon dhe në BE si dhe pranisë së lartë të bankave të huaja në treg¹, por një gjë e tillë mbart më vete pashmangërisht dhe përcjelljen e pasojave të krizave nga njëri vend në tjetrin.

Për t'i paraprirë situatave potenciale kritike do ishte mirë të përfshihej në strategji për çështjet themeltare monitorimi i vazhdueshëm i tyre dhe hartimi i planeve të kontigjencës. Gjithashtu për të parandaluar dhe evituar efektin domino të krizave, strategjia duhet të parashikojë një mbikëqyrje dhe sistem financiar sa me solid, me tregues makro në kontroll, një rrjet sigurie të lartë dhe plane emergjence (kontigjence) të përgatitura në avancë, gjë që aktualisht mungon në Shqipëri.

10. Organet mbikëqyrëse të subjekteve të ndryshme janë të dobëta dhe jo plotësisht të afta, shpesh pa vizion dhe në errësi, të lëna kështu me ose pa qëllim (mbikëqyrja e shoqërive financiare, konkurrenca, telekomunikacioni, energjetika, uji etj.). Duke qenë të tkurrura, sapo ato ngrënë kokën munden lehtë “nga të mbikëqyrurit”, me pasoja për konsumatorin: me çmime më të larta, monopole të fshehta e të hapura, cilësi të dobët ose shërbim e shpërblim të munguar etj.

11. Jemi të mendimit se strategjia e re mund të ofrojë garanci për të ardhmen në rast se kërkohet formulimi dhe

¹ Kose, M.A., E. Prasad, K. Rogoff and S Wei (2006). “Financial Globalization: a Reappraisal”, IMF Working Paper 06/189, International Monetary Fund, Washington DC, August.)

zbatimi i ruajtjes së pacenuar të pavarësisë së institucioneve kushtetuese dhe mbrojtjes së tyre nga presionet politike. P. sh. nuk mund dhe nuk duhet lejuar që BSH të sakrifikojë mosarritjen e objektivit afatgjatë të stabilitetit të çmimeve në favor të realizimit të përfitimeve afatshkurtër.

12. Duke pasur parasysh brishtësinë e demokracisë në Shqipëri, gjykojmë se do ishte jetike që të sigurohej një bashkëpunim aktiv mes pozitës dhe opozitës për të mos paguar më pas premiume për nivelin e rrezikut (rritje të normave të interesave në huamarrje, hyrje e kapitalit të huaj me kosto më të lartë huamarrëse nga qeveria, kosto shtesë për ekonominë, vlerësime më të ulëta të privatizimeve nga rastet analoge në vende të tjera të rajonit, frenime deri në bllokim të FDI-ve etj.). Për krahasim, mund t'u referohemi disa fakteve: me diferencë afro 2-vjeçare është realizuar privatizimi i AMC-së në Shqipëri (85 për qind) për 85 mijë USD, ndërsa 35 për qind e homologes së saj në Kroaci u privatizua për disa qindra mijë dollarë, ndërkohë që popullsia e këtyre vendeve ndryshon vetëm me 1 milion (3 dhe 4 milionë). Banka e Kursimeve që zotëronte afro 60 për qind të tregut u konsiderua si një privatizim i suksesshëm në Shqipëri. Por po t'i referohemi mundësive që kemi humbur duhet sjellë në kujtesë që kjo bankë u privatizua në masën 100 për qind me 120 milionë Euro, ndërsa vetëm dy vjet më pas 75 për qind e Bankës Amerikane të Shqipërisë, me një pjesë tregu 6 herë më të vogël nga BK, u shit me 156 milionë USD.

13. Në teori dhe praktikë tashmë është vërtetuar që Investimet e Huaja Direkte, si burim relativisht i qëndrueshëm kapitali, shoqërohen me rezultate më të larta makroekonomike. Llojet e tjera të flukseve të kapitalit, nuk mund të sjellin detyrimisht pasoja negative, por sigurisht shkaktajnë rreziqe më të mëdha, veçanërisht nëse çojnë në

konsum të tepërt dhe në fryrje të çmimit të aktiveve (tregu i pasurive të paluajtshme). Ndërsa dërgesat e emigrantëve janë burim i përkohshëm të ardhurash në valutë. Synimi parësor i kësaj strategjie duhet të jenë IHD.

Në mbyllje gjykojmë se Strategjia e Sigurisë Kombëtare duhet patjetër të jetë gjithëpërfshirëse dhe të sigurojë konsensusin e gjithë spektrit politik. Ajo duhet të caktojë objektiva brenda një harku kohor deri në 5 vjet, si dhe të hedhë bazat e një vizioni afatgjatë 10-20-vjeçar. Strategjia duhet të reflektojë qartë vizionin e politikaneve për të ardhmen e vendit, duke vendosur piketa konkrete, me prioritete sektorësh, plane aktivitësh me afate dhe programe për të shmangur ose zbutur efektin e risqeve eventuale (uji, energjia, decentralizimi etj.).

Aspektet prioritare nuk duhen lënë derisa të akumulohen në një pikë kritike dhe të na detyrojnë të ndërmarrim zgjidhje të shpejta që s'mund të jenë aq cilësore sa zgjidhjet që do arriheshin nëse diskutimet e konsultimet do ishin bërë me kohë. Lidhur me prioritetet, orientimet themelore të kësaj strategjie, sidomos në aspektin ekonomik, sipas mendimit tonë duhet të jenë: stabiliteti makroekonomik (regjimi i luhatshëm i kursit të këmbimit, shenjestrimi i inflacionit, llogari e liberalizuar e kapitalit, forcim i financave publike) dhe ai financiar; politika investimesh dhe makro, që nxisin liberalizimin e tregjeve, thithjen e investimeve të huaja, nxitjen e eksporteve, rritjen e rolit të sektorit privat dhe zbutjen e varfërisë; forcimin e institucioneve dhe partneritetin publik-privat, forcimin e transparencës etj.

I takon kësaj qeverie të realizojë konsensusin mbi bazë të gjerë me diskutime, debate, dialog konstruktiv etj. për çështjet esenciale që qëndrojnë mbi rezultatet e zgjedhjeve të një raundi. Komisioni hartues duhet të vendosë për interesa

madhore mbi ato të qeverisë si dhe të parashikojë monitorimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave. Partitë politike duhet ta përdorin këtë dokument si një hartë për të ballafaquar arritjet e direktivave.

Alex Finnen

Zv. ambasador i prezencës së OSBE, Tiranë

PLANIFIKIMI I EMERGJENCAVE CIVILE NË STRATEGJINË KOMBËTARE TË SIGURISË

Duke pasur parasysh mandatin e prezencës së OSBE-së dhe statusin tim civil, propozoj, që meqenëse më është kërkuar të flas për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, të fokusohemi te planifikimi i emergjencave civile. Kjo, mendoj unë, kuptohet gjerësisht si një “politikë sigurimesh” dhe si një masë paraprake kundër kërcënimeve të mundshme “civile” ndaj shtetit.

Meqenëse unë jam nga Mbretëria e Bashkuar dhe kam një lloj përvojë me menaxhimin e fatkeqësive civile si atje, ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara, do të përdor, aty ku më duket me vend, shembuj nga Mbretëria e Bashkuar dhe shembuj të tjerë që njoh.

Strategjia kombëtare për sigurinë e identifikon me të drejtë “analizimin e kërcënimeve” si prioritetin numër 1 të mbrojtjes civile¹ dhe paragrafi në fjalë i detajon mjaft mirë kërcënimet kryesore, të cilat janë identifikuar që Shqipëria mund të hasë në këto fusha. Përveç kësaj, besoj se janë konsultuar, ose duhet të jenë konsultuar planifikuesit e emergjencave civile rreth çdo zhvillimi që mund të modifikojë vlerësimin e çdo rreziku të mundshëm që mund të ndodhë në Shqipëri. Zonat e zhvillimit si termocentrali, depozitat e naftës dhe gazit, si dhe

¹ Pjesa VII, Neni 54 i Strategjisë.

ankorimet që lidhen me to në zonën e Vlorës&Fierit mund të jenë një shembull i mirë i një rasti të tillë, në mos tani, më vonë, në një të ardhme jo shumë të largët. Në këtë fazë ideimi dhe ndërtimi më vonë, planifikuesit e emergjencave duhet të bëjnë çmos që të plotësohen kërkesat e tyre, si p. sh. këto zona të kenë porta të mjaftueshme për të hyrë në to, të kenë sasi të përshtatshme shkume kundër zjarrit të magazinuar dhe gati për përdorim, dhe sigurisht, që kostot e këtyre masave paraprake shtesë të jenë pjesë të kostos së vetë projektit.

Këto vlerësime rreziqesh jo vetëm duhet të përditësohen sistematikisht, por duhen pasuar edhe me veprime sistematike planifikimi dhe prova reale të përgjigjes ndaj kërcënimeve potenciale të identifikuar. Këto ushtrime praktike i bëjnë njerëzit të aftë të punojnë bashkë dhe të zgjidhin çështjet e kontrollit dhe komandimit, që lidhen me çdo kërcënim të identifikuar, si dhe formojnë një përbërës të rëndësishëm të planifikimit civil të emergjencave. Në këtë fazë, duhet veçanërisht të ngrihet agjencia për bashkërendimin e përgjigjes ndaj çdo kërcënimi të identifikuar.

Për sa i përket ushtrimeve dhe “provave”, dy tërmetet e mëdha të kohëve të fundit që kanë rënë në rajonin e Ballkanit Perëndimor (në Shkup në vitin 1967 dhe në Hercegovinë në vitin 1981¹), mund të jenë modele të mira trajnimi për atë çka mund të ndodhë nëse një termet i tillë bie në një nga zonat më të mëdha urbane këtu. Mësimet e nxjerra në këto dy ngjarje, njëra prej të cilave la 250 000 njerëz pa strehë në Shkup, janë vënë në jetë jo vetëm në hartimin e planeve të emergjencave, por edhe në elementet themelore të planifikimit, si në kodet e ndërtimit dhe rregulloret e kontrollit të ndërtimeve.

¹ Tërmeti i Herceg Novit shkatërroi pjesë të kështjellës dhe mureve të lashta mesjetare, të cilët ranë në det.

Në rastin e një emergjence civile, Shqipëria do të kishte Këshillin për Siguri Kombëtare si organ të nivelit më të lartë.¹ Ky organ korrespondon me komitetin “Kobra”,² që ne kemi në Mbretërinë e Bashkuar, kurse Këshilli i Ministrave i bie që të korrespondojë me kabinetin tonë atje.

Me sa duket, midis Këshillit Kombëtar për Siguri dhe Kobrës³ ka disa ndryshime, që konsistojnë në faktin se ajo jo vetëm që thirret nga kryeministri, por edhe se nuk ka një përbërje të caktuar. Përbërja e saj është sipas rastit.⁴

Edhe gama e veprimtarive, për të cilat mund të përdoret Kobra duket si më e larmishme:

Ajo u përdor për të koordinuar situatën në rastin e bombardimeve në metro dhe autobus më 7 korrik 2005. Nuk është çudi që u thirr edhe për t’u marrë edhe me përmbytjet e mëdha në Mbretërinë e Bashkuar në qershor dhe korrik 2007, por fakti që u mblodh për të përballuar përhapjen e sëmundjes së aftës epizotike (“*foot and mouth*”)⁵ te kafshët mund të jetë ndoshta pak më e çuditshme. Komiteti Kobra është sigurisht një organizatë mjaft e pjekur⁶ dhe do të ishte interesante të krahasonim funksionimin e komitetit kombëtar për sigurinë pas, le të themi 10 vjetësh, pas zbatimit të Strategjisë për Sigurinë Kombëtare.

¹ Pjesa XIII, Nenet 78 – 81 të Strategjisë.

² Komiteti KOBRA është ekipi i Mbretërisë së Bashkuar për krizat kombëtare. Ky është një shkurtim për “**C**abinet **O**ffice **B**riefing **R**oom **A**.” (Dhoma A e Mbledhjeve të Zyrës së Kabinetit).

³ Ai mund të mblidhet nga kryeministri nën diskrecionin e tij. Përbëhet nga kryetarët e MI5, policia, sekretariati i kontingjencave civile, si edhe ministra të tjerë. Përbërja e tij ndryshon në varësi të emergjencave për të cilat mblidhet.

⁴ Për shembull, Zyrtari më i lartë për Veterinarinë në Departmentin e Mjedisit, Ushqimit dhe Çështjeve Rurale ka qenë anëtar i Komitetit COBRA, kur ky komitet trajtoi problemin e sëmundjes së aftës epizotike.

⁵ COBRA është mbledhur për herë të fundit më 3 gusht 2007 për të zgjidhur problemin e sëmundjes së aftës epizotike në fermën Swrei (Surrey).

⁶ Ka ekzistuar të paktën që nga viti 1980, kur menaxhoi reagimin e Mbretërisë së Bashkuar ndaj rrethimit të Ambasadës Iraniane.

Përtej kësaj përqsasje kombëtare, nevojitet edhe një përqsasje rajonale, si edhe një mekanizëm për t'u marrë me kërcënime, që mund të mos kenë origjinë lokale, madje që mund të vijnë ose mund të ndodhin jashtë hapësirës territoriale shqiptare, për shembull zjarre apo fatkeqësi të tjera natyrore mbi tragete, derdhje naftë, etj. Këta faktorë të jashtëm sigurisht që duhen marrë parasysh në analizimin e kërcënimeve në vend, sepse, për shembull, derdhja e një sasive të madhe naftë në terminalin e Tivarit, me të fryrë një erë e lehtë nga jugu, do të përbënte së shpejti një kërcënim për plazhin turistik të Velipojës. Menaxhimi efektiv i një derdhjeje të tillë, mund të mos jetë shumë i kushtueshëm, për sa i përket pajisjeve, por ai kërkon përdorimin e mjeteve të vogla lundruese të pajisura siç duhet dhe një ekuipazh të stërvitur mirë.

Një përfitim nga këto përqsasje nënrajonale, të cilat po adoptojnë Shqipëria dhe partnerë të tjerë vjen nga ndarja e kostos së pajisjeve të shtrenjta¹ si për avionët e posaçëm kundër zjarrit, ashtu edhe për zhvillimin e specializimeve kombëtare². Kjo është një strategji e arsyeshme jo vetëm për Ballkanin, por edhe për Evropën Veriore, përmes së cilës operacionet e shpëtimit me helikopter gjatë natës në Oqeanin Atlantik në bregun perëndimor të Irlandës bëhen me helikopterë të Mbretërisë së Bashkuar, të cilëve për të shkuar në skenën e shpëtimit u duhet të fluturojnë mbi Republikën Irlandeze. I njëjti specializim ndodh në rastin e platformave të naftës dhe gazit në Oqeanin Atlantik dhe Detin e Veriut, ku koordinimi i shpëtimit dhe sigurimi i pajisjeve të posaçme në këto ujëra

¹ Këto, për momentin, Brenda Ballkanit Perëndimor operohen vetëm nga Kroacia.

² Dy shembuj të kësaj nga Evropa Perëndimore janë specializimi i Holandës në parandalimin dhe lehtësimin e përmbytjeve dhe zhvillimin nga ana e Mbretërisë së Bashkuar e një programmi për trajnimin e qenve që identifikojnë viktimat në ndërtesat e shkatërruara, etj.

ndërkombëtare manaxhohet ose nga Mbretëria e Bashkuar ose nga Norvegjia. Njësitë e specializuara të reagimit ndaj zjarrit dhe incidente të tjera në det mbi tragetet e shumtë në Adriatik apo në rezervuarët e naftës dhe gazit mund të jenë një tjetër shembull.

Një tjetër përfitim qëndron te zyrtarizimi i “strategjive në ndihmë të fqinjëve”, sidomos në rast tërmetesh, zjarresh e ndoshta edhe pandemive aviare. Këtu mund t’i referohemi marrëveshjes për luftën kundër zjarreve mes Bosnje & Herzegovinës, Kroacisë dhe Malit të Zi, e cila jo vetëm që i jep të drejtë ekipeve të zjarrfikësve në terren ta ndjekin zjarrin këmba-këmbës, por i jep edhe zjarrfikësve ajrorë kroate mundësi hyrjeje në hapësirën ajrore të dy vendeve të tjera, për të luftuar zjarret në zona të vështira dhe pyje. Fakti që kjo marrëveshje lejon arranjime të tilla e zvogëlon ndjeshëm kohën e reagimit ndaj zjarrit dhe është veçanërisht me vlera, pasi ajo ka hyrë në fuqi që në vitin 2000, vetëm pesë vjet pasi vendet nënshkruese të saj ishin në luftë. Praktikisht, asetet kroate mund të përdoren për të plotësuar asetet paksa të kufizuara të dy vendeve të tjera. Në fund fare, këto marrëveshje bashkëpunimi duhet të çojnë te standardizimi i procedurave, pajisjeve, dhe gjërave të tjera si frekuencat e radiove dhe çështjeve të tilla elementare si p. sh. në shërbimet zjarrfikëse, diametri i zorrës apo tubit të llastikut të zjarrfikëseve¹. Ja, këtu shihni tre zjarrfikëse në stacionin e zjarrfikëseve në Cetinje, Mal të Zi, të cilat janë nga 30 deri 50-vjeçare. Dy prej tyre janë angleze, kurse njëra gjermane,

¹ Kjo nuk është diçka që bëhet sa hap e mbyll sytë. Mbretërisë së Bashkuar iu deshën 40 vjet, ndërsa në Shtetet e Bashkuara ky proces edhe sot e kësaj dite është larg të qenurit i përfunduar. Qyteti Fayetteville në Karolinën e Veriut përdor tuba lastiku me diameter 5 inç në nivel rrethi (County) dhe 4 inç në nivel qyteti (City). Përveç kësaj, diku punohet me radio VHF, kurse gjetkë me radio UHF, kështu që nuk mund të komunikohet direkt.

kështu që nuk përshtaten dot me njëra-tjetrën pa ndihmën e adaptorëve të posaçëm.

Për çdo “kërcënim” të identifikuar është e rëndësishme, sigurisht, që të caktohet një agjenci kryesore që të merret me një emergjencë, kurdo që ajo të ndodhe dhe kjo agjenci të lejohet që ta menaxhojë incidentin në nivelin e duhur, duke pasur në të njëjtën kohë mundësi t’i kërkojë niveleve më të larta të menaxhimit¹ asete apo mbështetje shtesë kur kërkohet. Presupozohet gjithashtu që kjo agjenci kryesore të prodhojë një analizë me shkrim të risqeve dhe një plan kontigjencash për çdo kërcënim që caktohet të menaxhojë.

Në Mbretërinë e Bashkuar, rregulli i përgjithshëm është që për emergjencat tokësore prioritet merr policia, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për emergjencë shumë specifike, si p. sh. një zjarr i madh, ndërsa për emergjencat bregdetare, prioritet merr roja bregdetare. Pastaj, këto kërcënime potenciale ndahen në të ashtuquajturat nivele komandimi ari, argjendi dhe bronzi, në varësi të seriozitetit të tyre. Një shembull i një incidenti të nivelit të artë do të ishte ai i bombardimeve të metrosë 7/7 dhe autobusit, kurse një përplasje e rëndë trenash me disa viktima, ndoshta do të menaxhohej në nivelin e argjendit. Në çdo nivel, menaxhimi i medias dhe puna me të, si edhe transparenca dhe sigurimi i informacionit për publikun është një komponent kyç në procesin e reagimit ndaj emergjencave dhe kryhet më mirë nga zyrtarë të ngarkuar posaçërisht me këtë detyrë dhe mundësisht të trajnuar.

Pavarësisht se kush ka prioritet, bashkëpunimi midis policisë dhe pushtetit vendor, si edhe bashkëpunimi me atë që mund të quhet sektori i organizatave jofitimprurëse mbetet i rëndësishëm. Zjarri që ra në Shëngjin në depozitat e naftës

¹ Ose Këshilli Kombëtar për Sigurinë, ose Këshilli i Ministrave, sipas rastit.

demonstroi më së miri rëndësinë e sjelljes së bashku fillimisht të aseteve shtetërore dhe atyre të OJF-ve (të OJF-së Malteser në këtë rast) dhe më në fund të aseteve nga një shtet fqinj. Në fazën e mëvonshme të pastrimit, agjencitë e ndryshme mjedisore dhe OJF-të mjedisore do të luajnë një rol në kthimin e lagunave fqinje në gjendjen fillestare si habitate të rëndësishme për zogjtë shtegtare. Kombinimi i qeverise (si asaj qendrore dhe vendore), reagimi ndaj emergjencave civile dhe nevoja për një mekanizëm të qartë kontrolli do të vazhdojë të jetë një veçori e planifikimit të emergjencave civile siç mund të shihet edhe nga roli që roja bregdetare e Mbretërisë së Bashkuar ka në koordinimin e veprimtarive të mjeteve të lundrimit të Institucionit Kombëtar Mbretëror të mjeteve lundruese të shpëtimit¹, një OJF e financuar plotësisht privatisht, me asete të tjera shpëtimi, që në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, janë të pajisura edhe me helikopterë.

Vetëm dy fjalë për kufijtë. Ndërkohë që kontrolli dhe menaxhimi i integruar i kufijve kombëtare² duhet të mbetet fokusi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Sigurinë, kjo nuk mund të jetë plotësisht efektive pa një përqasje të integruar rajonale dhe bashkëpunim të ngushtë me shtetet fqinje. Këto zhvillime po bëhen në gjithë rajonin në nivelet më të larta, por do të bëhen efektive vetëm kur të zbatohen në të gjitha nivelet. Për shembull, duke harmonizuar ndërrimin e turneve në të dyja anët e një pike kalimi kufiri. Zhvillimi i pikave të kalimit të kufirit vërtet të integruara, si ajo e Igalos në kufirin

¹ Instituti Kombëtar Mbretëror i Mjeteve Shpëtuese të Lundrimit ka një flotë aktive të vendosur në 230 baza në bregdetin e Mbretërisë së Bashkuar dhe një ekuipazh prej 4,800 anëtarëve vullnetarë. Në vitin 2005 ata kanë dalë në det 8,273 herë dhe kanë shëtuar 307 jetë, mesatarisht 23 dalje në det në ditë. Kjo është një organizatë bamirësie dhe e financuar plotësisht mbi baza vullnetare (ndryshe nga shërbimet e shpëtimit të rojes bregdetare të Bashkuara). Kostoja vjetore operative është 180 milionë Euro (2005).

² Pjesa VII, Neni 49 i Strategjisë.

midis Malit të Zi dhe Kroacisë dhe ajo që do ndërtohet së shpejti në Muriqan, në kufirin midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, duhet të ndihmojë në rrjedhjen e lirë të trafikut të turistëve nëpërmjet autostradës kroate buzë detit nga Evropa Qendrore dhe Veriore për në Shqipëri. Sigurisht që është shumë e rëndësishme që të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë proces t'i shohin kufijtë si një mekanizëm kontrolli, i cili përshpejton nga njëra anë lëvizjen e pasagjerëve dhe mallrave të ligjshme dhe minimizon nga ana tjetër vonesat, duke zbuluar dhe parandaluar njëkohësisht kontrabandën dhe veprimtari të tjera të paligjshme e jo duke u bërë pengesë për lëvizjen e lirë dhe të ligjshme. Përveç kësaj, ndarja e barrës rajonale për sa i përket aseteve të sofistikuara dhe të shtrenjta si mjetet ajrore të survejimit të zonës bregdetare mund të rrisë mundësinë e kapaciteteve më të mira për të gjithë.

Zonja dhe zotërinj, shumë faleminderit për vëmendjen!
Jam në pritje të debatit që do të pasojë.

Gjen. Brig. Zija Bahja

Komandant i Komandës Mbështetëse të Forcave të Armatosura të Shqipërisë

IDE MBI RIHARTIMIN E STRATEGJISË SË SIGURISË KOMBËTARE TË RSH

perspektivat për 2008 - 2010

Së pari falënderoj organizatorët për këtë aktivitet dhe për mundësinë e dhënë, të flas për nevojën e përpunimit për vitet në vijim të Strategjisë së Sigurimit Kombëtar (SSK).

Gjatë fjalës sime, do të përpiqem të jap pikëpamjet e mia personale lidhur me situatën e sigurisë në vendin tonë dhe në rajonin e SEE (Evropës Juglindore). Synimi: të gjenden treguesit e përbashkët të sigurisë, të cilët duhet të udhëheqin politikëbërësit e vendeve të rajonit tonë drejt vlerave të përbashkëta të sigurisë. Kjo jo vetëm për faktin se ndeshim gati të njëjtat rreziqe e kërcënime për sigurinë, por edhe se siguria është tepër komplekse dhe dimensionet e saj i tejkalojnë kufijtë e një vendi të vetëm, cilado qofshin përmasat e tij.

Siç kuptohet nga vendosja e folësve të këtij sesi, mua duket se më kanë paracaktuar të flas për rolin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e detyrave të SSK. Kuptohet të shpreh mendimet e mia personale dhe jo të MM apo të SHP. Por organizatorët e këtij aktiviteti më kanë kërkuar të flas edhe përtej kufijve “hipotetike” të dimensionit të mbrojtjes së SSK, dhe t’i përgjigjem disa pyetjeve duke shfrytëzuar edhe lirinë

akademike të shprehjes që të lejojnë këto forume. Ndër to janë:

- Disa nga elementët e rinj që nevojiten të merren në konsiderate gjatë diskutimit dhe përpilimit të SSK për vitet 2008-2010?
- Si duhet organizuar procesi i përpilimit?
- Çfarë politike qeveritare e informimit publik duhet aplikuar për SSK të re?
- Çfarë veprimesh në kontekstin rajonal duhet të ndërmerret Shqipëria, gjatë draftimit të SSK?
- Çfarë masash duhet të ndërmerret Shqipëria për realizimin e objektivave të saj në raport me NATO-n dhe BE?

Në përfundim do të përpiqem të nxjerr disa përfundime rreth të ardhmes së situatës së sigurisë në rajonin tonë (SEE), duke vënë theksin te nevoja e forcimit të bashkëpunimit bilateral me vendet fqinjë tanët, paralel me fuqizimin e aktiviteteve me organizatat shumëpalëshe.

Për të disiplinuar mendimin, preferohet të jepet përkufizimi i një koncepti. Sigurimi nuk bën përjashtim nga ky rregull. Por shpeshherë këto përkufizime kanë limitet e fushës apo të këndvështrimit, në të cilat ato vrojtohen apo aplikohen. Për të treguar vështirësinë e dhënies së një definicioni të saktë dhe të plotë për sigurinë, përdoret një shaka në mjediset e huaja akademike ushtarake në lidhje me kategorinë “siguri”. Nëse i thua një këmbësori siguro “X” objekt, ai do të marrë masa të vendosë shërbimin e rojës, artiljeri do planifikojë zjarr, piloti do sigurojë nëse është mbyllur dera e avionit, marinari do rrisë vigjilencën të shohë se mos del kapiteni i anijes papritmas nga kabina e komandimit. Ndër përkufizimet më të përdorura të sigurisë do të përmendja tre-katër prej tyre që e vënë theksin te situata e pasigurisë dhe konfliktet.

“Sigurimi është kusht i parashikuar, me synim shmangien, parandalimin ose mbrojtjen nga dëmtimet, humbjet ose dëmtimin e shëndetit dhe vrasjet e mundshme të perceptuara”.¹

“Sigurimi shërben si parakusht për zhvillim ...dhe ulje të varfërisë”.²

“Konflikti, mungesa e marrëveshjeve politike të qëndrueshme për reforma, traditat e cekëta të bashkëjetesës në demokraci dhe institucionet e dobëta janë kombinuar të gjitha dhe pengojnë zhvillimin politik dhe ekonomik në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore”.³

Mundësia për konflikte vjen nga “Rivalitetet territoriale dhe etnike, shtetet dhe institucionet e dobëta dhe jo të qëndrueshme, kultura e izolacionizmit nacional, ndërhyrjet nga jashtë dhe kriminaliteti transnacional.”⁴

Sado që përcaktimet e mësipërme japin ide shumë të mira lidhur me konceptin e sigurisë në nivel kombëtar dhe rajonal nëse realizohen, ato duken të pamjaftueshme për të dhënë një spektër të qëndrueshëm të sigurimit në rajon dhe në vend. Prandaj do të sugjeroja metodën dhe mjetet e teorisë dhe praktikës së zgjidhjes së konflikteve për të arritur një situatë sigurie të qëndrueshme, ndër të cilat: menaxhimin sa më herët

¹ Giovanni Manuta, Security: An Introduction, Defining Security, Cranfield University RMCS, 1998, Second Edition March 2000, pp. 42- 45, 11- 16.

² ‘Një Evropë e Sigurt në një botë më të mirë - Strategjia e Sigurisë e BE’- viti 2003, fq. 2; Paul Wilkinson: The statement of Clare Short, Secretary of State for Development, given in the Wilkinson’s paper: “DEFENCE AND SECURITY POLICY FORMULATION, EVALUATION AND IMPLEMENTATION IN DEVELOPING COUNTRIES”, delivered to ESCADA working group (CESS), Groningem 18- 21 April 2002.

³ World Bank Reconstruction SEE: The Road to Stability, op. cit. p.6 <http://www.secrecon.org/RegionalInitiatives/WBRegionalStrategy/contents.pdf> Format.

⁴ Janusz Bugajski, Winning or Losing the Balkans ? Southeast European Reconstruction, Center for Strategic and International Studies, Washington, D.C.A CSIS Europe Program Report, October 2000.

e të planifikuar të situatave kërcënuese politike, sociale, emergjencave natyrore dhe industriale; angazhimin rajonal, transformimin e konflikteve dhe proceset pajtuese brenda vendit e me fqinjët me anë të zhvillimeve ekonomike, politike, ligjore dhe institucionale, bazuar në vlerat demokratike perëndimore, këmbimin, dialogun dhe bashkëpunimin kulturor dhe mirëkuptimin reciprok kulturor e ndërftar (feja pjesë e kulturës). Neglizhenca i kësaj rruge të mban ashtu si në të kaluarën, në “Moçalin Ballkanik” dhe kufizimet e “Real politikës”, kur konfliktet vetëm sa mbaheshin të ndrydhura, nuk zgjidheshin.¹ Nga citimet e mësipërme del mëse e qartë se koncepti i sigurisë kombëtare përmbledh në vetvete disa dimensione që duhen mbajtur në konsiderate gjatë hartimit të SSK: siguria politiko-ushtarake, siguria njerëzore, siguria ekonomike dhe siguria e mjedisit. Këto dimensione konkretizohen duke trajtuar në SSK mënyrën dhe masat e periodizuara në kohë që duhen marrë për çështje të tilla si ulja e tensioneve politike dhe etnike brenda e jashtë vendit, zvogëlimi i deficiteve në zbatimin e normave të demokracisë, zbatimi i rregullit dhe i ligjit, lufta kundër krimit, përdorimit dhe trafikimit të narkotikëve të këqij, përmirësimi i faktorëve që përcaktojnë stabilitetin social, uljen e papunësisë, ruajtjen e mjedisit dhe të infrastrukturës, masat për parandalimin e katastrofave natyrore dhe industriale. Siguria kombëtare arrin stabilitet kur këto masa çojnë në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike-financiare, grupet njerëzore dhe individët ndiejnë rritjen e mirëqenies, arsimimit dhe kulturës dhe të sigurisë njerëzore, përfaqësimin dhe respektin individual, kushte këto

¹ Më gjerë lexuesi mund të drejtohet tek artikulli i Carlo Jean, *THE GEOPOLITICS OF THE BALKANS: REALITY AND PROSPECTS*, Professor of Strategic Studies, LUISS Guido Carli University, Rome, **prepared on the occasion of the international conference *The Balkans and the European Union*, 2001**, October fq. 5-7.

edhe për legjitimitetin e çfarëdo qeverisje. Por në botën reale rrallëkush mund të gjejë perfekten. Prandaj edhe strategjitë e sigurisë kurrë nuk e përjashtojnë konfliktin, por vetëm sa e kufizojnë atë dhe pasojat e tyre. S'ka se si të mos jesh dakord edhe tani pas një shekulli me observimin e sociologut klasik, Max Webber, i cili shkruante: "Raportet e panumërta stabël e përmbajnë (bllokojnë) konfliktin, por konflikti qëndron i maskuar, ai rri nën sipërfaqe në saje të ekzistencës së legjitimitetit".¹ Sipas shkencëtarit strukturalist gjerman, Fritz Schrapf, duhen tre kushte të domosdoshme për mbështetjen dhe ruajtjen e qeverisjes legjitime: së pari, legjitimiteti i orientuar nga inputet, siç është përfaqësimi me votimin e lirë dhe procedura të ndershme. Së dyti, legjitimiteti i orientuar nga outputet, si p. sh., politika efiçente, performanca e qeverisjes, etj. E treta, është kërkesa normative e identitetit të përbashkët kolektiv, e cila e bën vendimmarrjen e bazuar në inpute të pranueshme nga pakica nga njëra anë, dhe nga ana tjetër vlerësohet efiçencia e qeverisjes.² Nuk do shumë argumente për të kuptuar domosdoshmërinë e plotësimit kushteve të pranimit në NATO dhe në BE për vendet aspirante, të cilat në ¾ janë të njëllota dhe masa konkrete për arritjen e legjitimitetit.³

¹ Joseph A. Scimecca: "Theory and alternative dispute resolution: A contradiction in terms?": in Dennis J. D. Sandole and Hugo van der Merwe: "Conflict Resolution theory and practice, Integration and application". Manchester University Press, USA, 1993, fq. 214- 215.

² Fritz Schrapf: në artikullin e Weiner, Antje: "The Puzzle of the British 'No' to Schengen", (Institute for Political Science, University of Hanover, February 1999), p. 9.

³ A. Kriteret e Kopenhagen-it për pranim në BE, kërkojnë nga vendet candidate të kenë arritur:

- Stabilitet të institucioneve, garantim të demokracisë dhe shtetit ligjor.
- Të drejtat e njeriut dhe respekti për minoritetet e mbrojtja e tyre.
- Eksistenca e një ekonomie funksionale tregu, si dhe kapacitet për t'u përballur me presionin e konkurrencës së lirë dhe forcat e tregut brenda BE.

Përmbushja sa më shpejt e tyre jo vetëm i shërben ruajtjes së sigurisë kombëtare, por mbetet edhe obligim patriotik për çdo shtetas shqiptar.

Disa probleme dhe përgjigjet për zgjidhje nga SSK

- SSK e shkruar - ka nevojë të qartësojë disa hipoteza kryesore, të vendosë prioritetet (politikat) dhe balancimin e faktorëve që lidhen me objektivat (qëllimet) e Strategjisë së Sigurisë dhe masat për arritjen e tyre.
- SSK- në rastin më të mirë shërben të udhëheqë e koordinojë punën e detajuar të institucioneve, agjencive, sektorëve shtetërorë dhe joshtetëror për të arritur sinergjinë e nevojshme.

• Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshi besnikërinë ndaj qëllimeve politike, ekonomike dhe monetare të unionit.

• *Të kenë krijuar :*

- kushtet për integrim përmes përshtatjes së strukture së tyre administrative;
- kështu që legjislacioni i BE i njëjtësuar në legjislacion kombëtar të zbatohet efektivisht me anë të strukturave administrative dhe juridike të përshtatshme.

B. Kriteret për anëtarësim në NATO: a. Nje sistem politik demokratik funksionues (përfshirë këtu zgjedhje të lira dhe të ndershme, respekt për lirinë e individit dhe shtetin ligjor) dhe një ekonomi të plotë tregu.

b. Stil demokratik të marrëdhënieve civilo-ushtarake.

c. Trajtimin e pakicave (minoritetëve) të popullit në përputhje me statutet e OSBE.

d. Zgjidhjen e konflikteve me vendet fqinje dhe angazhim për zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërkombëtare.

e. Dhënien e kontributit për aleancën dhe vullnetin për të ndërmarrë hapa për arritjen e interoperabilitetit me anëtarët e tjerë të aleancës.

Sipas fjalëve të William Perry, kriteret për pranimin e anëtarëve të rinj në NATO janë të njëjta me gjendjen e anëtarëve ekzistues: a. shoqëri demokratike; b. ekonomi e tregut të lirë; c. jo konflikte territoriale me fqinjët; d. kontroll civil në forcat e armatosura; e. Forca të Armatosura me strukturë komandim kontrolli të ngjashme me NATO-n. (*What next- NATO enlargement, By William Perry*).

- I jep Kuvendit një mjet për të ushtruar rolet e veta plotësuese në mbikëqyrjen dhe formësimin e politikës së sigurisë.
- Duke qenë proces transparent mund të promovojë llogaridhënien demokratike dhe zhvillimin e dijes, të maturisë dhe ekspertizës brenda shoqërisë për çështjet e sigurisë.
- Duke theksuar fushat e mundshme për kooperim apo zgjidhjen e mospajtimeve, dokumenti komunikon prioritete dhe synime të qeveritë dhe audienca e huaj.
Ky është edhe rasti i NATO-s dhe EU, ku kriteret e pranimit në to janë bërë *de facto* gjenerator për stabilitet dhe siguri të integruar në vend.
- Teksti ekzistues i SSK thekson shpesh anëtarësimin e plotë në NATO dhe EU, por shumë pak përshkruhen masat e prioritizuara, parapërgatitja e fushave të nevojshme apo referencat për strategjitë dhe marrëveshjet e aprovuara të zgjerimit. Dokumenti në pjesën e tretë, nuk shkon përtej nevojës dhe artikulimit të aspiratave të përgjithshme, nuk specifikohen politika konkrete për arritjen e tyre.

Në dokumentet e botuara të vitit 2005 të SSK dhe të SUK (Strategjia Ushtarake e RSH) rikonfirmohet zyrtarisht bindja e politikëbërësve të vendit tonë se kërcënimet kryesore për sigurinë në rajon nuk vijnë më nga fqinjët jashtë kufijve të çdo vendi. Ato kanë më tepër origjinë të brendshme, vijnë nga mungesa e stabilitetit politik, arritjet e dobëta ekonomike, të cilat po e stërzgjasin procesin e tranzicionit në demokraci me institucione të pjekura. “Bota është e sheshtë”,¹ dhe e vogël argumenton Tomas Friedman, dhe efektet negative dhe pozitive të situatave të sigurisë arrijnë aq shpejt nga një vend në tjetrin sa nuk kanë më kuptim kufijtë ekzistues shtetërorë.

¹ Thomas L. Friedman: “The World is Flat”, www.fsgbooks.com 1 3 5 7 9 10 8 6 4 2, botim elektronik i vitit 2006.

Është koha që këtë tezë të Friedman ta kuptojnë e zbatojnë të gjithë politikëbërësit e rajonit të Ballkanit.

Botimi i 2005 i SSK është i treti për nga radha, pas aprovimit më 1995, ku SSK dhe SUK përbënin një dokument të vetëm. Ka merita: pasi paraqet në mënyrë koherente dhe reale situatën e sigurisë në vendin tonë dhe në rajon. Thekson qartësisht se rreziqet primare që i kanosen sigurisë së vendit janë më tepër nga brenda vendit sesa nga jashtë. Rrjedhimisht jep rekomandime të politikëbërësit tanë që t'i japin prioritet zhvillimit të faktorëve të stabilitetit të brendshëm të sigurisë, në raport me ato që sigurojnë vendin nga rreziqet e jashtme (FASRSH). Ka një publicitet të madh vendimi tepër pozitiv të qeverisë tonë për buxhetin e mbrojtjes 2% e GDP, për të lehtësuar pranimin në NATO.

Në lidhje me këtë vendim dua të parashtoj dy argumente:

1. Pavarësisht nga objektivi për marrjen e ftesës së anëtarësimit në NATO, shpenzimet për mbrojtjen mbeten pas buxhetit për shëndetësinë, arsimin dhe rendin, pasi këto përbëjnë prioritetet për zhvillimin e vendit, dhe rrjedhimisht për sigurinë kombëtare. Dhe kjo është gjë e mirë. Të mos harrojmë se në kohën e mbretërisë, në vitet '30 shteti shqiptar shpenzonte për mbrojtjen mbi 52% të buxhetit të shtetit, dhe nuk arriti të mbronte vendin. Në kohën e shtetit komunist, buxheti i mbrojtjes përbënte në periudha të veçanta nga 24-14% të totalit, për arsye se mbrojtja ishte e ndërtuar mbi konceptin e mbrojtjes me forcat e veta dhe izolimit politik.

2. Ka mendime, se meqë anëtarësimi në NATO kërkon shpenzime të 2% e GDP, kjo do përbëjë një barrë të rëndë për ekonominë, duke harruar se mbrojtja kolektive jo vetëm jep më shumë siguri, por kushton edhe më lirë... Për më tepër, situata e riskut për investimet e huaja vlerësohet me shkallën 6 për vendin tonë, nga 7 që merret maksimalja. Anëtarësimi në NATO jep garanci për investimet e huaja e më gjerë.

Problemet që duhet të zgjidhë më mirë strategjia e SK 2008-2010, kanë të bëjnë me shmangien e karakterit të saj disi leksikor mbi SSK, sidomos përmirësimin e pjesës së tretë dhe të katërt, ku në disa raste mbetet ende në nivelin e vlerësimit të rreziqeve (p. sh., mjedisi, fq. 45). Ajo duhet të nxjerrë qartazi, kornizën e punës (framework) apo matricën e veprimeve dhe masave që nevojiten për të arritur në balancimin e qëllimeve (objektivave) me burimet e mjetet (means) në dispozicion dhe mënyrat për arritjen e tyre, duke llogaritur edhe kompensimet e nevojshme në njërin ose tjetrin element.

Rruga e Metoda e Përpunimit të SSK

Shpesh strategjitë tona janë përkthime ose të shkruara nga të huajt për ne, pa e kuptuar realitetin, kulturën dhe nevojat tona. Kjo ka edhe shpjegimet e veta, përderisa është një proces i ri për vendin tonë, ku përvoja e memoria burokratike dhe administrative e kanë të vështirë të mbijetojnë në kushtet e ndryshimeve të shpeshta strukturore të institucioneve dhe personelit që punojnë në to. Por së pari kjo vjen nga mungesa e nxitjes së debatit publik dhe mungesës së konsultimit gjatë hartimit të dokumentit të SSK&SUK me grupe të gjera jo vetëm të interesit, por edhe me publikun në tërësi. Metoda e ndjekur duhet të synojë ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe të gjitha institucioneve, të cilat duhet ta konsiderojnë SSK produkt dhe pronë të tyre. Ndryshe ajo kthehet në një dokument të rëndomtë që rrallë kush i referohet. Kuptohet se transparenca si metodë dhe instrument i shërben gjenerimit të debatit publik në media dhe vende pune. Puna e mbyllur nëpër zyrat është ajo që vlen më pak. Konsultimi me publikun dhe puna me të i shërben rritjes së vetëdijes, thellimit të kuptimit të sigurisë kombëtare dhe inkurajon pronësinë publike mbi procesin dhe çështjet e sigurisë. Në këtë mënyrë

i shërbehet forcimit të kohezionit social dhe kombëtar në tërësi. Procesi mbetet i mangët nëse nuk vijohet me mbledhjen dhe përpunimin e mendimeve të opinionbërësve dhe shkruesve të mendimeve e ndjesive të opinionit. Verifikimi i vlerësimeve fillestare për analizën e kërcënimeve dhe vendosja në vëmendje të opinionit publik për këto kërcënime dhe provokimi i debateve, i shërben precizimit të gjetjeve dhe zgjidhjeve, si dhe për nxjerrjen e konkluzioneve mbi ndjeshmërinë e publikut për çështje të sigurisë. Analiza e mjedisit fizik të sigurisë dhe analiza e kërcënimeve dhe zhvillimi i një sigurie reale të vendit (kombëtare) duhen marrë në raport me funksionimin real të institucioneve dhe sektorëve të sigurisë, me kapacitet, boshllëqet e tyre.

Eksperiencia më e mirë, rekomandon një metodë me rreth 9 hapa: 1. Rishikimi i mjedisit të sigurisë; 2. Analiza e kërcënimeve; 3. Roli dhe kapacitetet që nevojiten të krijohen; 4. Analiza funksionale e institucioneve të sigurisë; 5. Analiza e mangësive (deficiteve) të sigurisë; 6. Rishikimi i projekteve të zhvillimit sektorial; 7. Analiza e burimeve (buxheteve) të sektorëve të sigurisë; 8. Aprovimi i Strategjive të Reformimit të Sektorëve të Sigurisë. 9. Aprovimi i SSK (Konkluzioni = SSK).

Disa prioritete rajonale dhe kombëtare për Sigurinë

Përputhja me vlerat e përbashkëta të BE i të gjithë sistemit politik, social dhe ekonomik përmes:

- Ndërtimit dhe forcimit të institucioneve, zhvillimit gjithkund të kapitalit njerëzor dhe kulturës, shtimi i resurseve për demokratizimin e mëtejshëm të komunitetit rajonal.
- Arritjeve ekonomike dhe financiare dhe kthimi në ekonomi të plotë të tregut të lirë.

- Arritjes së kohezionit social e politik, gjithëpërfshirjes, pajtimit kombëtar, duke shmangur diskriminimin dhe përjashtimin në mjedisin social.
- Rritjes së kulturës qytetare dhe politike të popullatës, duke shëruar plagët e qëndrimeve të kaluara nacionaliste dhe kërkuar siguri e miqësi së pari në fqinjët tanë kufitarë.
- Rindërtimit dhe pajtimit kombëtar e mbrujtjes së vlerave të përbashkëta demokratike.
- Sistemit të arsimit, i përputhur me ETC (European University System).
- Ruajtjes së Rendit Publik, luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve ilegale dhe korrupsionit.
- Konsolidimit e përsosjes së infrastrukturës rajonale, veçanërisht sistemit rrugor, infrastrukturës e kulturës së turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Transformimi i Forcave të Armatosura për arritjen e Objektivave Kombëtare për pranimin së shpejti në NATO.
- Kooperimi brenda dhe jashtë rajonit, thellimi i ndërtimit të sigurisë dhe besueshmërisë reciproke mes popujve dhe shteteve tona, duke lidhur traktate të miqësisë me të gjithë fqinjët tanë dhe ndërtuar një klimë reale mirëbesimi e kooperimi me ta.

Krijimi i skemave logjike funksionale për paketat e ligjeve të sigurisë dhe akteve nënligjore dhe reforma e gjerë e të gjithë Sistemit të Sigurisë Kombëtare (SSR). Do të sugjeroja, përvojën e Lituanisë dhe të Bullgarisë që kanë në përdorim një ligj organik për sigurinë kombëtare. Ky lloj ligji *organik i përkufizon dhe sanksionon*:

- *Sigurinë si shërbim të integruar shumëdimensional, strukturën e sektorit të sigurisë, menaxhimin e tij dhe kontrollin civil demokratik mbi të.*

Do të argumentoja vetëm një aspekt të sistemit të arsimit që lidhet ndjeshëm me sigurinë e vendit dhe është kthyer në

faktor negativ për të, kualifikimet në shkencat ekzakto, kryesisht ato kompjuterike, programuesit. Vendi ynë ka numrin më të vogël në rajon të të diplomuarve për software dhe numrin më të vogël të shpikjeve për banorë. Kjo, në kohën kur siguria e komunikimeve elektronike dhe përdorimi i internetit për qëllime kriminale e terroriste është bërë objekt i shumë vendimmarrjeve dhe nismave ligjore ndërkombëtare. Jemi prapa Serbisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Bosnje Hercegovinës. Sa për ilustrim po përmend: Në vitin 2006 Microsoft hapi në Serbi qendrën e tij për kërkime dhe zhvillim. Ericson ka hapur në Kroaci qendrën e tij për kërkim dhe zhvillim për IT të avancuar, me 500 shkencëtarë. Bullgaria po bën tratativa me korporatën ORACLE për të hapur qendrën e kësaj korporate për kërkime shkencore e zhvillim. Rumania është kthyer në India e Evropës për marrjen me kontratë të përpunimit të programeve soft për shumë kompani të huaja, për shkak të cilësisë së mirë e me kosto më të ulët të punës së tyre (në Austri janë më të preferuarit).

Mundësitë për konflikte:


Ka një bindje të përgjithshme për mungesën e konflikteve ndërshtetërore në Ballkan e më gjerë. Por është rritur rreziku nga aktorët joshitetërorë dhe kërcënimet e brendshme për sigurinë. Sidoqoftë kriza e pazgjidhur e ish-Jugosllavisë dhe efekti i minoriteteve etnike është arsye për shqetësim për stabilitetin rajonal. Ka rreth 16 milionë njerëz që i takojnë minoriteteve në Ballkan dhe 3.5 milionë të zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Kohezioni i vendit dhe tendenca për konflikte të brendshme ende kanë përparësi për masat për forcimin e sigurisë kombëtare. Do të sugjeroja aplikimin real të marrëveshjes dhe konventave politike të qëndrueshme dhe

konsensuale për t'u qeverisur, ndryshe përse e mbajmë shtetin? "Asnjë qeveri në botë nuk mund të realizojë dhe arrijë të përmbushë për një kohë të gjatë të gjitha sa pret popullata e tyre".¹ Ndaj edhe autori Stephen Nathanson me të drejtë pyet që në titullin e librit të tij: A duhet të merremi vesh për t'u qeverisur? Mirëqeverisja dhe forcimi i institucioneve - përfshi SSR (reformën e sektorëve të sigurisë) rrit shanset për legjitimitet, rrjedhimisht, ul potencialisht mundësinë e konflikteve të brendshme.

Mungesa e parapërgatitjes së territorit të vendit dhe e mjeteve të domosdoshme për parandalimin e katastrofave natyrore dhe industriale mbi mjedisin dhe jetën e njerëzve (tërmetet, përmbytjet, zjarret masive, shpërthimi i digave) mbetet një tjetër drejtim i vëmendjes së masave për sigurinë e vendit. Forcat e armatosura i kanë paraprirë me transformimin e tyre këtyre nevojave të sigurisë për mbrojtjen e mjedisit, krahas përshtatjes me operacionet, në mbështetje të paqes dhe luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar. Direktiva e BE për Menaxhimin e baseneve të Lumenjve dhe bregdetit 2017 i hap perspektiva më të qarta rritjes së rolit të FARSH për Mjedisin dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore. Kjo kërkon medoemos edhe masivizimin e Shërbimit të detyrueshëm ushtarak alternativ dhe rritjen kapaciteteve për këto detyra, me qëllim përbalimin e tyre me siguri. (Piktura e mëposhtme tregon takimin e pjatave tektonike të Tokës, që nëse nuk mbahen në konsideratë gjatë kolaudimit të ndërtimeve dhe infrastrukturës që po bëhen në vendin tonë, do të sillte pasoja katastrofike për jetën e qytetarëve tanë: kujto tërmetin në Stamboll 1999 me më shumë se 50 mijë të vrarë).

¹ Nathanson, Stephen: *'Should we consent to be governed?'*- Wadsworth Publishing Company, USA, 1992, p. 106-7.



Developed by The Learning Company, Inc. Copyright (c) 1997 TLC Properties Inc. All rights reserved.

Kërcënimet dhe rreziqet:

Në Strategjinë e sigurisë së BE, nënvizohet se: “asnjë nga kërcënimet e reja nuk është thjesht ushtarake dhe asnjë nuk mund të përballet vetëm me mjete ushtarake”.¹ Duke përmendur në mënyrë telegrafike kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë kombëtare, mund t’i ndanim për efekt analize si më poshtë:

Të Jashtme:

- Përdorimi i forcës ushtarake: ka pak gjasa të ndodhë
- Nacionalizmi dhe konfliktet etnike
- Terrorizmi & përhapja e ADM (WMD)
- Krimi i Organizuar & trafiket ilegale
- Ndotja e mjedisit global dhe epidemitë

¹ ‘Një Evropë e Sigurt në një botë më të mirë - Strategjia e Sigurisë e BE’ - viti 2003, fq.7

- Ngrohja globale dhe mungesa e burimeve hidrike dhe energjetike
- Rritja e pakontrolluar demografike e popullatës së botës dhe emigrimi masiv i saj

Të Brendshme:

- Krimi i Organizuar
- Mungesa e stabilitetit politik
- Rritja e pamjaftueshme ekonomike dhe e zhvillimit
- Emigrimi Ilegal
- Fatkeqësitë natyrore dhe industriale
- Rritja demografike përtej mundësive të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Dezinformimi dhe manipulimi i opinionit publik
- Zhvillimi i pamjaftueshëm i arsimimit, shkencës, dhe kulturës

Kultura zhvillohet më ngadalë nga mirëqenia. Ajo ruan dhe gjeneron gjendjen e konfliktit.

Siguria e Kufijve dhe Sfidat e Trafiqeve të Narkotikëve të Këqij


- Siguria e Kufijve:
- Krimi i Organizuar/ Korrupsioni, përhapja e armëve, narkotikëve, dhe trafiku i qenieve njerëzore
- Kokaina: Evropa është tregu i dytë në botë, me 1,5 milionë përdorues.

Brigjet e Atlantikut dhe të Mesdheut janë pikat e hyrjes kryesore, Ballkani zonë tranzitimi.

Heroina: Afganistani, prodhuesi kryesor për Evropën, Ballkani rrugë transit.

Këto janë arsytet që në raportet e NATO-s për vendin tonë nënvizohet në veçanti forcimi i regjimit të sigurisë dhe

menaxhimit të kufijve, regjistrimit dhe futjes në rrënjët elektronike të popullatës dhe adresave të banimit, kartave të identitetit e lejeve të udhëtimit ndërkombëtar bio-metrik, etj. Kjo krijon mundësi për këmbim informacioni në kohë reale, rrjedhimisht rrit efikasitetin e luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Siguria është një koncept i gjithanshëm, shumëdimensional dhe shumëpalësh, që i kapërcen kufijtë e NATO-s, të BE dhe të çdo vendi. Ajo kërkon menaxhim dhe përpunim në nivelet përgjegjëse dhe kooperim ndërkombëtar bilateral dhe multilateral, në të gjitha dimensionet dhe krijimin e masave të plota të besimit reciprok. Nëshkrimi i Traktateve të Miqësisë me të gjithë vendet fqinje do t'i kontribuonte drejtpërdrejt sigurisë (shih tabelën më poshtë në anglisht).



Reforma në Sektorin e Sigurisë – nënkupton përmirësimin e vijueshëm të Marrëdhënieve civile-ushtarake (MCU)

- Fokusi i Arsimitit Profesional Ushtarak (APU), objektiv parësor për lidhshmëri të suksesshëm mbeten formimi ushtarakeve si pjesë e shoqërisë qytetare (Civile) dhe Mbikëqytja Demokratike e Sektorit të Sigurisë (përfshi Forcat e Armatosura).
- APU konsolidohet në vartësi të principeve të arritura që e bëjnë ushtarakun:
 - Pjesë e shoqërisë civile dhe të vlerave të saj.
 - Krijojnë tek ushtarakët vlera të larta, virtyte, ethos, profesionalizëm dhe shpirt reparti e komuniteti.
 - Të ketë mundësi e shanse të barabarta për arsimim, kualifikim, gradime e karriere dhe procedura të ligjshme për trajtimin dinjitoz të tyre.
- Të ndiejë se Shqipëria është pjesë e komunitetit rajonal në Evropën Juglindore, e cila kërkon të arrijë sigurinë e saj me anë të zhvillimit të fqinjësisë së mirë; rajon që para së gjithash aspiron për integrim në NATO dhe në BE sesa për realizim të ëndrrave nacionaliste.
- Reforma e transformimi kërkon ushtarakë të paguar mirë për punën e tyre dhe shtet që mbron dinjitetin e vlerat e tyre për shërbimin ndaj atdheut, sigurinë tyre sociale dhe ta bëjë punën e tyre sa më tërheqëse ndaj brezave të rinj dhe të respektuar nga shoqëria civile (shih grafikun e ndërvarësisë së vlerave më poshtë).

Grafiku i vlerave të ndryshueshme ndërmjet ideologjisë, profesionalizmit dhe pushtetit në marrëdhëniet civilo-ushtarake.

Përmbushja e kërkesave të raportit përfundimtar të Samitit të **Pragës**, krahas atij të **Rigës** mbeten prioritet për vendin tonë. Lordi Robertson megjithëse vlerësoi përparimet që kemi bërë sidomos në reformën në Forcat e Armatosura, theksoi: “Ndryshoni Mentalitetin. Në NATO do të hyhet me kapital njerëzor të ndryshuar dhe jo me topa dhe aeroplanë”.¹ Rrjedhjet dhe konkluzionet për vijimin e mëtejshëm të reformës sidomos MCU janë të kuptueshme. Kjo kërkon mbi të gjitha që vëmendja e planizuesve tanë ushtarake dhe civile të përqendrohet tek arsimimi i gjerë sipas kurrikulave të vendeve perëndimore dhe plotësisht i konvertueshem dhe me kredite të transferueshme akademkisht, te stërvitja, gjuha

¹ Communiqué (21-22 Nov. 2002) 127: Prague Summit Declaration issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council, internet sources.

operacionale e NATO-s, anglishtja, modernizimi i pajisjeve mësimore dhe stërvitore, simulatorët, etj. Pra, fokusimi në zhvillimin e fuqisë dhe vlerave luftarake kryesisht në përbërësit konceptualë e moralë të Forcave të Armatosura dhe më pak në modernizimin e përbërësve fizikë të fuqisë luftarake, e cila sigurisht kërkon më tepër financime në para.

Përmbajtja e Mundshme e SSK

1. Dispozita të përgjithshme
2. Hipoteza bazë mbi Politikën e Sigurisë Kombëtare
3. Interesat e Sigurisë së RSH
4. Faktorët e rrezikut, dëmtimeve dhe kërcënimeve ndaj Sigurisë së Vendit
5. Politika e Sigurisë Kombëtare të RSH, koncepti, objektivat, prioritet.
6. Veprimet parësore dhe burimet për implementimin e SSK
7. Dispozita Përfundimtare

Në përfundim, shpreh bindjen se ky seminar do të kontribuojë në përpilimin e SSK të vendit, si proces dhe përmbajtje, duke bërë të mundur ndërjegjësimin tonë për nevojën reale të balancimit të objektivave strategjike me kapacitetin në dorë dhe të krijuara, për një strategji sa më realiste të sigurisë së vendit.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
MBI ZHVILLIMIN E STRATEGJISË SË SIGURISË KOMBËTARE

Formati: 14x20 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 240116
Tiranë, 2007